

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration Intérimaire  
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2004**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 22.12.2004. GODINE**

---

**DHJETOR – DECEMBAR**  
**2004**

# TRANSKRIPT

## NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2004

Seanca Plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,15.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

### **KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes. Ju dëshiroj mirëseardhje në Seancën Plenare. Mirëseardhje të veçantë Kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministrit dhe ministrave.

Materialet lidhur me këtë seancë, ju janë shpërndarë me kohë.

Ju lutem, të përqëndrohemi: pas betimit të deputetëve e kemi zgjedhjen e zëvendëskryeministrave, e këtë e kemi patur në Kryesi si propozim dhe është aprovuar, prandaj ta kemi në konsideratë.

Meqë mendoj se do të kemi mjaft punë, pa humbur kohë po kalojmë në miratimin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Sikur është rregull, për vërejtje eventuale, ato le të bëhen me shkrim. Megjithatë, nëse ndonjë deputet ka vërejtje dhe e ndien të nevojshme, atë mund ta bëjë edhe gojarisht. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës – Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Më duhet ta jap një sqarim të shkurtër, më tepër si argumentim ose përkrahje të vërejtjeve e sygjërimeve që i kemi patur në seancën e parë nga Grupi Parlamentar të ORA-s. Në një bisedë shumë të shkurtër këtu, thash se do të vazhdojmë konsultime të mëtejshme dhe do të mundohemi ta bëjmë një zgjidhje, e këtë e kam thënë edhe në seancën e Kryesisë. Prandaj, sygjërimi dhe vërejtja qëndron. Do të thotë, nuk ishte e paarsyeshme, por nuk ishin bërë përgatitjet e duhura dhe konsultimet e nevojshme dhe këtë sot e kemi parasysh.

Të gjithë deputetët këtë e kanë në materialet, dhe pa humbur kohë të procedojmë me dhënien e betimit.

(Pas ndërhyrjes, pa kyçje të mikrofonit)

Zoti Mujota, falemnderit në vërejtje. E kemi tejkaluar këtë fazë në mandatin e kaluar dhe nuk do të ketë më miratim të rendit të ditës, por do bëhet ashtu që, nëse deputetët - jashtë renditjes së Kryesisë - kanë ndonjë çështje të ngutshme ose të ngjashme, në fazën e hapjes së këtillë – këtë mund ta bëjnë.

Propozim tjetër të rendit të ditës nuk do të ketë, sepse do të mundohemi që rendin e ditës gjithmonë në një seancë të mëparshme ta përcaktojmë dhe atëherë kur për këtë kemi mundësi. Pra, këtë Kryesia do ta propozojë dhe kështu do të punohet.

Prandaj, vazhdojmë me betimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Unë do të dal në foltore ta lexoj këtë dhe teknika le bë tëhet gati.

Mendoj se të gjithë deputetët duhet të ngriten në këmbë, ashtu siç e keni të shkruar, dhe do të procedojmë.

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

(Deputetët përcjellin fjalët e kryetarit të Kuvendit dhe të njëjtat i përsërisin)

Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, i zgjedhur me votën e lirë, sot - solemnisht – betohem se me ndershmëri e me sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri, me tërë qenien time, me të gjitha aftësitë e mia do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve, do të angazhohem në mbrojtjen dhe rrespektimin e kushtetushmërisë e të ligjshmërisë, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, në garantimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut, në pajtim me ligjet e vendit dhe me standardet europiane.

**B e t o h e m!**

(Të gjithë deputetët e pranishëm – njëzërit: – B e t o h e m)

Lus deputetët që ta nënshkruajnë betimin dhe pastaj t'i dorëzohen Sekretarisë.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

– Zgjedhja e zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës.

Konform Rregullores së PSSP, nr. 204/50, Kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj i është drejtuar Kuvendit me propozim për emërimin e zëvendësministrave në Qeveri. Lus zotin Haradinaj të paraqesë propozimin për emërimin e zëvendësministrave.

Zoti kryeministër, kërkoj falje për një moment, sepse zoti Haliti, anëtar i Kryesisë dëshiron të marrë fjalën.

### XHAVIT HALITI:

Unë nuk e di si është rregullorja dhe së pari nuk e kemi rregulloren dhe nuk e di a duhet ne t'i miratojmë zëvendëskryeministrat apo s' duhet t'i miratojmë. Në qoftë se nuk i miratojmë me votim, dhe nuk iu japim mandat, do të thotë legjitimitet çfarë kanë ministrat, atëherë unë mendoj

se është çështje e Qeverisë dhe e koalicionit i cili ka arritur marrëveshje dhe nuk besoj se do të duhej tash të votojmë ne për zëvendëskryeminsitra, më falni për zëvendësministra.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe në Kryesi u shtrua kjo çështje. Unë ceka me qëllim Rregulloren që e ka shpall Përfaqësuesi special.

(Reagim, pa kyçje të mikrofonit)

Të gjitha udhëzimet i kam kështu sikur që po veprojmë. Xhavit, nuk po e kundërshtoj, do të thotë unë po veprojmë sipas asaj marrëveshjeje që është arritur, sipas nevojave të Kuvendit dhe sipas asaj që është në rend dite. Prandaj, ju lus të procedojmë ashtu siç është paraparë dhe nuk besoj se bëjmë gabim. Megjithatë, një përgjegjësi komplete i shtrohet Qeverisë në Parlament, por kjo është vetëm mendim, kurse unë po veprojmë në bazë të dokumentacionit. Urdhëroni Kryeministër.

#### KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, zëvendëskryeministra, ministra, Kemi bërë përgatitje të duhura dhe janë evidentuar kandidatët për zëvendësministra nga koalicioni qeverisës dhe sjell para jush propozimet për kandidatët veç e veç:

- Zotri Hafiz Krasniqi, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, ekonomist i diplomuar;
- Zotri Astrit Ajeti, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Shëndetësisë, është doktor;
- Zotri Muharrem Ibrahim, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë për Ekonomi e Financa, është ekonomist i diplomuar;
- Zotri Fevzi Berisha, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Zotri Aziz Lila, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Pushtetit Lokal;
- Zotri Merxhan Avdyli, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor;
- Zotri Kadri Kryeziu, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë;
- Zotri Agron Dida, është kandidat për zëvendësministër i Ministrisë së Energjetikës dhe Minerave;
- Zotri Lulzim Leci, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

- Zotri Mark Komoni, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Shërbimeve Publike;
- Zonja Angjelina Krasniqi, është candidate për zëvendësministre në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Zotri Ibish Bajrami, është kandidat për zëvendësministër për Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve;
- Zotri Tomë Hajdaraj, është kandidat për zëvendësministër në Ministrinë e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Zotri Ergyn Koruglu, është kandidat për zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente, dhe
- Zotri Nazmi Fejza, është kandidat për zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve.

Ftoj kandidatët për zëvendësministra të prezentohen me radhë para nesh.

(Radhiten të gjithë zëvendësministrat e propozuar)

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Dëgjuam propozimin e Kryeministrit, si propozim i Qeverisë mbi baza të propozimit të koalicionit qeverisës, prandaj ju ftoj të përcaktohem i për zëvendësministrat e propozuar.

Të pranishëm në sallë janë 101 deputetë.

Tani vë propozimin në votim.

Kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Një votë është kundër.

A ka abstenime? Falemnderit.

Më lejoni t'ju informoj se për zëvendësministrat e propozuar, kanë votuar 66 deputetë.

Një votë është kundër dhe 34 abstenime.

Prandaj zëvendësministrave të zgjedhur iu uroj ushtrimin e detyrës.

(Duartrokitje)

Pika vijuese e rendit të ditës është: - Betimi i Qeverisë.

Lus Kryeministrin, zotin Haradinaj, që të lexojë tekstin e betimit të Qeverisë. Zoti Kryeministër foltorja është e juaja. Ministrat dhe zëvendësministrat të ngriten në këmbë, ju lutem.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:**

(Ministrat dhe zëvendësministrat, përcjellin Kryeministrin duke lexuar nga libri i betimit)

Betim i Qeverisë së Kosovës.

Ne - anëtarët e Qeverisë së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, b e t o h e m i solemnisht se: me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t'i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe vendimet e miratuara, duke rrespektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci – në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të popullit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës. B e t o h e m!

(Të gjithë: B e t o h e m!)

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit Kryeministër.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës – Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës.

Sipas marrëveshjes nga Seanca inauguruese, Qeveria e Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar për shqyrtim Programin e Qeverisë së Kosovës.

Prezentimin e këtij Programi do ta bëjë Kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj. Zoti Kryeministër, fjala është e juaja.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:**

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, zëvendëskryeministra dhe ministra, Jam i nderuar që sot po i drejtohem këtij Kuvendi si Kryeministër i Kosovës dhe që në fillim dua të jap premtimin se së bashku me partnerët e koalicionit do të punojmë parreshtur në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në këtë kohë, ne gjithësesi duhet t'i kujtojmë të gjithë ata që u flijuan për lirinë e vendit dhe të gjithë ata që me vite punuan pa kursyer asgjë që një ditë populli i Kosovës t'i gëzohet lirisë dhe pavarësisë. Ne iu kemi borxh të përjetshëm të gjithë atyre që rënë në altarin e lirisë që të bashkohemi në detyrat tona të përbashkëta për të krijuar një shtet me shoqëri demokratike dhe tolerante.

Sot, për herë të parë, në historinë tonë të re të Kosovës, kemi një Qeveri dhe një opozitë. Unë pres që opozita do të ofrojë zgjidhje alternative dhe se do të jetë konstruktive në veprimet e saj, si dhe do t'na nxisë në punën tonë për të mirën e përbashkët. Opozita ka premtimin tonë se kjo Qeveri do ta trajtojë atë si pjesë integrale të demokracisë sonë.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës ka bërë gati Programin e saj, në të cilin ka bashkuar aspekte programore për qeverisjen e suksesshme në tri vitet e ardhshme, për zhvillimin e Kosovës në të gjitha fushat e jetës, për një zhvillim që do të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të vazhdueshme. Programi në vete ka të shkrirë agjenden e standardeve për Kosovën që do të mundësojë realizimin e tyre me sukses.

Po ashtu, Programi i Qeverisë siguron bërjen e Kosovës shtet në proces duke mundësuar vendosjen për statusin final në përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës. Në programin e Qeverisë nuk është përfshirë platforma për negociata për statusin final të Kosovës, sepse një platformë e tillë do t'i prezentohet Kuvendit të Kosovës në kohën e duhur. Planet vepruese të ministrive veç e veç sigurojnë zbatimin e këtij programi. Programi i Qeverisë së Kosovës është real, ai është në përputhje me kapacitetet buxhetore të Kosovës si dhe në pajtueshmëri me synimet e përgjithshme të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ne kemi lënë pas një periudhë të arritjeve të rëndësishme - përmbylljen e suksesshme të fazës emergjente, të ndërtimit të pasluftës dhe tejkalimit gradual të pasojave të rënda të luftës, kemi mbajtur zgjedhje të lira dhe demokratike dhe kemi bërë hapa cilësor në ndërtimin e institucioneve në nivel lokal dhe qendror. Ne përballemi me probleme jo të vogla, para se gjithash me stagnimin në rritjen ekonomike dhe përkeqësimin e gjendjes sociale, joefikasitetin në shkallën e duhur të strukturave qeverisëse, transferin e ngadalshëm të kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet vendore, problemet e integritetit të minoritetit serb dhe kthimin e të zhvendosurve nga Kosova, ekzistencën e enklavave jashtë tërësisë institucionale të Kosovës dhe me pasojat që sjellën ngjarjet e marsit. E gjithë kjo shpreh ndërlikueshmërinë e realitetit të Kosovës.

Programi i Qeverisë së Kosovës reflekton edhe brengat e popullatës dhe në veçanti fatin e të ardhmes politike të Kosovës, problemet e papunësisë dhe të varfërisë, si dhe problemet që ndërlidhen me situatën e përgjithshme në Kosovë. Programi, gjithashtu është i bazuar edhe në rekomandimet dhe hulumtimet e institucioneve hulumtuese të pavarura të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare. Qeveria është e vetëdijshme për periudhën sfiduese nëpër të cilën është duke kaluar vendi, për kufizimet për veprim efektiv, për resurset e kufizuara, por edhe për gatishmërinë e institucioneve, pozitës dhe opozitës, partive tjera politike dhe shoqërisë civile që të ndërtojmë vendin dhe të përballemi me këto sfida. Ne jemi të vetëdijshëm po ashtu për rëndësinë që ka vazhdimi i mbështetjes ndërkombëtare për Kosovën.

Me qëllim që të sigurohet implementimi efektiv dhe të kemi rezultate në periudhën sa më të shkurtër, Programi promovon objektiva të prekshme dhe prioritete të veprimit. Kemi nevojë të ngutshme të shohim rezultate më bindëse në zbatimin e standardeve, sidomos në forcimin e shtetit ligjor, në thellimin e tolerancës ndëretnike dhe në sigurinë më të madhe për minoritetet.

Për zbatimin me sukses të këtij Programi janë inkurajuese orientimet dhe veprimet e bashkësisë ndërkombëtare për transfer substancial të kompetencave të rezervuara, krahas progresit me forcimin e kapaciteteve të institucioneve, me qëllim që Qeveria të bëhet përgjegjëse për zbatimin e këtij programi. Ne duam t'i marrim këto përgjegjësi dhe i vlerësojmë veprimet e PSSP-ës drejt rritjes së rolit të institucioneve dhe të Qeverisë në sektor buxhetor dhe fiskal dhe në krijimin e atmosferës konstruktive të bashkëpunimit, veprim ky që e rritë përgjegjësinë dhe angazhimin tonë. Jemi të përkushtuar që t'i adresohemi çështjes sfiduese dhe brengat e qytetarëve të Kosovës dhe të jemi përgjegjës edhe para bashkësisë ndërkombëtare.

Fati ynë lidhet edhe me integrimin tonë në proceset Euroatlantike. Ne do të bëjmë gjithçka që është e mundur që ta përmirësojmë situatën e rëndë sociale dhe të krijojmë një platformë që përcakton për një konsensus të gjerë shoqëror për zbutjen e shpërpjestimeve në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nevoja për zbatimin e standardeve tanimë është kuptuar seriozisht nga ana e qytetarëve dhe institucioneve të vendit. Kjo duhet të jetë agjendë mobilizuese për të gjithë, duke patur parasysh objektivat madhore për arritjen e pavarësisë së Kosovës në të cilën të gjithë do të jenë në shtëpinë e vet të sigurtë dhe me shansa të barabarta për progres. Një Kosovë e tillë do të jetë faktor i stabilitetit në rajon, do t'i inicojë proceset pozitive të bashkëpunimit dhe të fqinjësisë së mirë aq të nevojshme për rajonin. Situata stabile dhe siguria e kënaqshme për të gjithë është parakusht për zbatimin e standardeve për Kosovën, por edhe për sigurimin e rritjes ekonomike dhe të investimeve. Do të mirren masa të nevojshme për përmirësimin e sigurisë dhe parandalimin e situatave të krizës dhe dhunës të cilat rrezikojnë jetën dhe pronat e qytetarëve. Kosova nuk ka perspektivë me imazhin e dhunës. Duhet të nxirren të gjitha përvojat dhe mësimet nga ngjarjet e marsit si nga ne ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe për këtë Qeveria e Kosovës do të krijojë atmosferën ku shprehja e protestave të qeta dhe të lira do të jenë të mundshme për qytetarët, për grupet dhe për komunitetet sipas procedurave ligjore, por Qeveria do ta bëjë të qartë se përdorimi i dhunës dhe rrezikimi i rendit nuk janë të lejueshme.

Qeveria do të kërkojë që në këtë kuadër të përmirësimit të situatës në Kosovë pushteti dhe autoriteti i institucioneve të Kosovës të shtrihet në gjithë territorin e saj. Mbi këtë bazë duhet të integrohen edhe territoret e Kosovës në veri dhe qyteti i Mitrovicës në rendin juridik dhe institucional. Ne do të jemi të vendosur për këtë.

Qeveria e Kosovës konfirmon gatishmërinë për bashkëpunim të plotë me Tribunalin e Hagës në pajtim me rendin ndërkombëtar.

Të vetëdijshëm për përgjegjësinë e koalicionit qeveritar para Kuvendit dhe qytetarëve promovojmë këto prioritete të veprimit.

Si prioritet të parë kemi – standardet dhe statusin.

Pastaj me radhë:

- Forcimin e institucioneve;
- Përmirësimin e qeverisjes dhe plotësimi i kuadrit ligjor;
- Ndërtimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe të shtetit ligjor;
- Rritjen ekonomike dhe punësimi;
- Arsimin dhe edukimin, sipas standardeve ndërkombëtare;
- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës;
- Forcimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë dhe avancimin në procesin e integritimit evropian dhe Auroatlantik si dhe ndërtimi i raporteve të mira me fqinjët;



*Standardet dhe statusi.-*

Zbatimi i planit të standardeve do të jetë përkushtim operativ dhe ditor i Qeverisë, duke siguruar një bashkërenditje të veprimeve dhe monitorim efektiv ndërinstitucional. Do të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë me UNMIK-un dhe institucionet tjera të Kosovës por edhe të të gjitha organizatave në angazhimin e të gjitha instrumenteve qeveritare dhe strukturat civile të shoqërisë së Kosovës.

Duhet të jemi të qartë se zbatimi me sukses i standardeve do të reflektohet pozitivisht në statusin përfundimtar politik, në rrugën evropiane të Kosovës dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në performansat e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse.

Qeveria do të krijojë klimë të qëndrueshme politike për arritjen e suksesit në zbatimin e standardeve brenda një kohe të shkurtër.

Qeveria do të krijojë një agjendë të saktë dhe të realizueshme që kuadri i domosdoshëm ligjor të kompletohet duke iu dhënë përparësi ligjeve që dalin nga standardet për Kosovën. Kritike do të jetë ndjekja aktive e prioriteteve të standardeve, ndërtimi i partneritetit me UNMIK-un rrespektivisht me bashkësinë ndërkombëtare dhe faktorizimi më substancial i Qeverisë nëpërmjet transferimit të kompetencave dhe kompletimit të Qeverisë me ministri të nevojshme.

Bazë për përcaktimin e statusit të Kosovës do të jetë vullneti politik i popullit të Kosovës për pavarësi dhe njohja e pavarësisë së Kosovës.

Kosova dhe Qeveria e Kosovës do të punojnë që të kemi marrëdhënie të mira me fqinjët dhe po ashtu marrëdhënie të mira me BE, SHBA, Grupin e Kontaktit, NATO dhe OKB.

*Forcimi i institucioneve.-*

Forcimi i institucioneve është synim i parë i Qeverisë dhe këtë përmes kompletimit të Qeverisë edhe me ministrinë e nevojshme. Ne po ashtu do të veprojmë që të përmirësohet kultura e qeverisjes dhe të shtohet efikasiteti i administratës shtetërore.

Formimi i ministrive të reja do të jetë në funksion të ushtrimit të kompetencave të transferuara në këto institucione dhe në kuadër të këtij prioriteti Qeveria do të fokusohet sidomos në:

- ngritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës institucionale; kompletimin e Qeverisë me ministri tjera të nevojshme;
- fillimin e punës për hartimin e kushtetutës së Kosovës – me inkoorporim të standardeve dhe normave evropiane dhe paralelisht me propozimin për definimin e statusit final dhe aprovimin e kushtetutës;
- funksionimin e ekonomisë së tregut, rritjen e efektivitetit në qeverisje;
- marrjen e masave korigjuese dhe preventive me qëllim të realizimit efektiv të objektivave;
- krijimin e parakushteve për lehtësimin e rolit monitorues dhe korrektues të UNMIK-ut në pajtim me mandatin e tij. Pra, gradualisht transformim të mandatit të UNMIK-ut në mandat monitorues.

Ndërtimi i një administrate publike të përgjegjshme, të shtetit ligjor dhe lufta kundër korrupsionit,  
- do të arrihet përmes:

- ndërtimit të një administrate që do t'i përballonte përgjegjësitë e reja edhe me rastin e transformimit të kompetencave;
- ngritjes së nivelit të organizimit, të aftësive dhe të kapaciteteve institucionale, si dhe individuale të punëtorëve të administratës publike, duke inkuadruar edhe përpjekjet për rritjen e mundësive buxhetore për të krijuar më shumë denjëtet në këto shërbime, përmes evitimit të menaxhimit të papërgjegjshëm të buxheteve dhe të përfitimeve personale nga prona shoqërore dhe publike dhe zbatimi i saktë i dispozitave ligjore për të eliminuar konfliktet e interesave private dhe publike;
- luftimit energjik të praktikave korruptive, në të gjitha nivelet në shoqëri në përgjithësi duke krijuar një aleancë të gjerë me opinionin publik, mediat dhe shoqërinë civile;
- forcimit të sundimit të ligjit; përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve;
- rritjes së sigurisë së pronës, si dhe
- mbrojtjes institucionale të të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

#### *Rritja ekonomike dhe punësimi.-*

Rritja ekonomike dhe punësimi - konsiderohen si shtylla të rëndësishme të stabilitetit të përgjithshëm në shoqëri. Të gjitha potencialet e vendit dhe përkrahja ndërkombëtare duhet të kanalizohen për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe hapjes së një perspektive për punësim produktiv. Kërkesat për punësim në këtë moment janë të papërballueshme për shoqërinë dhe ekonominë kosovare nëse nuk sigurojmë rritje ekonomike dhe investime në infrastrukturë dhe arsimim më të mirë për rininë tonë. Vetëm në këto rrethana mund të ndjeken me sukses reformat shoqërore për ndërtimin e një qëndrueshmërie në zhvillim ekonomik dhe të ndjekes së një politike aktive dhe fokusim në: mbështetjen e hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe përfundimit të studimeve sektoriale, në energjetikë, mbrojtjen e ambientit, planit hapsinor, bujqësisë, ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe të sektorëve për aftësi konkurruese si dhe eksportit dhe sektorëve tjerë. Pra, të përfundojnë studimet sektoriale që do të jenë bazë për hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës. Këto studime janë në zhvillim e sipër.

Adresimin e barrierave për zhvillimin e bizneseve dhe tërheqjen e investimeve të jashtme – nëpërmjet:

- përmirësimit të mjedisit afarist;
- korigjimit të politikave fiskale në favor të importit të pajisjeve dhe teknologjive të reja;
- përmirësimit të bizneseve dhe përmirësimi i politikave tregtare me fokusim në nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me vendet tjera;
- funksionalizimit të agjencisë për promovimin e investimeve dhe të eksportit si dhe ndërtimin e identitetit tregtar të Kosovës në marrëdhëniet me vendet tjera;
- dinamizimi të procesit të privatizimit, të ndërmarrjeve shoqërore si dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike – si obligim nga standardet për Kosovën, me një rrjedhë normale e dinamike më të shpejtë, si dhe shfrytëzimin racional dhe efektiv të fondeve që krijohen nga privatizimi, duke tejkaluar bllokimin e tyre joracional;

- transformimit të rolit të tashëm të AKM, në një rol monitorues, edhe në sektor të privatizimit. Pra, në pajtim me transformimin e rolit të UNMIK-ut në monitorues, ky rol të transformohet edhe tek AKM;
- afirmimit të rolit aktiv të Qeverisë në raport me kompetencat fiskale që mbahen në kuadër të këshillit ekonomik fiskal dhe që do të transferohen në ministrinë dhe institucionet e Kosovës;
- zbatimit të ligjit mbi financat publike;
- avancimit të procesit buxhetor dhe evitimin e dualizmit në menaxhimin e tij;
- raportimit, transparencës, eliminimit të evazionit fiskal, pengimit të aktiviteteve biznesore jolegale dhe të ekonomisë joformale.

Përmirësimi i pozitës së bujqësisë, në kuadër të politikave fiskale, duhet të shoqërohet edhe me masa shtesë për të siguruar një qëndrueshmëri në zhvillimin rural dhe të bujqësisë. Do të targetohen disa sektorë të bujqësisë që mund të përmirësojnë aftësinë konkurruese, siç është rasti me blegtorinë, pemtarinë, prodhimin e perimeve, atë të qumështit dhe të produkteve karakteristike që mund ta ndërtojnë emrin e vet në treg.

Formimi i ministrisë së energjetikës dhe minierave, është rast i mirë për adresimin e problemeve bazike në funksionimin e këtyre sektorëve. Janë të nevojshme disa veprime urgjente lidhur me zvoglimin e humbjeve teknike dhe komerciale për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të KEK-ut dhe definitivisht ndërprerjen e angazhimit të mjeteve buxhetore për këtë kompani dhe kompanitë tjera publike.

Në funksion të ndryshimit të situatës aktuale, paralelisht duhet sforcuar detyrimin administrativ të pagesës së borxheve tani të papërbalueshme për KEK-un për energjinë e shpenzuar. Kjo kërkon shqyrtimin e mundësive për formimin e një skeme subuencionuese për rastet sociale.

*Arsimi, shkenca, teknologjia, rinia, kultura dhe diaspora.-*

Në këta sektorë, Qeveria do të ndërmarrë masa të përqëndruara në tejkalimin e vështirësive dhe dobësive lidhur me aspektet menaxhuese të infrastrukturës dhe teknologjisë mësimore e financiare dhe vazhdimin e reformimit të arsimit në të gjitha nivelet; përmirësimin e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe të gjeneratave në arsimin e lartë; kujdesin e shtuar ndaj arsimimit të minoriteteve; përmirësimin e kushteve të punës në institucionet shkollore publike; inkurajimin e iniciativave private me një mbikëqyrje institucionale të punës dhe misionit të tyre si dhe vazhdimin e participimit të studentëve në mbulimin e shpenzimeve të studimeve.

Universiteti publik dhe institucionet e arsimit në Kosovë duhet të depolitizohen dhe të realizojnë më me sukses rolin e tyre të madh në zhvillimin e Kosovës, duke rritur kështu edhe kredibilitetin e tyre brenda vendit dhe jashtë tij dhe duke punuar për integrimin e tyre në hapësirën evropiane të arsimit; që të aprovojë dhe zbatojë programe e kërkimeve shkencore, duke reflektuar prioritetet dhe synimet strategjike zhvillimore të Kosovës, të cilat do të mbështeten nga fondet publike dhe të tjera shtesë – bazuar në partneritetet me bizneset dhe fondacionet ndërkombëtare.

Në kuadër të kulturës, do të mbështetet pasurimi i identitetit kulturor të qytetarëve; mbrojtja dhe restaurimi i objekteve të trashigimisë kulturore dhe kombëtare; nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar kulturor si dhe restaurimi i objekteve fetare të shkatërruara më herët apo edhe gjatë ngjarjeve të marsit 2004.

Në kuadër të sportit, do të realizojmë synimin për ndërkombtarizimin e sportit kosovar dhe po ashtu duke i dhënë mbështetje sportit në Kosovë do të fokusohemi në evidentimin e parregullsive në sport dhe në gara sportive.

Në kuadër të diasporës, qeveria do të angazhohet për mbështetjen e projekteve që kanë të bëjnë me mësimin plotësues, kulturën, ruajtjen e trashigimisë kulturore dhe kombëtare për diasporën tonë.

Do të ndërmerren masa për pajisjen e diasporës me dokumente të udhëtimit dhe të shërbimeve të tjera civile dhe do të punohet për tërheqjen e më shumë investimeve private nga diaspora. Për këtë, Qeveria e Kosovës do të vendosë kontakte të drejtpërdrejta me qeveri të vendeve ku është e përqëndruar diaspora jonë për të gjetur zgjidhjet edhe të ndërmjetshme për çështjen e pajisjes së tyre me dokumentacionin përkatës.

#### *Reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi.-*

Kujdes i veçantë do të tregohet ndaj bartjes së kompetencave në drejtim të pushtetit lokal, me qëllim që pushteti t'u ofrohet të gjithë qytetarëve, veçanërisht minoriteteve, duke rritur mundësinë e veprimit të tyre institucional për qasje të barabartë në shërbime dhe për realizimin e të drejtave të tyre mbi parimet e multietnicitetit.

Decentralizimin e kuptojmë si praktikë për reformën e pushtetit lokal, duke përmirësuar qeverisjen dhe rritjen e participimit të qytetarëve në vendimmarrje. Ky reformim duhet të fillojë me nxjerrjen e legjislacionit, siç janë ligji mbi pushtetin lokal, ligji mbi financat publike dhe ligjet tjera. Do të vazhdohet puna rreth rumbullaksimit të një koncepti mbi decentralizimin, duke inkuadruar në proces të gjitha institucionet, administratën ndërkombëtare, shoqërinë civile por edhe minoritetet. Në kohë të duhur do të bëhen veprime konkrete mbi bazë të konceptit mbi reformën e pushtetit lokal. Mbështetje për veprim mund të gjejnë vetëm zgjidhjet që mbështeten nga qytetarët e Kosovës dhe institucionet e vendit, por edhe bashkësia ndërkombëtare.

Veprimi i shtetit ligjor, garanca për krijimin e progresit në zbatimin e standardeve dhe ndërtimin e një qëndrueshmërie demokratike dhe socioekonomike është forcimi i shtetit ligjor; forcimi i sistemit juridik; forcimi i efektshmërisë dhe efikasitetit të gjykatave, të prokurorive dhe të organeve të sigurisë publike.

Prioritet i Qeverisë do të jetë luftimi i korrupsionit në administratën shtetërore, por po ashtu edhe luftimi i krimit të organizuar e të rënd, kriminalitetit ekonomik, sulmeve ndaj jetës e pasurisë së qytetarëve pa dallim përkatësie etnike, gjinore apo politike.

Me prioritet do të trajtohen çështjet dhe kontestet pronësore lidhur me uzurpimet e paligjshme, duke zbatuar me urgjencë rikthimin e pronave të uzurpuara dhe duke punuar për kthimin e të të shpërngulurve edhe të minoriteteve, përfshirë edhe tejkalimin e ngecjes në kthimin e qytetarëve serb të Kosovës të shpërngulur nga Kosova.

Qeveria në Program ka një qasje të veçantë për kategoritë meritore për lirinë e Kosovës. Do të veprojë në bazë të përgatitjeve të bëra, për kujdes ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjeve të martirëve dhe të të zhdukurve. Po ashtu, Qeveria ka ndërmarrë veprime dhe do të punojë për ta zgjidhur më shpejt çështjen e personave të zhdukur dhe për këtë do të kërkojë edhe angazhimin më të vendosur të faktorit ndërkombëtar.

Do të angazhohemi për aplikimin e legjislacionit dhe praktikave jodiskriminuese në punësim, ku do të ketë hapësirë edhe për pakicat në shërbimet publike, në përdorimin e gjuhës, në informata qeveritare, në treg dhe po ashtu në zhvillimin e inisiativës private.

Ministritë, veç e veç, kanë planet vepruese në të cilat parashihen të gjitha veprimet e nevojshme për të gjitha lëmitë që i mbulojnë ato.

*Partneriteti dhe bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare.-*

Qasja e Qeverisë së Kosovës për tejkalimin e sfidave dhe krijimin e një stabiliteti demokratik, politik dhe socioekonomik bazohet në forcimin e partneritetit me komunitetin ndërkombëtar, në veçanti me BE, SHBA, NATO, por edhe me Organizatën e kombeve të bashkuara dhe organizata, institucione dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të reflektojë siguri dhe stabilitet, paqe të qëndrueshme, fqinjësi të mirë dhe ajo që ka rëndësi praktike dhe strategjike për Kosovën – sukses në zbatimin e standardeve dhe hapjen e perspektivës integruese Europiane dhe Euroatlantike. Ne do të jemi përgjegjës ndaj rendit ndërkombëtar dhe do të veprojme në pajtim me ambiciet tona për forcimin e imazhit të Kosovës si vend demokratik dhe prosperues.

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Ju ftoj t'i jepni pikëpamjet tuaja për Programin e Qeverisë së Kosovës dhe ju siguroj se ne me vëmendje do t'i marrim mendimet dhe pikëpamjet tuaja, por po ashtu më lejoni që t'ju siguroj se Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga unë – është e vendosur që ta realizojë me sukses Programin e Qeverisë, të përmbushë standardet për Kosovën dhe ta bëjë realitet shtetin e Kosovës. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryeministër, ju falemnderit shumë.

Para se të hapim debatin, desha t'ju lus për diçka. Është mirë që çdo deputet të ketë shansin për debat dhe për këtë t'i lajmëroheni Sekretarisë. Partia Demokratike e ka bërë një listë. Po ju premtoj se do të ketë debat sa të doni, por me argumentim dhe sa orë të ketë të nevojshme, por po ashtu po ju përkujtoj që debati për shefat e grupeve parlamentare do të zgjasin 10 minuta, për shefat e komisioneve po ashtu deri në 10 minuta, për deputetët 5 minuta, kurse – meqë kemi patur sistem elektoral partiak – unë propozoj, edhe pse nuk e kemi të shkruar, që kryetarët e partive mund ta tejkalojnë dhjetëminutëshin, do të thotë të kenë 15 minuta. Këtë unë e thash si parim, dhe do të vlejë për të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe shefave të partisë, kurse tjerët vetëm 5 minuta.

I lus të gjitha grupet që të paraqiten në mënyrë që të jetë një debat homogjen dhe do të lutja, aniqë s'i kemi të aprovuara komisionet, në veçanti deputetët, të përcaktohen më tepër në ato lëmi ku janë propozuar anëtarët e komisioneve, sepse të gjitha sygjerimet që mund ta përmirësojnë programin e Qeverisë - besoj Qeveria do t'i konsiderojë shumë seriozisht, sepse kemi një qasje – që ta ndihmojmë Kosovën dhe jetën e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, duhet t'u përmbahemi këtyre rregullave dhe pa humbur kohë të vazhdojmë.

Nga Sekretaria rrjedh një ide që të jipet një pauzë prej 15 minutash, deri sa të regjistrohen të gjithë, nëse ju e aprovoni. Ju lutem, jo më tepër se 15 minuta! Ju falemnderit.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë ju lus që t'i zënë ulëset të gjithë deputetët dhe anëtarët e Kryesisë.

Tani mendoj se duhet të vazhdojmë me debatin mbi Programin e Qeverisë dhe ia jap fjalën kryetarit të Partisë Demokratike, zotit Thaqi, edhe pse sipas forcës do të duhej të jetë LDK, por për këtë kur të jetë në nivel të shefave, atëherë do të shikojmë. Foltorja është e juaja zoti Thaqi.

HASHIM THAQI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Për Partinë Demokratike të Kosovës është inkurajues fillimi entuziast i punëve protokollare të Qeverisë së re.

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, do të theksoj disa nga opinionet e përgjithshme për Programin e Qeverisë së re të Kosovës.

Në vend që Programi qeveritar të prezentohet e debatohet fillimisht, e pas aprovimit të Programit të zgjedhet Qeveria, siç e don rendi e rregulla demokratike parlamentare, këtu tek ne ndodhi e kundërta. Sikur jemi duke i kushtuar më tepër rëndësi shfaqjes së jashtme sesa ndërtimit të institucioneve të njëmendëta shtetërore.

Programi qeveritar është një përkthim i mirë, por është abstrakt. Nuk ka substancë. I mungon vizioni, më tepër i ngjanë një punimi studimor teorik sesa programit politik e zhvillimor. Programet qeveritare nuk ndërtohen vetëm nga hulumtimet e opinionit publik për t'i treguar brengat e qytetarëve, siç bën kjo strukturë qeverisëse, por duke i hulumtuar ato dhe duke na bindur me gjetjen e formave më të mira dhe adekuate për zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve dhe afatizimin e tyre.

Prandaj, formimi dhe hapat e parë të kësaj Qeverie vazhdojnë të përcillen me shqetësim, ankth, dilema e mosbesim në sukses. Veprimet fillestare të nxitueshme të kësaj Qeverie kanë krijuar opinionin brenda dhe jashtë, sikur Qeveria është kundër të gjithëve – e të gjithë kundër Qeverisë. Prandaj, ndonjë sukses i pozitës nga Partia Demokratike e Kosovës nuk do të kuptohet si humbje e saj. Ne do të sprovijmë konkretisht përgjegjësinë kombëtare dhe kulturën politike, sipas parimit – interesi qytetar mbi të gjitha. Çdo disfatë e pozitës është në një formë edhe disfata e jonë.

Për Partinë Demokratike të Kosovës, ofrimi i alternativave shtetbërëse për vendin është dhe do të jetë përkushtim kombëtar e standard demokratik, e jo refuzimi mekanik i pozitës. Kjo do të jetë edhe filozofia politike dhe e punës së qeverisjes së mirë nga Partia Demokratike e Kosovës. Por, për Partinë Demokratike të Kosovës nuk është e mirëpritur ajo qasje e Qeverisë e cila është e orientuar që problemet e qytetarëve t'i zgjidhë në baza etnike, e jo sipas konceptit modern qytetar. Kjo sfidë nacionalromantike sjell thellim të ndarjeve etnike dhe përcillet me rreziqe për integritetin territorial të Kosovës.

Krahas vërejtjeve që do të prezentohen prej Partisë Demokratike të Kosovës, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës për Qeverinë e re të Kosovës sjell këto rekomandime plotësuese për Programin vijues të saj.

Partia Demokratike e Kosovës, vlerëson se duhet të qartësohen edhe më mirë këto aspekte të Programit të Qeverisë, duke bërë këto rekomandime dhe plotësime në vijim:

1. Të bëhet program qeveritar angazhimi kryesor për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe të integruar në strukturat Veriatlantike; Kosova duhet të krijojë të plotë identitetin shtetëror. Të gjithë qytetarët e saj të jenë shtetas të Kosovës; Të garantohen të drejtat për shtetësi të dyfishtë, me marrëveshje bilaterale, sipas nevojës dhe vullnetit për ata që janë lindur në Kosovë, që janë pasardhës të prindërve të lindur në Kosovë dhe të cilët shprehin vullnet të marrin shtetësinë e Kosovës;
2. Të specifikohen edhe më qartë dhe në mënyrë më të avancuar të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët. Kosova vend shumëetnik dhe shumëfetar dhe të gjithë duhet të angazhohemi kundër diskriminimit në baza të identitetit etnik, gjinor, racor ose fetar. Në Kosovë duhet të ketë mbrojtje të garantuar dhe veprime afirmative për pakicat dhe me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe përkushtimin e Qeverisë të arrihet nënshkrimi i Kartës evropiane të të drejtave të njeriut dhe paktit mbi të drejtat civile dhe politike si dhe traktateve tjera relevante; Qeveria do të duhej zotuar më vendosmërisht se Kosova do të jetë shtet ku gjuha shqipe dhe ajo serbe do të jenë gjuhë zyrtare; Pjesëtarët e komuniteteve tjera do të kenë të drejtë të praktikojnë dhe komunikojnë në gjuhët e tyre në të gjitha nivelet e institucioneve të Kosovës;
3. Sa i përket sundimit të ligjit, do të duhej të bëhet një zotim më specifik dhe konkret për:
  - Ndërtimin e bazës ligjore dhe legjislacion me interes të të gjithë qytetarëve;
  - Përkushtimin dhe afatizimin e periudhës kohore për nxjerrjen e një kushtetute në përputhje me atë të shteteve demokratike perëndimore;
  - Gjyqësinë e pavarur e të paanshme të përgjegjshme ku të gjithë qytetarët do të jenë të barabartë para ligjit;
  - Masa rigorozë antikorrupsion në të gjitha segmentet e institucioneve me zbatim të barabartë në të gjitha nivelet;
  - Zotimin dhe afatizimin kohor për hedhjen poshtë të të gjitha ligjeve serbe të aplikueshme në Kosovë. Edhe sot e kësaj dite për fat të keq ende ligjet e kohës së Millosheviqit janë të aplikueshme në “drejtësinë - në thojza – kosovare”;
  - Pjesëtarët e strukturave paralele, e “rojave të urës” që si destabilizues për vendin të dirigjuara nga Serbia të kemi përkushtim të qartë dhe konkret të Qeverisë për t’u ballafaquar me ligjin;
4. Sa i përket funksionimit të qeverisjes së Kosovës, si shoqëri moderne, duhet patur parasysh veçanërisht:

- funksionimin e shërbimit civil modern dhe profesioinal, me status të mbrojtur me ligj;
- të ndalet fushata e qeveritarëve të rinj të motivuar politikisht për largimin nga puna të njerëzve profesionist të administratës publike;
- zotimin që në të ardhmen, në bashkëpunim me partitë politike, shoqërinë civile, me mekanizmat ndërkombëtar – të ndodhin reforma në sistemin zgjedhor me aplikimin e listave të hapura për një parlament më të përgjegjshëm ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve;
- pagat në sektorin publik të jenë konkurrenente me ato në sektorin privat;
- shoqëritë aktive civile dhe mediat të jenë plotësisht të lira dhe të pavarura;
- të hiqet dorë nga praktika e qeveritarëve të rinj që këtyre ditëve ushtrojnë trysni për kontrollin ndaj mediave por edhe të mos lejohet më tutje korrupsioni publik. Për korrupsionin publik më mirë e dijnë editorët e gazetave të ndryshme.

5. Në pjesën e Programit për zhvillimin ekonomik, duhet patur kujdes:

- Prioritetin e inkuadrimit të plotë të Kosovës në eurozonë me euro si valutë;
- Përshpejtimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet fqinje dhe vendet tjera;
- Rrespektimin dhe mbrojtjen me ligj të pronës private;
- Lehtësimin e investimeve ndërkombëtare;
- Krijimin e kuadrit favorizues për sipërmarrjen e lirë dhe biznesin e vogël.

Qeveria do të duhej të kishte një program brenda Programit, të veçantë në kuptimin pozitiv favorizues për investime dhe zhvillim për zonat më të dëmtuara gjatë luftës së fundit. Atje ende ka skajshmërisht varfëri të theksuar. Shumë familje ende janë pa kulm mbi kokë. Një praktikë e tillë ka ndodhur në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, por ka ndodhur edhe në Gjermani ku në vitet e 90-ta, pas bashkimit të Gjermanive u hartuan programe të veçanta me qëllim të nivelizimit të zhvillimit të vendit. Po flas për Gjermaninë Lindore.

6. Në drejtim të mirëqenies sociale duhet të ketë asistencë sociale për qytetarët që nuk kanë mundësi t'i përmbushin nevojat elementare për veten dhe familjet e tyre; Pensionet e rregulluara me ligj; standarde evropiane të shëndetësisë; arsimit dhe sigurisë në punë; Përkujdesje shumë të theksuar institucionale për jetë më të mirë dhe dinjitoze për veteranët dhe invalidëve, Ushtrisë Çlirimtare .....

Me asistencë, mendoj se në programin e Qeverisë do të duhej patjetër të definohet qartë çështja e veteranëve dhe të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mos kihet turp që të futet formulimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të mos ketë ndajre familjare apo lokaliste në përkujdesjen ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës siç po ndodhë.



Gjithashtu përkujdesje edhe më e theksuar për familjet e viktimave civile dhe invalidët civil të luftës,

7. Në aspektin e mbrojtjes dhe të sigurisë kufitë ekzistues të Kosovës të mbrohen në përputhje me parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, garancionet e sigurisë nga NATO -ja duke përfshirë dhe zhvillimin e forcës mbrojtëse të Kosovës, sot TMK të integruar në të ardhmen e afërt në NATO. Partneriteti i plotë me NATO-m përmes iniciativës së Evropës Juglindore si pjesë aktive dhe e përgjegjshme e përpjekjeve ndërkombëtare kundër terrorizmit.

8. Bashkëpunimi me shtetet fqinje duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të njeri tjetrit, me Shqipërinë, angazhimi i Qeverisë për thellimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat institucionale dhe të integrimi kombëtar me Maqedonin, mbështetjes së marrëveshjes së Ohrit nga institucionet e Kosovës, institucionet e Maqedonisë të reflektojnë drejtë për njohjen e vullnetit të qytetarëve të Kosovës për statusin politik dhe natyrisht të hapen zyrat e ndërlidhjes ndërmjet dy vendeve në Prishtinë, Shkup.

Me Malim e Zi, hapja e zyrave ndërlidhëse në Prishtinë dhe Podgoricë do të krijonte mundësitë e komunikimit normal dhe të bashkëpunimit bilateral çarkullim të lirë të mallrave dhe të njerëzve bashkërenditje të luftës kundër krimit të organizuar, shpresojmë me një respekt dhe njohje reciproke do të ndodh ndaj aspiratave të drejtave të qytetarëve të dy vendeve për vetëvendosje dhe integrim në strukturat Euroatlantike. Me Serbinë bashkëpunim në fushat e interesit reciprok.

Zonja dhe zotërinjë, pasi që të gjithë në Kosovë presin që statusi politik të zgjidhet në vitin 2005, e Partia Demokratike e Kosovës është e bindur se janë krijuar rethanat adekuate të përshtatshme solide që komuniteti ndërkombëtar të respektoj dhe vlerësojë pozitivisht ndërtimin e standardeve për Kosovën, Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se Qeveria do të duhej të zotojë se Kosova si shtet i Pavarur dhe Sovran pretendon të bëhet anëtar i kombeve të bashkuara të nënshkruaj marrëveshjen për asocim stabilizim të jetë anëtar i ardhëshëm i Bashkimit Evropian, të inkuadrohet në mekanizmin e partneritetit për paqë, të bëhet anëtarë i ardhëshëm i Organizatës të Traktatit Veriatlantik të vazhdojë bashkëpunimin me Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore.

9. Përkrahje më kuptimplotë nga Qeveria për integrimin e të kthyerve dhe mbrojtjen e trashigimisë kulturore të komuniteteve.

Kthimin e qendrueshëm dhe të sigurtë të të gjithë të zhvendosurve në shtëpitë dhe pronat të tyre. Integrimin efektiv të të kthyerve në shoqërinë dhe institucionet e reja të vendit, mbrojtjen dhe respektimin e trashigimisë kulturore dhe fetare të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të theksojnë çartë se refugjatëve të kthyer institucionet partitë politike shoqëria Kosovare do t'ju ofrojnë bashkëpunim integrim, fqinjësi të mirë, tolerancë qytetare por nuk ka mundësi reale për sigurimin e vendeve të punës apo mirëqenies sociale afirmative se sa për qytetarët tjerë që jetojnë në Kosovë.

10. Kosova shtet i ri i cili mirëpret angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për garantimin e paqës dhe të sigurisë për ngritjen dhe forcimin e kapacitetit të Kosovës në këto fusha në partneritet me institucionet e Kosovës.

Asistencë të vazhdueshme ndërkombëtare në forcimin e institucioneve demokratike gjyqësore dhe civile, asistencë të vazhdueshme ndërkombëtare për rimkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe të infrastrukturës, në këto rekomandime në emër të PDK do t'ia prezentojmë edhe kabinetit Qeveritar, ju falenderoj për vëmendje.

## VETON SYRROI

Zonja dhe zotërinjë, i nderuar kryetar, e nderuara Qeveri, janë dy çështje të cilat janë të avancuara në këtë program qeverisës krahasuar me atë të kaluarën.

I pari është se është shumë më i konkretizuar siç kishim rast më herët është autoktonë dhe ka rrjedhë në një kohë relativisht të shkurtër dhe për këtë Qeveria meriton përgëzime.

Disa prej çështjeve të cilat preken në këtë program qeverisës dhe të cilat tregojnë për burimin e programit qeverisës e burimi i programit qeverisës në masë të madhe është rrjedhë e rekomandimeve të cilat qeveria e kaluar kjo Qeveri ka marrë qoftë nga OJQ-të të ndryshme qoftë nga institucionet ndërkombëtare të pranishme këtu.

Është për të lavdëruar kapacitetin apsorbuës të Qeverisë ndaj propozimeve të organizatave joqeveritare dhe më duket se kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Disa prej mungesave strukturore të këtij programi qeverisës megjithatë mbesin, këtu premtohet hartimi i strategjive në fushat e ndryshme, strategji e zhvillimit ekonomik, strategji e zhvillimit hapësiror energjetik e të tjera dhe kjo është një nevojë e madhe e Kosovës megjithatë tregon dy probleme fundamentale me të cilat do të ballafaqohet kjo Qeveri.

E para është se duhet të shpenzojë një kohë bukur të madhe në hartimin e këtyre strategjive, ai i zhvillimit ekonomik posaqërisht dhe dy si do të punojë në këtë kohë të ndërmjeme, si do të punoj Qeveria në mungesë të strategjive.

Problemi i dytë strukturore e këtij programi Qeverisës është se kemi formulime të përgjysmuara lidhur me hapjen e vendeve të reja të punës nxitjen e zhvillimit ekonomik, nxitjen e zhvillimeve të bujqësisë etj, Formulimet e përgjithësuara të cilat janë pak a shumë të njejtë me ato që i rekomandon banka botërore apo fondi monetar me cilin do vend të botës të tretë apo vend të pa zhvilluar, dmth. Programi qeverisës nuk e reflekton konkretësinë e Kosovës por mer modele të veprimit të cilat do të përdoren në cilin do vend të pazhvilluar në botë.

E meta më e madhe e këtij programi qeverisës është se në masë të madhe juridikisht do të jetë qeveri ose qeverisje e kontinuitetit në kuptimin juridik të fjalës.

Koncepti juridik i propozuar në këtë program qeverisës është koncept i cili vazhdon të mbajë dy tri apo katër sisteme juridike të ndryshme brenda territorit të Kosovës. At çka nuk e kemi këtë program qeverisës për kundër, premtimit se do të hartohet Kushtetuta e Kosovës është unifikimi i sistemit juridik kosovar, edhe po të hartojë Kushtetuta e Kosovës në një afat shumë të shkurtër megjithatë Kosova do të duhej të kalonte nëpërmjet të unifikimit të sistemeve të ndryshme legale në Kosovë, që nga ato të vitit 1989 e deri te ato regulloret e UNMIK-ut ky është obligim edhe e kësaj Qeverie edhe të këtij parlamenti.

Koncepti siç e thashë i zhvillimit ekonomik nuk përputhet me urgjencën që ka Kosova në disa prej fushave elementare por mer përsipër formulat e dhëna nga banka botërore apo nga viset e ndryshme, edhe e meta e tretë evidencuar nga aspekti strukturor është se ekziston një shpërputhje që ka marrë Qeveria dhe kapacitetit intelektual apo menagjerial të disa prej anëtarëve të Qeverisë të cilët nuk mund ti përgjigjen këtyre sfidave.

Si do të reflektohet mungesa unifikimit të një sistemi juridik në një qeverisje do të mund të shifet fare lehtë në një koncept të thjeshtë se çfarë përdorim edhe në këtë program edhe në të folmen e përditshme e kjo është ndërmarjet publike.

Në Kosovë zonja dhe zotërinjë nuk ekzistojnë ndërmarjet publike, ekzistojnë ndërmarje të cilat do të duhej të ishin publike por nuk kanë asnjë instrument kontrolli publik dhe këtu tregohet çasja e një qeverie. Kjo qeveri ose do të njoftë gjendjen faktike, gjendja faktike është se ne nuk kemi ndërmarjet publike, KEK-u PTK-ja RTK-ja janë ndërmarje të cilat në masë të madhe apsorbojnë para publike por nuk janë ndërmarje të cilat mbikëqyren nga ana e publikut dhe kjo do të ishte një detyrë qeveritare, dhe tash po hy në pika konkrete.

Mendoj se në këtë program qeverisë nuk jepen përgjigje për këto pyetje çfar do të jenë masat stimulative për ritjen e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme posaçërisht sa mund të jenë më stimulative se që janë ato në rajon, dmth. Ato duhet kontekstualizu problemin e stimulimit. Çfarë do të jetë stimulimi infrastrukturor, çfarë ai fiskal, çfarë ai i politikës kreditore. Si mund të vazhdohet me procesin e privatizimit siç premtun Qeveria, nëse ky koncept i privatizimit nuk e parashef të drejtën pronsore kosovare është i kontestueshëm nga ana e UNMIK-ut dhe është i drejtuar kah shitja e patundshmërisë, e jo shitja e kapacitetit prodhues ekonomik me çka do të degratohet edhe më tujtje struktura prodhuese e Kosovës.

Si do ta përfshijë Qeverija AKM brenda vehtes, në kuadër të cilës ministri, me çfarë ndërlidhje me kryeministrin dhe me çfarë kompetencash karshi pronës joprivate.

Si do të eliminohet deficiti enorm. Më imadhi në Evropë, në balansin e pagesave gjegjësisht në raportin në mes eksportit dhe importit. Si do të krijohen kushte për investime direkte të brendshme, mos të flasim për ato të jashtme çfarë dotë bëhet me monopolet, Qeverija presupozon se Kosova do të ketë monopole në energjetikë dhe monopole në telekomunikacion, ndonë se është paraparë një proces i liberalizimit por në këtë fazë parashifet dhe në program të Qeverisë parashihet gjithësesi një lloj intervencionizmi në fonde publike p.sh. në pikën që ka të bëjë me zhbllokimin e mjeteve dhe të privatizimit apo në pikën që ka të bëjë me bujqësinë.

Qeverija parasheh ndërhyrje direkte në ato mjete me çka rrezikohet që ato mjete të treten fare. Në vend të kësaj mendoj se Qeveria do të ishte e udhës të ndërmarë një rikoncetualizim i cili do ti shef mjetet e zhbllokuara si pjesë e një fondi zhvillimor e jo si pjesë e mjeteve buxhetore.

Përgjigje nuk kemi dhe çfarë do të bëhet me sistemin bankar nuk mund të thuhet vetëm se duhet të ndihmohet zhvillimi i mëturjeshëm dhe do të formohet banka qendrore, ne kemi realisht probleme me sistemin e tanishëm bankar i cili më shumë i shërben themeluesve të bankave se sa të qytetarëve në tërësi.

Si do të zhbllokohet vendimarrja në komuna relacioni në mes pushtetit qendror dhe atij lokal si mund të reflektohet kjo në komunën e Prishtinës e cila mënyrë kontinuele gjatë 5 vjetëve të kaluara është simbol jo vetëm i korupsionit jo vetëm i degradimit të jetës qytetare në të por një simbol i një organizimit të përgjithshëm në shoqërinë tonë në sistemin tatimor.

Çka do të mund të bëhet në vend që të flitet për masat stimulative tatimore si do të përgjigjet Qeveria një çështje shumë të thjeshtë e ajo është si do të shtrohet tatimi i vlerës së shtruar në tërë gjerësinë dhe në tërë thellësinë e ekonomisë së Kosovës.

Sugjeroj që ky program t'i rikthehet Qeverisë, të konkretizohet, të afatizohet Qeveria të na tregoj se në cilën periudhë të kohës të ndërmerr cilën masë nga këto dhe të specifikohen çështjet kyqe për të cilat kërkohet një koncenzus i përgjithshëm në Kosovë, siç është privatizimi, transformimi i

ndërmarrjeve të clat konsiderohen se do do të duhej të ishin publike etj, etj. dhe në fund mendoj se nuk mund të flitet për korrupsion në sistemin tonë apo në luftë kundër korrupsionit nëpërmes të një agjencie. Unë mendoj se kjo Qeveri dhe ky Parlament duhet të shkëpus kontinuitetin me korrupsionin e qeverisjes së kaluar dhe këtë duhet ta bëjë nëpërmjet raportit e së paku 4 ministive ku kan qenë shefa njerëz nga parti të ndryshme dhe të demonstron nëpërmjet rivlersimit të tërë procesit të ritenderimit p.sh: në Ministrinë e Arsimit, në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe në ate të Telekomunikacionit dhe Lidhjeve, a ka ekzistuar apo jo siç është përfolur gjatë këtyre 3 viteve një indikator aq i lartë i korrupsionit sa ta hetoj popullata. Unë mendoj se është obligim i Qeverisë që të prezentoj një raportim të këtillë në mënyrë që të tregoj se nga dita e parë e ka parashikuar luftën kundër korrupsionit si një luftë reale e jo si një vizion të ndërtimit të një strategjie apo të një agjencie. Ju faleminderit.

## KRYETARI, NEXHAT DACI

Para se t'ju jap fjalën shefave të grupeve. Unë i propozoj z. Surroi që nga procesverbali të hiqet fjalia ku e merr rrolin e prokurorit sepse ky është dokumentacion zyrtar, të mos emërtohen, korrupsioni të luftohet mbi të gjitha bazat ligjore, normative, pajtohem me krejt ate, por të mos figurojnë ministri dhe komunë, sepse ajo kërkon pastaj procedurë të veçantë, kryetarët e partive duhet programin dhe vërejtjet ti japin dhe ne të mundohemi që t'i aplikojmë, prandaj ju lutem që herave tjera të mos merremi me këto çështje. Unë e kam këtë të drejtë por dua që edhe z. Surroi të pajtohet me te, në mënyrë që ne të jemi efektiv dhe efikas në të gjitha të metat që i kemi pasur gjatë periudhës së kaluar që të mos përsëriten.

Një skjarim, lus që edhe shefat e grupeve parlamentare të dalin në foltore, deputetët do të diskutojnë nga vendi dhe një numër i caktuar i kartelave secilit do t'i jepet, por lus deputetët që diskutimin ta bëjnë në këmb, fillojmë me prof. Gashin.

z. Surroi, po e përsëris (Kryesuesi Nexhat Daci) unë po ju lus që atje ku keni përmendur emra të veçant, janë theksuar komunë e caktuar dhe ministri të caktuara, në qoftë se keni argumentim, ky argumentim le t'i dorëzohete parlamentit dhe ne do ta paraqesim në procedurë të rregullt ku duhet, d.m.th me pëlqimin tuaj të fshihet nga pjesa zyrtare e dokumentacionit të Parlamentit ajo fjali ku përmendni emra keni të drejtë me insistu por atëherë e merrni obligimin që me e sigurue dokumentacionin.

## VETON SURROI

Unë nuk jamë për heqjen e emrave siç thash zgjedhja e ministrive është bërë në mënyrë që të identifikohet që nuk është çështje e një partie, unë flas për hulumtime të perceptcionit për korrupsion në këto ministri, nuk flas për hulumtime të cilat identifikojnë korrupsion në këto ministri, prandaj nuk jamë për heqjen e emrave por po e riformuloj kështu. Kërkoj nga Qeveria që të formoj grupe të cilat do të rivlersonin procesin e tenderimit në këto ministri për të tregu lidhur me bazueshmërinë apo jo të perceptcionit për korrupsion në këto ministri dhe natyrisht për komunën e Prishtinës. Unë nuk e eliminoj besimin tim apo mosbesimin tim në procesin tenderues. Unë them se ekziston një perceptcion për korrupsion në këto ministri dhe në komunën e Prishtinës, atëherë po e la anash se ajo ishte vetëm ilustrim i degjenerimit në shoqërinë tonë, por në mënyrë që kjo Qeveri të filloj me duar të pastra apo me një projekt të duarve të pastra në

qeverisje do të duhej të jepte raport për perceptcionin e keq qeverisjes së mundshme në Qeverinë e kaluar.

## KRYETARI, NEXHAT DACI

Perceptimi është e drejtë individuale, kjo nuk ka implikime në dokumentacion. Unë po ju propozoj që të jetë përgjithësim që Qeveria e re mund të bëjë vlersime dhe të mos përsëriten, por prap po ju lus pa emra të ministrive dhe të komunave, edhe në perceptcion do të jetë në dokumentacion keq

por megjithatë në perceptcion keni të drejtë, nuk kërkoj të shlyhet por po ju lus që të keni mirkuptim dhe të mos fillojmë menjëherë me këtë por është e drejtë e juaja.

## ALUSH GASHI

Falënderoj kryeministrin për paraqitje lidhur me atë se çka duhet bërë për ta bërë Kosovën vend më të mirë për të gjithë. Janë impesive objektivat e shtruar, realizimi i të cilave do ta bënë vendin tonë më të mirë dhe të pranueshëm. Në këtë proces do të mirprisnim ofrimin e argumenteve të nevojshme për të dëshmuar mundësinë e realizimit të asaj që nevojitet dhe dëshirohet sot këtu, gjë që të cilën e presin qytetarët e Kosovës dhe Bashkësia Ndërkombëtare.

Z. kryetar, shkalla e zhvillimit të një vendi varet nga niveli i zhvillimit të diturisë shkencore dhe aplikimit korrekt të saj. Andaj edhe kërkojmë një përkushtim më të theksuar në ngritje të nivelit të gjithmbarshëm të edukimit institucional, sepse për ndërtim të shoqërisë demokratike nevojitet dije në të gjitha lëmitë. Jetojmë në kohë të ndërvarshmërisë globale, është koha e dijes z. Kryetar. Z. Kryeministër edhe përkundër kufizimeve eventuale kushtetuese do ta mirëprisnim paraqitjen e vizionit nëse edhe jo vendimin e Qeverisë për strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë së Kosovës për hapjen e përfaqësive të Kosovës, jashtë vendit në veçanti në Bashkimin Evropian, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si dhe vizionin e Qeverisë për zbatimin e ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës dhe mbi të gjitha do ta mirëpresim argumentimin për mundësinë e hapjeve të vendeve të punës për të cilat flitet sot këtu. Z. Kryetar të vetëdijshëm se shansa e Kosovës është demokracia e qëndrueshme ku të gjithë qytetarët do të kenë shans të njëjtë dhe do të jenë të barabartë para ligjit, angazhohemi që në vendin tonë të ketë paq, drejtësi dhe prosperitet.

Jemi të përkushtuar të dëshmojmë se jemi shumicë e përgjegjeshme. Nga Qeveria kërkojmë transparencë dhe efikasitet dhe me këto parime mbështetet përkrahja e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe me këto parime mbështetet vota jonë për ju. Ftojë deputetët e Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në debat dhe me begatim të këtij programi të cilin grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet dhe për të cilin do të voton. Ju faleminderit.

## JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar, z. Kryeministër dhe ministra, zonja dhe zotërinj deputet.

Edhe neve na vjen mirë që u prezentua një program që është shpresëdhënës nga ajo që shihej dhe që u fol edhe këtu për të ardhmen e Kosovës, për përparimin e saj edhe neve pse jemi opozitë avansimi i të gjitha procesve në Kosovë është qëllim i yni i kahershëm dhe jo vetëm i sotshëm. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, duke lexuar me vëmendje programin e Qeverisë së koalicionit sikur në disa segmente kemi formuar bindjen se hartuesi i programit të

Qeverisë së koalicionit nuk ka pasur informacione të mjaftueshme për punën dhe aktivitetin e Qeverisë së shkuar.

Unë sot do të përpiqem duke shkëputur pjesë nga programi që mendoj se duhet të ndryshohen. Që në hyrje të programit Qeveria konstaton se Kosova gjindet para sfidave të vështira dhe para momenteve historike po e citoj nga programi: “Kur duhet të bëjë hapa vendimtarë në realizimin e

vullnetit politik të qytetarëve të vet për ndërtimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike”. Vullneti politik i secilit popull realizohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur të deputetëve në Parlament ose përmes referendumit gjithëpopullor. Këtu nuk është thënë asnjëra në program.

Në paragrafin e 4 pika 2.1 bie në kundërshtim me atë që thuhet në hyrje. Tani thuhet: “Qeveria do të bashkëpunoj me UNMIK-un dhe komunitetin ndërkombëtar që bisedimet lidhur me statusin

përfundimtar të Kosovës të fillojnë në kohën e paraparë”. Kur është paraparë ajo kohë, kush duhet ta zgjidh statusin e Kosovës, qytetarët e Kosovës me referendum apo Qeveria me UNMIK-un dhe komuniteti ndërkombëtar.

Kjo nuk është e sqaruar. Më von thuhet se gjatë 5 viteve të kaluara, ky është konstatim, UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes përmbyllën me sukses fazën emergjente. Në 5 vitet e kaluara në Kosovë ka pasur të arritura, ka pasur suksese por ta ndërtosh programin e Qeverisë mbi premisen e gabuar se në Kosovë është përmbyllë faza emergjente do të thotë të mos dish nga duhet nisur do të thotë mos njohjen e realitetit në Kosovë dhe krejt programi të nisur nga premisa të gabuara sa të jetë i mirë dhe i realizueshëm një program i tillë unë nuk dua ta paragjykojë, por duhet të them se në Kosovë vazhdon të jetë faza emergjente, shumë shtëpi të kategorisë së pestë janë të parindërtuara, të pandërtuara, jo të gjithë familjet kanë kulëm mbi kokë si pasojë e luftës. Emergjente është zbardhja e fatit të të zhdukurve ç’ështëja e pensionistëve, fondet e grabitura ç’ështëja e invalidëve të punës e fëmijëve jetim e invalidëve të luftës çlirimtare, e familjeve të dëshmorëve e të përndjekurve politik që në këtë program nuk përmenden fare, rryma elektrike është më shumë se emergjente, Kosova shpeshherë është pjesa dërmuese e saj në terr, rrimkëmbja e ekonomisë dhe punësimi, zgjedhja pronësore- juridike të gjitha këto janë çështje emergjente dhe Kosova nuk i ka zgjedh.

Ndoshta për ne që gjindemi në këtë sallë të Kuvendit kemi përmbyllur me sukses fazën e ndërtimit emergjent, por kjo nuk mund të thuhet për shumë qytetarë nuk e kanë zgjidhur çështjen ma emergjente edhe shumë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ata që na kan sjellur këtu në këtë parlament në institucione me mundin, gjakun dhe pjesët e trupit të tyre. Në paragrafin e 3 të hyrjes përmendet një varg pengesash si transferi i ngadalshëm i kompetencave. Unë duke qen në Qeveri them me bindje se problemi nuk ka qen te transferi i ngadalshëm i kompetencave, problemi ka qen të mosbesimi, mosbashkpunimi që administrata e Kosovës e ka pasur me institucionet e përkohshme vetëqeverisëse. Natyrisht përgjegjësia më e madhe i bie atij që është i fuqishëm dhe e fuqishme ishte administrata ndërkombëtare ose drejtuesve të lartë të kësaj administrate.

Në fakt të parët në shumë segment kan rehabilituar ish struktura pa i pyetur institucionet vendore e as vullnetin e qytetaraëve. Si problem në program ceken ngjarjet e marsit, ne jemi të bindur se ngjarjet e marsit nuk ishin probleme, ato ishin pasojë e problemeve të shumta e të pazgjidhura, problemet tjera që nuk përmenden ishin:

Vendi i djegur, ekonomia e shkatërruar dhe plaçkitur, fondet e plaçkitura pensionistëve dhe qytetarëve, dokumentet e plaçkitura dhe të shkatërruara, marrëdhëniet ndërnjerëzore, ndëretnike krejt të çrregulluara, as nga këto e shumë të tjera nuk janë pasojë e ngjarjeve të marsit. Pasojat e ngjarjeve të marsit, ato që ishin për riparim u riparuan në fakt se për 10 muaj, vetëm jeta e

njerëzve nuk mund të riparohet. Edhe ky Program ndër problemet kryesore ka një segment të pakicës nuk mund të thuhet se ky nuk është një problem nga të shumtë që ka Kosova.

Z. kryeministër vendor dhe ndërkombëtar, shumicë dhe pakicë duhet ta dijnë se pa e zgjidhur problemin e shumicës, pa krijuar një ambient të përshtatshëm për shumicën me perspektiv për

shumicën nuk mund të krijojmë një ambient të dëshiruar as për pakicën që bojkoton çdo iniciativë popullore ynë thotë: me zor, me dhunë mund t'i merrësh dikuj diçka, por nuk mund t'i japësh.

Diku në paragrafin e fundit të hyrjes në program thuhet: "Ky program reflekton programe elektorale të partive që marrin pjesë në koalicion" e them me bindje se programi që kemi përpara nuk reflekton atë që kemi ndëgjuar gjatë fushatës zgjedhore, kur i kemi mashtruar qytetarët, atëherë apo tani. Sa herë që përmendet Qeveria përmenden edhe ministrat. Qeveria përbëhet nga ministrat, ky gabim përsëriteet shpesh në program, gabime ka shumë por ne nuk po i trajtojmë ato. Gjatë gjithë fushatës prioritet kryesor keni pasur barrën e shtetit në veprim të Kosovës, është e kuptueshme se këtë e keni lënë për ma von. Ju në këtë pjesë vlersoni se po citoj: Zbatimi i standardeve paraqet një interes jetik për qytetarët ...Z. Krasniqi ju ka kalu koha,Z. Daci, ju lutem tju përmbahemi me krejtë respektin, ju ka kalu koha.

Xhavit Haliti

Z. kryetar unë kam një pyetje. Pse nuk është kryeministri në sallë, sepse programin e Qeverisë ai e përfaqëson dhe do të dëshiroja ta di se në qoftë se ka marrë leje, apo është i zënë me punë që të marrim pauzë deri sa të kthehet ai.

Kryetari, Nexhat Daci

Po, z. Kryeministër ka takim, do të kthehet, sepse është i interesuar që me vëmendje t'i ndëgjoj propozimet, por të gjithë ministrat dhe zëvendësministrat janë këtu, incizohet çdo gjë, do t'i dorëzohet, prandaj vazhdojmë.

Unë personalisht po ju kërkoj falje, kam thënë se është e programuar 10 minuta,

Gjylnaze Sylaj

I nderuari kryetar i Kuvendit z. Daci, i nderuari kryeministër, të nderuari ministra dhe zëvendës ministra, të nderuari deputetë.

Do të fillojë duke vënë në rend të parë Kosovën qytetarin e saj në përfaqësuesit e zgjedhur në Kuvend kemi përgjegjësinë që gjatë këtij mandati të sjellin ligje të mençura efektive dhe të evropjanizuara që janë në shërbim të çdo qytetari të Kosovës, ne duhet të rindërtojmë komunitetet tona rurale dhe urbane ne duhet të krijojmë klimën e mirëbesimit përmes komunikimit më të mirë ndërmjet komuniteteve shumicës dhe pakicës dhe të nxisim integrimin e bashkësive etnike sidomos asaj serbe në shoqërinë kosovare..

Kemi dëshirën dhe vullnetin për ta bërë këtë dhe do të përdorim të gjitha mjetet që kemi që integrimi të jetë i sukseshëm, por njëkohësisht ftojme qytetarët serbë të Kosovës të tregojnë dëshirën për të integruar në proceset demokratike dhe shoqërinë kosovare.

Kërkesat e qytetarëve për liri paqë të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik janë përgjegjësi e secilit qytetarë sidomos e jona që e përfaqësojmë atë por edhe e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, liria e të gjithëve duhet të jetë e siguruar dhe ligjet duhet të vlejnjë për të gjithë njësojë.

Të nderuar deputetë, përherë të parë në historinë tonë ne e kemi pozitën dhe opozitën, duam të jemi të qartë në deklarinimin tonë se ne i vlerësojmë anëtarët e opozitës së këtij Kuvendi si kolegët tanë.

Ne kemi përgjegjësinë e përbashkët për të vënë kornizën ligjore në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe për të mbajtur qeveri të përgjegjëshme, ne jemi lidhja mes qeverisë dhe të qytetarëve të Kosovës dhe nuk duhet të harojmë se së pari duhet të jemi besnik ndaj qytetarëve që na zgjodhën.

Viti 2005 është për Kosovën vit i sfidave të mëdha, por i pritjeve dhe shpresave të mëdhaja, andaj ne duke kuptuar rëndësinë e momentit të tanishëm gjatë mandatit tonë në këtë Kuvend do të promovojmë agjentin e bashkëpunimit konstruktiv të ndarjes së përgjegjësi të tejkalimit të

ndryshimeve dhe ballafaqimit me sfida dhe vendime që përcaktojnë të ardhmen e vendit tonë. Duke shërbyer ne kemi kuptuar një të vërtetë të thjeshtë por të fuqishme, i duhemi njëri tjetrit dhe duhet të punojmë me njëri tjetrin, sepse duke bërë kështu njëkohësisht kujdesemi për qytetarët e Kosovës.

Besimin tonë në realizimin e qëllimeve të përbashkëta e mbështesim në vlerat e popullit të Kosovës, në parimet që na bashkojnë dhe na udhëheqin në qeverisjen e popullit. Besimin e mbështesim edhe në miqët tanë ndërkombëtar që u dëshmuar në kohët më të vështira për ne, në NATON, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Unionin Evropian.

Andaj të nderuar deputet, vlera kryesore që do të udhëheqë veprimet tona në Kuvend do të jetë çdo vendim një standard më të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Z. Kryetar ne mbështesim programin e Qeverisë dhe sot ju ftojme të gjithëve që të na bashkoheni. Nuk pretendojmë se në këtë program nuk ka asgjë për t'u shtuar, por është program i mirë, është progresiv, nxit dinamikën e veprimit dhe është përgaditur në interesin më të mirë të të gjithë qytetarëve. Në vijim dua të shtoj në veçanti arsyet përse e mbështesim programin. Agjendja dhe prioritetet strategjike të përcaktuara promovojnë proceset demokratike në Kosovë dhe plani i veprimit është udhërrëfyes për ndërtimin e shoqërisë inkluzive. Vizioni i qartë dhe efektiv për rritjen ekonomike krijon kushtet për përmirësimin e cilësisë së jetës, ky vizion mbështetet nga strategjia e Qeverisë për rritjen ekonomike nga 1 në 3% në 4 deri 6% dhe GJIDIPIN më shumë se 7% deri në vitin 2006. Masat e parapara krijojnë kushtet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes shtyllave si:

1. Krijimi i infrastrukturës ligjore që garanton sigurimin e investimeve, Ligji për garantimin e investimeve, Ligji për konsesionet,

2. Politika programore për nxitjen e zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

3 Stimulimi i bizneseve përmes shkarkimit të bizneseve dhe nga tatimi dhe doganat, shërbimet efikase tatimore në mes zhvillimit të kapaciteteve të administratës tatimore, sistemi efektiv i prokurimit,

4. Menagjimi efikas i buxhetit të Kosovës,



5. Politika efikase monetare kreditore dhe përmes krijimit të bankës qendrore, shëndërrimit të autoritetit të pagesave në Bank qendrore.

Plotësimi i kuadrit ligjor me 23 projektligje dhe akte prioritare të parapara deri kah mesi i vitit 2005 e bën shoqërinë tonë më funksionale, sepse nga këto këto 36% janë për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe stabile, 18% janë për siguri dhe shtetin ligjor, 13% për ekonomi dhe 13% për të drejtat pronësore. Hartimi i Kushtetutës me norma dhe standarde evropiane gjithashtu është paraparë. Për herë të parë Qeveria vë theksin në mënyrë të shkoqur në menjanimin e qasjes improvizuese në Universitet.

Synimi për thellimin e strategjisë së antikorrupsionit do të siguroj qeverisje të mirë dhe efikase. Në muajt që vijnë ne do të argumentojmë në favor të plotësimeve të caktuara në programin e Qeverisë, sidomos do të argumentojmë për:

1. Planin më të qartë të kompletimit të kornizës ligjore përfshirë aspektin kohor, përmirësimin e mekanizmave për mbikqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe indikatorëve që do të përdoren për matjen e progresit. Ligjet që sigurojnë konkurrencën, zhvillimin e strategjisë për hapjen e vendeve të punës.

Ligjet që sigurojnë konkurrencën, zhvillimin e strategjisë për hapjen e vendeve të punës, si kuvendar jemi të obliguar të gjejmë mënyrat për përmirësimin e legjislacionit dhe të bëjmë përpjekje për ta bindur Qeverinë për pikëpamjet tona. Ne do të ndëgjojmë me shumë kujdes dhe vemendje se çfarë do të thotë opozita dhe nuk do të hezitojmë të shprehim pajtimin tonë me opozitën nëse pikëpamjet e tyre janë konstruktive, megjithatë jemi të bindur se ky program është në interesin më të mirë të Kosovës.

Ne po hyjmë në një moment të rëndësishëm të historisë sonë, është koha kur pritet shumë nga ne si trup ligjvënës, më shumë se sa që është punuar në të kaluarën, është një program legjislativ i gjërë që kërkon më shumë punë në komisionin nga ky Kuvend. Ky program do të kërkojë bashkëpunimin e secilit këtu për të siguruar arritjen e progresit të nevojshëm të standardeve deri në vitin 2005. Është obligim i ynë që të punojmë gjatë e shumë dhe është i nevojshme për t'i përbushur detyrat tona. Populli i Kosovës tani më ka demonstruar vullnetin për vetëvendosje, marrëdhëniet e mira me fqinjët dhe dëshirën për anëtarësinë e plotë në familjen evropiane dhe evropatlantike. Populli i Kosovës respekton ligjet dhe konventat ndërkombëtare, të cilat bazohen në parimet e përgjithshme të vetëvendosjes siç janë 1) marrëveshja ndërkombëtare për kombet e bashkuara, për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore, 2) deklarata e principeve të ligjit ndërkombëtar në pajtim me kartën e kombeve të bashkuara, deklarata e kombeve të bashkuara për dhënien e pavarësisë së vendeve të kolonizuara dhe njerëzve 116, konferenca për sigurinë dhe bashkëpunimin në evropë paragrafi 8.

Ne si deputetë do t'i përdorim gjithë mekanizmat parlamentar dhe votën tonë për tu siguruar se Qeveria do të punojë si duhet në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Do t'i përmbushim obligimet tona ndaj qytetarëve dhe do të kërkojmë që Qeveria do ta bëjë të njejtën gjë. Ju faleminderit

Kryesuesi, Nexhat Daci,

Në emër të grupit parlamentar "ORA" Ylber Hysa në marrëveshje me shefin e grupit parlamentar dhe le të përgatitet pastaj Mahir Yakçilar

Ylber Hysa

I nderuari kryetar i parlamentit, të nderuar deputetë dhe përfaqësues të Qeverisë. Programi qeveritarë ndonëse në përpjekje për të përfshirë prioritete politike dhe ekonomike dhe si një prodhim vendor është përpiluar me një shpejtësi dhe kjo mbase e ka kushtëzuar ngecjen në një parashtrim që nuk përfillë korniza kohore për planifikim dhe implementim të politikave duke vënë në pah një varg inkonzistencash që krijojnë paqartësi sidomos në aspektet që unë kisha dashur të përqëndrohem në paraqitjen time e që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të sigurisë, të standardeve, decentralizimit.

Qeveria e rithekson disa herë gatishmerinë e saj për të përqaftuar politikën e standardeve dhe siç thuhet synon progres të mëtejme dhe të shpejtë të standardeve për Kosovën por, Qeveria është e vetëdijshme në programin e saj se politika e standardeve është afatgjate dhe dëshiron të fuqsohet në implementimin e prioriteteve të standardeve, rishtasi të adaptuar nga komuniteti ndërkombëtar, megjithëse në asnjë moment nuk ipen mënyrat konkrete të qasjes, angazhimit, instrumenteve mbi zbatimin e këtyre politikave.

Në anën tjetër në këtë pjesë të programit qeveritar theksohet se do të ketë bashkëpunim me UNMIK-un dhe komunitetin ndërkombëtar, që bisedimet lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës të fillojë në kohën e paraparë dhe që pasiguria dhe paqartësia e ambikuitetit lidhur me

statusin e Kosovës të evitohen për të shtuar më poshtë se vullneti politik i qytetarëve të Kosovës duhet të përcaktojë statusin dhe se Qeveria së bashku me UNMIK-un, bashkësinë evropiane, shtetet e bashkuara në grupin e kontaktit dhe në këshillin e sigurimit do të angazhohet për të filluar negociatat dhe shpejtuar vendimet për pavarësinë e Kosovës.

Së pari në raportin në mes të politikave dhe të standardeve dhe të qasjes ndaj statusit final hetohet një kohezistencë programore Nëse Qeveria zotohet me besnikëri ndaj politikës së standardeve, në asnjë moment nuk qëndron se do të përfillet vullneti politik i qytetarëve të Kosovës në përcaktimin e statusit final të Kosovës. Dilema bëhet më e madhe kur kësaj ti shtohet zotimi tjetër për angazhimin tjetër për bisedimet të shpejtuara një varg adresash me rëndësi të institucioneve ndërkombëtare, Qeveria nuk dallon në shpjegimin e saj nëse këshilli i sigurimit është adresa ku do të kërkohet zgjedhja për të filluar, siç thuhet negociatat e shpejtuara dhe vendimet për pavarësinë e Kosovës, apo siç thuhet edhe në bashkësinë evropiane shtetet e bashkuara apo grupin e kontaktit. Nëse është kështu atëherë pretendimi për të adresuar statusin në mënyrë të shpejtuar të elaboruar jo më shumë se disa paragrafe në programin qeveritar duket se i mungon serioziteti i qasjes dhe shtjellimit për të qenë bindës për një aprovim parlamentar.

Paragrafi tjetër se Qeveria do të zhvillojë dialog edhe me fqinjët ashtu që të forcohet bashkëpunimi, mbaron me kaq thotë se plani i standardeve favorizon një bashkëpunim më të elaboruar, duke i mundësuar qeverisë kosovare zhvillimin e një qasje me benefite politike dhe ekonomike Një qasje tjetër elaborohet në mënyrë të veçantë 2.8 ku flitet mbi avancimin në procesin integrimin evropian dhe erroatlantik dhe ndërtimin e raporteve të mira me fqinjët, ku theksohet se Qeveria ndër të tjera do të angazhohet për shumë iniciativa bilaterale e multilaterale, por i vetmi propozim konkret është ai mbi pjesëmarrjen e Kosovës në iniciativat ekzistuese mbi ballkanin perendimor si Pakti i stabilitetit dhe KARDS që për të gjithë ata që minimalisht kuptojë nga këto çështje mund të dijnë vlerën reale dhe benefitet nga ky lloj angazhimi.

Për sa i përket bisedimeve me Serbinë theksohet gatishmëria e diskutimit të marrëdhënieve bilaterale që përfillin edhe çështjet e luftës, marrëdhëniet fqinjësore e tjera, dhe në fund theksohet gatishmëria e vazhdimit të bisedave teknike brenda kësaj platforme. Mbetet e paqartë a është përfshirja në bisedimet teknike veprim taktik i kësaj çasje komplekse strategjike dhe çka do të

ndodhë nëse Serbia është e interesuar vetëm për bisedimet teknike, sidomos nëse kjo është insistimi i pikës 7 të planit për prioritetet e standardeve.

Dhe në fund një çështje, e cila është me një prioritet të jashtëzakonshëm, e cila së paku kështu është kundruar nga bashkësia ndërkombëtare viti 2005. Cila është strategjia për vitin 2005 në statusit final, nëse kjo qeveri e ka, çka mendon ajo të bëjë në vitin 2005? Çka nëse viti 2005 nuk do të ndodhë në për këtë asnjë fjalë e vetme në këtë program qeveritar.

Pika 2.7 ndërtimi dhe forcimi i stabilitetit politik dhe të sigurisë, ndërtimi i shoqërisë inkluzive me shansa të barabarta për të gjithë. Qeveria zotohet në akceptimin dhe përkrahjen e faktit se situata stabile e sigurisë e kënaqëshme për të gjithë është parakusht për zbatimin e standardeve për Kosovën, për sigurimin e një rritje ekonomike dhe të investimeve. Për këtë arsye Qeveria do të përcjellë zhvillimet në këtë sferë dhe do të inicioj masat e nevojshme për përmirësimin e sigurisë dhe parandalimin e situatave të krizës dhe të dhunës e cila rrezikon jetën dhe pronën e qytetarëve.

Më tutje në këtë pikë të elaboruar jo më shumë se një faqe sillen zotime të ngjashme për përfilljen e postulateve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe rendin por në asnjë moment më shumë se Qeveria do të mbështet zhvillimin e SHPK-së dhe aftësimin e saj, apo zbatimin e standardit të 8 për TMK-në që ka të bëjë me integrimin e pakicave dhe shkarazi një çasje për Mitrovicën.

Nëse është kështu atëherë si mendon Qeveria, ashtu siç thekson në këtë pjesë programore të mbështetë sigurimin e kushteve për kthimin e kosovarëve të shpërngulur si rezultat i situatës fragjile politike dhe të sigurisë, nëse ajo nuk do të ketë instrumente dhe politika që i lejojnë asaj që të jetë kompetente në zbatimin e sigurisë, forcimin e stabilitetit politik dhe ndërtimin e shoqërisë inkluzive dhe sidomos nëse theksohet se Qeveria për kthimin e “Qëndrueshëm” do të krijojë kushte paraprake të atilla që të gjithë qytetarët e saj të ndihen të lirë dhe të barabartë dhe të ndiejnë veten plotësisht në vendet e tyre.

I vetmi shpjegim i tërthorët ipet në pjesën që flet për pasojat e marsit të vitit të kaluar ku theksohet se Qeveria do të krijojë atmosferën ku shprehja e protestave të qeta dhe të lira do të jetë e mundëshme për qytetarët, grupet dhe komunitetet sipas procedurave ligjore, por Qeveria do të bëjë të qartë se përdorimi i dhunës dhe rrezikimi i rendit nuk janë të lejueshme dhe se ato do të parandalohen në mënyrë energjike.

Mbetet e paqartë si dhe me çfarë instrumente. Shpjegimi që pason menjëherë nxjerr më shumë pyetje se sa që jep përgjigje. Për këtë kërkohet përgjegjësia e organeve të sigurisë por edhe mbështetja e plotë e institucioneve tjera dhe të qytetarëve për to. Një çasje shumë verbale pa asnjë konkretësi.

Në kapitullin për pushtetin lokal dhe decentralizimin është konfuz dhe i shkurtër. Dilema është nëse ligji sistemor apo organik i paraprin pilot projektit, ose e kundërta nëse nuk i paraprinë cili do të jetë regjimi juridik që duhet të zbatohet në komunat pilot, kur Qeveria përdorë termin pilot komuna. Ekziston dilema a bëhet fjalë për komuna ekzistuese apo të reja që mund të krijohen sikurse Graçanica. Nëse po në bazë të cila kriteret, gjeografike, etnike demografike, ekonomike, politike, kulturore apo ndonjë kriterijumi tjetër për të cilin ne nuk dijmë. Nuk ka afatizim nga Qeveria për sa i përket harimit dhe implementimit të ligjit për pushtetin lokal dhe financat lokale. Në dokumentin kornizë flitet që në rastin e krijimit të pilot komunave do të meret mendimi i banorëve të komunave dhe nëse po si dhe ku mendon Qeveria të realizojë këtë të drejtë të qytetarëve. Decentralizimi deri më tani nuk është futur si prioritet në propozimet për planifikimin e standardeve, atëherë pse Qeveria i kushton kësaj pune kaq rëndësi.

Nuk bëhet fjalë për formimin dhe përshtatjen e organeve komunale që ato ti shërbejnë më mirë qytetarit dhe decentralizimit të mundshëm. Plani qytetar për decentralizim nuk përmend asnjë rast ministrinë e re të pushtetit lokal dhe kompetencat e saj mbikëqyrëse në lidhje me prerogativat e komunave dhe me procesin e decentralizimit në përgjithësi. Po kështu nuk u përmend as edhe partneritetin e mundshëm me asociacionin e komunave apo ndonjë organi tjetër kompetent qoftë edhe në formën këshilldhënëse. Nuk parashihen debate në institucione me opozitën, shoqërinë civile dhe grupet e interesit lidhur me decentralizimin, siç bëhet fjalë psh. në pjesët tjera të këtij programi qeveritar.

A do të thotë kjo se Qeveria do të mbajë mbi vete të drejtën ekskluzive mbi këtë aspekt me interes dhe a do të thotë se qëndrimi i shprehur në media i Kryeministrit në komunën e Graçanicës është shprehje individuale apo program qeveritar. Duke marrë parasysh se ky është një program qeveritar që ndër të tjera është paraparë të jetë shtyllë mbi të cilën mund të ndërtohet shqyrtimi i standardeve në vitin 2005, që ka të bëjë me përcaktimin e statusit final të Kosovës, konsideroj se inkonzistencat dhe planifikimet kohore duhet të shmangen për tu balancuar në mes të objektivit dhe mundësive që qeveria mund ti ketë në mesin e vitit 2005. Duke shpresuar se këto pyetje dhe dilema mbi disa paqartësi janë më shumë shprehje e një brengjeje dhe kontribut se sa vetëm kritik opozitare, dëshiroj t'ju falenderoj për vemendje.

Kryesuesi, Nexhat Daci

Mahyr Jakcilar

I nderuar zoti kryetar, i nderuari kryeministër dhe të nderuar kolegë deputetë!

Ju përshëndes në emrin e grupit parlamentar 6 + të cilin e përbëjnë deputetët me radhët boshnjake të koalicionit Vakrat dhe përfaqësuesve të KDTP. Para nesh kemi temë të rëndësishme për shqyrtim –programin e Qeverisë e së bashku me te edhe ardhmërinë e Kosovës.

Grupi parlamentar është i vetëdijshëm për seriozitetin e situatës në të cilën gjendet Kosova sot. Jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë për ta përmirësuar situatën dhe stabilitetin e Kosovës. Programin e Qeverisë e vlerësojmë si konstruktiv dhe serioz, njëherit konsiderojmë se në të njëjtin janë të përfshira të drejtat dhe interesat tona. Kryeministrit të Kosovës z. Ramush Haradinaj i japim përkrahjen tonë dhe e mbështesim programin e propozuar të Qeverisë, natyrisht me sygjerime dhe propozime konstruktive që ato të vijnë nga ana e deputetëve.

Ne si bashkësi me dy deputet të zgjedhur me 4 të rezervuar në parim e mbështesim shumicën në parlament pjesë e së cilës jemi sepse në një mënyrë na orjenton edhe Kushtetuta e përkohshme e Kosovës. Nuk dëshirojmë që të bëhemi pengesë e Qeverisë por dëshirojmë që edhe ne të japim kontributin tonë për realizimin e të gjitha aktiviteteve programore të cilat janë përfshirë në programin e propozuar nga ana e Qeverisë.

Mendojmë që gjithëherë ekzistojnë zgjedhje edhe më të mira, por për këtë të gjithë jemi prezent dhe se për rezultate të mira duhet të jetë Qeverija e fortë, ekspert dhe ata që me propozimet e tyre konstruktive do ta bëjnë programin të suksesshëm. Është me rëndësi që ajo që është shkruar si të realizohet. Gjithëherë është e rëndësishme të përcaktohet periudha kohore e realizimit të zgjedhjeve të ofruara dhe kuadrove gjegjëse. Jemi të mendimit që kjo Qeveri e ka përgjegjjen dhe dëshirën për realizimin e shumicës të zgjedhjeve të ofruara.

Sfida më e madhe, sikurse kuptohet nga programi i propozuar është realizimi i standardeve për Kosovën. Detyrë e jona është realizimi i standardeve në mënyrë që të mundësojmë një të ardhme

më të mirë për Kosovën. Mendojmë që kjo është detyrë e kuptueshme natyrisht dhe përgjegjje ndaj bashkësisë ndërkombëtare.

Grupi parlamentar gjithëherë do të jetë aktiv në Kuvend dhe Qeveri. Asnjëherë nuk do të jemi pengesë e zhvillimeve demokratike dhe e interesit për një të ardhme më të mirë për të gjithë banorët e Kosovës. Me siguri që si përfaqësues të zgjedhur të bashkësisë turke dhe boshnjake, gjatë punës kujdesin më të madhë do t'i përkushtojmë të drejtave dhe interesave të bashkësive turke dhe boshnjake por nuk do t'i përkushtojmë të drejtave dhe interesave të bashkësive turke dhe boshnjake por nuk do ti lëmë anash as përgjegjësitë tjera të cilat i kemi si qytetarët të

Kosovës. Zhvillimin dhe mbrojtjen e gjuhës turke dhe boshnjake, arsimimin në këto gjuhë, botimin e librave sipas programit Kosovar në këto gjuhë, zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës dhe identitetin e këtyre bashkësive.

Duke miratuar këtë program në emër të grupit përzemërsisht Ju përshtëndes dhe dëshiroj realizim të suksesshëm të këtij programi të propozuar.

Kalojmë në debatet e deputetëve.

Sabri Hamiti

Zotëri kryetar i Kuvendit, zotëri qeverisës, të gjithë me tituj që jeni ketu kolegë të nderuar,

Unë konsideroj që Kuvendi i Kosovës duhet të jetë një tempull i demokracisë si organi më i lartë përfaqësues legjislativ, ti aprovoj ligjet ndjek zbatimin e tyre, të kontrollojë punën e Qeverisë, të artikulojë interesin e qytetarëve dhe në fund të japë formën institucionale vullnetit politik të tyre.

Në Kuvend deputetët janë përfaqësues që kanë mbritur me sigla të partive që kanë programe të ndryshme dhe të nuansuara politike unë mendoj që definitivisht në Kuvendin e Kosovës duhet të krijohen mundësi që deputetët të shlirojnë fuqitë individuale të punës dhe të punës së përgjithshme për Kuvendin, që të kenë mundësi të tejkalohen kufizimet politike që janë kriju normalisht në një shumicë dhe në një pakicë.

Unë mendoj që është koha momenti edhe historik dhe aktual që në këtë Kuvend për çështjet e mëdha që e presin Kosovës që mund të krijohet bashkimi i shumicës absolute që tejkalon këto pjestime politike. Kujtoj që edhe në kuptimin nacional edhe në kuptimin përtej nacional ose të pakicave tjera këtu në këtë formë krijohet një shumicë absolute që mund të krijojë vendimet e mëdha. Një problem i dytë që këtu mund del në diskutet edhe të programit po edhe politike po edhe ato që ndodhin përditë në jetën praktike dhe shoqërore, problemi i standardeve.

Unë mendoj që standardi numër 1 kur është fjala, standardi është Kosova e Pavarur dhe të gjitha tjerat ose janë derivime të kësaj ose nuk kanë shansë që të të plotësohen por ne mund të vazhdojmë me fjalime rotorike rreth këtyre.

Standardet e tjera po them nëse projektohen si vonesa për statusin e Kosovës unë jam i bindur që nuk do të jenë bledhje kohës por do të jenë humbje e kohës për Kosovën dhe fundi i fundit ky qëndrim im është i rishpallur edhe një herë sot dhe i paraqitur në Kuvend edhe më herët, sepse partitë politike që janë në Kuvend e kanë obligim edhe qytetar edhe përfaqësues ma në fund edhe në bazë të programeve që i kanë afishuar pa ndalë hiq nëpër fushata zgjedhore i kanë parasysh të gjitha partitë pa përjashtim kanë thënë se ky është standardi numër 1 i tyre.

Tema tjetër e madhe është decentralizimi, unë shtroj pyetjen, ky nuk paraqitet si standard kur nominalisht në dokumente, por ne po shofim që është bërë standardi numër 1 i veprimeve praktike politike të Qeverisë që i bjen pak si tinzisht në kuptimin institucional.

Unë mendoj që duhet të shtrohet problemi a është decentralizim a reformim i administratës lokale këto janë dy probleme që nuk duhen të përzihen, nëse është decentralizim në vështrimin etnik unë mendoj që ky nuk do të sjellë kurfarë qetësie, por në të vërtetë do të jetë dezintegrimit politik i Kosovës që do të thotë në instancën e fundit legalizim i enklavave. Në anën tjetër nëse decentralizimi kuptohet si shpërndarje për shpërqëndrim i pushtetit politik unë mendoj që është

problem se është një vakum se nuk din njeriu qka decentralizon për shkak se pushtet qendror ndërtum në kuptimin efektiv për fat të keq nuk kemi,

Në kuptimin e ikjes pra të pushtetit qendror kah qytetari atëherë unë them edhe reformim kuptimin final ske çfar të reformojësh në pushtetin lokal se ai nuk është formu totalisht.

Problemi tjetër është se gjitha këto nivele pushtetore në të vërtetë e kanë përmas një servitues ose një tutor ndërkombëtar i cili sillet me njërin ose në funksionin tjetër në bazë të aftësisë të vetë ose në bazë të mesit në Kosovë si e akcepton ate.

Kemi problemin e shtetit ligjor, unë mendoj që shtet ligjor pa ligj të shtetit nuk mund të ketë, shkurt kjo po i bie që duhet të kemi Kushtetutë pa organonin themelor të një vendi nuk ka shtet në anën tjetër gjitha ligjet faktikisht derivime sistemore të kushtetutës dhe nëse nuk ndodhë kjo ne do të kemi një kaos të ri edhe me ligjet sistemore që do t'i ndërtojmë.

Pse e them këte, e them për shkak se ne po na ndodhin përpjekje veprime konkrete në jetën sociale dhe politike të Kosovës që grupet të quajtura grupe të punës që të krijojnë, (disa fjalë nuk janë regjistruar të fundit)

Kryesuesi Nexhat Daci

Bajram Rexhepi

Unë e respektoj këtë Parlament, dhe Qeverinë por me të vërtetë në këmbë nuk e kemi komoditetin e leximit, është shumë vështirë me akordu dioptrinë me lexim, mirëpo mos të bëhet në praktikë në të ardhmen.

I nderuari kryetar i Parlamentit, kryeministër, ministra dhe deputetë të nderuar.

Me të gjitha sondazhet e 5 vjetëve të kaluara, çështja e zhvillimit ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës ishte një ndër prioritetet kryesore të qytetarëve të Kosovës.

Me propozim projektin e programit qeveritar të këtij segmenti tepër të rëndësishëm i është dhënë një hapësirë dhe vemendje e konsiderueshme. Është bërë identifikimi i shumicës së dobësive dhe pengesave aktuale për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Pengesat në fjalë padyshim se pamundësojnë krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për zhvillimin në ndërmarrje të vogla dhe të mesme private e të cilat në anën tjetër do të krijojnë segmentin më vital të ekonomisë kosovare në këtë situatë të vështirë të tranzicionit. Do t'i përmendi disa nga këto pengesa: politika fiskale jo e favorshme për prodhuesit vendor edhe pse janë bërë disa hapa domethënëse në lëmin e agrobiznisit nga qeveria e mëparshme. Rezultatet e para të këtyre masave do të shihen nga një janari i vitit 2005.

Politika monetare dhe kreditore. Në momentin aktual dihet se banka e pagesave të Kosovës nuk e ka rolin e bankës qendrore për të bërë politikën monetare për të krijuar garancione për kredi më të favorshme të bankave vendore komercijale si dhe të jashtme.

Qeveria e mëparshme është angazhuar në shtyllën e katërt dhe fondin monetar ndërkombëtar në krijimin e parakushteve drejtë avansimit të bankës së pagesave të Kosovës në bankë qendrore. Qeveria aktuale duhet të vazhdojë në përkushtim përpjekjet tani të filluara.

Ekonomia e Kosovës e sidomos sektori privat ka uri për mjete të gatshme financiare të cilat janë të bllokuara në formë të depozitash nëpër bankat e ndryshme komerciale. Mjetet e trustit pensional në tregjet e parave në Holandë, fondi nga asetet e shitura të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara është po ashtu i bllokuar, mjetet e pashfrytëzuara dhe tepricat e PTK-së, Aeroportit e tjerë. Kjo Qeveri duhet të gjejë sa më parë mënyrën e mobilizimit të këtyre mjeteve për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose të ndërmarrjeve publike.

Privatizimi si domosdoshmëri e transformimit më të shpejtë të pronës shoqërore dhe publike në mënyrë që prona të ketë titullarin e qartë privat është premisë kryesore për investimet e kapitalit të freskët dhe për menagjim të përgjegjshëm.

Për privatizim presin edhe 350 deri 400 ndërmarrje shoqërore, proces ky të cilin AKM-ja duhet ta përfundojë deri në qershor të vitit 2005. Me dinamikën e tanishme ky proces nuk mund të kryhet as për dy vite. Poashtu ristrukturimi i ndërmarrjeve publike si proces i domosdoshëm për vetëqendrueshmërinë financiare për huazimet e kredive dhe përgatitje për privatizim vështirë se do të bëhet gjerë në mesin e vitit 2005.

Është pak sa optimiste gatishmëria e ndrimeve në strukturat udhëheqëse të shtyllës së katërt dhe rrjedhimisht të AKM-së. Qeveria duhet të propozojë një strukturë organizative më efikase në bordin e drejtorëve të AKM-së, si dhe në strukturën menagjuese të ndërmarrjeve publike dhe të atyre shoqërore, ndërsa prej qershorit të vitit 2005 privatizimi do të duhet të kalojë krejtësisht në duart e vendorëve.

Pengesat ligjore dhe administrative që lidhen me statusin e padefinuar të Kosovës dhe me mungesë të kompetencave të mjaftueshme të vendorëve duhet të tejkalohen.

Ambienti i disfavorshëm ekonomik dhe politik në fqinjësi të Kosovës. Gati të gjitha shtetet e ballkanit perendimor kanë qendrim negativ ndaj Kosovës për nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë, kurse marrëveshjet në fjalë janë hapi i parë drejtë liberalizimit të tregut në regjion. Përkundër rekomandimeve të paktit të stabilitetit dhe komisionit evropian i vetmi rast pozitiv është Shqipëria me të cilën janë nënshkruar marrëveshja e tregtisë së lirë, lirimi nga taksat e dyfishta dhe garantimi i investimeve të ndërsjella. Të gjitha këto pengesa janë dekurajuese për investitor serioz, përkundër pengesave aktuale duhet vazhduar përpjekjet me Maqedoninë, Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën e të tjerët. Imazhi i krijuar me ose pa të drejtë për pasiguri të mjaftueshme fizike politike dhe siguri të investitorëve.

Kryesuesi, Nexhat Daci

Faleminderit për sygjerime, Naim Maloku le të bëhet gati Teuta Sahatqiu

Naim Maloku

Të nderuar ministra të nderuar deputetë. Duke ju bashkangjitur përgëzimeve për një fillim të mbarë të Qeverisë së Kosovës dhe për këtë program i cili reflekton at fillim të mbarë të punës. Më lejoni që të jep 4 sygjerimet e mia personale në përbërjen e këtij programi.

Nën 1. ndoshta do të përsëris parafolësin tim, por më lejoni të shprehë shqetësimin tim për nxjerrjen e mjeteve financiare jashtë tregut të kapitalit të Kosovës, dhe e kam fjalën për Trustin pensional i Kosovës që është një vlerë rreth 70 deri 100 milionë euro. Më lejoni të shprehi rezervën time lidhur me manipulimet me këto mjete financiare jashtë Kosovës, dhe me frikën që këto mjete financiare do të përfundojnë ashtu siç ka përfunduar edhe fondi pensional i Rumanisë me humbjen e dhjetëra milionë eurove pa kthim.

Mjetet tjera financiare që janë larguar nga tregu i kapitalit të Kosovës janë edhe mjetet e posteve të Kosovës ku spekulohet me qindra miliona euro. Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të bëjë çmos që këto mjete financiare të i kthen në tregun e kapitalit në Kosovë, që kishte me qenë një ndihmë e madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

2. Departamenti i sigurisë civile dhe i emergjencës nuk përmendet në këtë program. Më lejoni z. kryetar dhe ministra, që për të qenë afër zhvillimeve të këtij departamenti që nga fillimi mendoj se ky departament duhet të hiqet nga Ministria e shërbimeve publike, e përsëris sygjerimin tim, edhe nga legjislacioni i kaluar në këtë Kuvend që nga fillimi ky departament është zhvilluar me synimin që të jetë skema organizative e Qeverisë e njëjtë me ato të bashkimit evropian. Pra ky departament të jetë pranë kryeministrit ashtu me këtë skenë janë të zhvilluara edhe qeveritë e shteteve në tranzicion.

Ky departament për momentin është si divizion në kudër të shërbimeve publike mendoj që nuk e ka vendin aty. Ky departament duhet të bëhet sa më shpejtë me ligj dhe jo të lihet kështu me rregullore. Një ligj i cili është prezentuar këtu në legjislacionin e kaluar ka mbetë i pa miratuar dhe ky departament nëse vazhdon kështu atëherë ka ngecje në zhvillimin e tij duke u bazuar vetëm në rregulloret të UNMIK-ut,

3. Në fushën e transportit dhe telekomunikacionit më lejoni që të përsëris synimet dhe orientimet në këtë lami, por mendoj se pak ju ka kushtuar rëndësi rrjetit hekurudhor të Kosovës. Mendoj se duhet ti kushtohet një rëndësi më e madhe hekurudhave të Kosovës, për këto arsye është transporti më i lirë dhe duke marrë parasysh se 98% të mallrave që hyjnë në Kosovë janë nga importi, një transport më i lirë kishte me ndikuar edhe në uljen e çmimeve.

Nën dy kishte me u ba shkarkimi i rrjetit rugor nëse orientohen transporti i mallrave në sistemin hekurudhor dhe lidhja më e shpejtë me rrjetin e hekurudhave ndërkombëtare dhe me tregun ndërkombëtar.

Në fushën e mjedisit dhe të planifikimit hapësinor më lejoni të sygjeroj Qeverinë e Kosovës dhe ministrinë që e mbulon këtë resor që t'i kushton një vëmendje edhe më të madhe mbrojtjes së rrjedhave të lumenjëve të Kosovës dhe resurseve të ujërave nëntokësore për t'ju siguru gjeneratave që ju vijnë një resurs të shëndoshë, posaçërisht, sygjeroj që të kihet vëmendje mbrojtjes së rrjedhjes së Drinit të Bardhë dhe ndalimi i përdorimit të metutjeshëm dhe eksploatimit të zhavorit nga këto rrjedha.

Kryesuesi, Nexhat Daci

Teuta Sahatqiu

I nderuari kryetar i kuvendit, të nderuara deputete dhe deputetë,



Përpilimi i programit qeveritar vërtetë kërkon një përkushtim dhe një punë të madhe. Ju përgëzojë juve z. Kryeministër dhe bashkëpunëtorët tuaj për një punë të përkushtuar dhe shumë ambiciozë.

Ne si grup parlamentar opozitarë me dëshirë që të jemi konstruktiv dhe në shërbim dhe dobi të qytetarit të Kosovës kemi disa vërejtje në lidhje me Programin e Qeverisë së Kosovës.

Në pjesën ku flitet për privatizim, pikërisht në fjalinë, korigjimet sipas nevojës të politikave operacionale duhet të evitohen paçartësitë lidhur me autorizimet burimore legale të institucioneve

të Kosovës në qeverisjen e pronës shoqërore dhe publike. Rekomandojmë që të shtohet në fund edhe fjalët dhe shoqëritë aksionare si dhe fjalia Qeveria do të angazhohet për zgjedhjen e problemit të privatizimit të shoqërive aksionare, të cilët janë transformuar me ligje jodiskriminuese. Pasi vij nga Gjakova ku ekzistojnë 48 shoqëri aksionare, ju lutem më lejoni me pika të shkurtëra tju njoftojë me gjendjen e tyre.

Shoqëritë aksionare deri më sot nuk janë përfshirë në privatizim dhe nuk shifet një rrugë e zgjidhjes e statusit të tyre.

Këto ndërmarrje janë transformuar në shoqëri aksionare me ligjin diskriminues të kohës së Ante Markoviqit mbi kapitalin shoqëror, fletorja zyrtare republikës socialiste të Republikës Socialiste të Jugosllavisë nr. 77/88 40/89 46/90 dhe 61/90. Me të njejtin ligj janë privatizuar dhe fabrika e subjekte tjera në ish Jugosllavinë e atëhershme. Gjakova me 1989 kishte 21 mijë të punësuar, prej tyre 14 mijë në industri, me bruto prodhim prej 100 milion euro prej të cilave 20 milion eksport. Industria e tekstitit Emin Duraku kishte mbi 5000 mijë të punësuar, industria elektrometalike dhe elektromotori 2700, industria bujqësore Ereniku dhe Kooperativa e becit 2500 të punësuar industria e përpunimit të materialit ndërtimor, industria e përpunimit të gomës me nga 200 të punësuar.

Këto subjekte ekonomike kishin bashkëpunim me shumë shtete si Gjermania, Italia, Franca, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fatkeqësisht këto ndërmarrje nuk janë në plan të privatizohen, ato as nuk janë të regjistruara pasi që nga Ministria e tregtisë deri më sot nuk është përgjegjur në kërkesën e tyre, këtyre shoqërive aksionare si për regjistrim si biznese. Si të tilla ato nuk mund të ushtrorjnë aktivitetin e vetë të plotë ekonomik, nuk kanë mundësi të importit dhe eksportit nuk mund të aplikojnë në tenderat të kenë konton e vetë e tjera, ndërsa në të njejtën kohë ato nuk pengohen të paguajnë tatime. Prandaj po ju drejtohem Qeverisë dhe z. Kryeministër që duke pasur parasysh këte kërkojmë nga ju që të futet në programin e Qeverisë edhe kjo çështje. E kemi parasysh se është problemi i vështirë por për të nisur një zgjidhje duhet të ekzistojë dëshira për ta zgjidhur dhe të bëhet hapi i parë në këtë drejtim. Ne posedojmë dokumentacionin e nevojshëm si dhe informatat, të cilat jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë në këtë çështje me rëndsi të veçantë për këto subjekte afariste dhe së bashku me këtë për një numër të madh të punëtorëve, të cilët me padurim presin reaktivizimin e shoqërive aksionare.

Kryesuesi, Nexhat Daci,

Unë ju lus, në ora 2 kthehem këtu, dhe të gjithë të jemi të pranishëm, sepse ka gjasa që dikur vonë do të duhet t'ju nënshtrohëm procesit vendimor,

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

## **FATMIR SEJDIU**

Të nderuar deputetë, vazhdojmë debatin rreth Programit të Qeverisë. Lus deputetët e tjerë që nuk janë në sallë që të vijnë brenda. Unë, po ashtu, do ta përcjellë rradhën sipas paralajmërimit. Për fjalë është paraqitur deputeti Rifat Krasniq, ndërkaq le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

## **RIFAT KRASNIQ**

Zotëri Krasniq nuk është i pranishëm.

## **FATMIR SEJDIU**

Zotëri Xhemajli le të paraqitet.

## **EMRUSH XHEMAJLI**

I nderuari kryesues, të nderuarë deputetë, i nderuari kryeministër. Edhe Lëvizja Popullore e Kosovës e përgozon Qeverinë e Kosovës që ka arritur në një afat të shpejtë të sjellë në Kuvend për shqyrtim Programin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2004-2008. LPK-ja është përcaktuar që t'i rezervojë vehtes të drejtën që të aprovojë të gjitha pjesët konkrete të programit të Qeverisë që i vlerëson të drejta, mirëpo do të kundërshtojmë veç e veç pjesët e programit që i konsiderojmë të dëmshme për interesin e vendit. Nga pjesët programore me të cilat pajtohet LPK-ja është përpunimi i ligjit në procedim për dëshmorët, invalidët dhe veteranët e luftës çlirimtare. Gjithashtu, përkrahim listën e ligjeve që ka ofruar Qeveria si shtesë të programit duke shpresuar që ndërkohë do të shtohen edhe ligje të tjera të nevojshme. Në veçanti përkrahi pjesën ku flitet për angazhimin e Qeverisë, për regjistrimin e popullësisë si dhe pjesët që kushtohen diasporës e tjera. Mendojmë se Programi i Qeverisë duhet të plotësohet edhe me disa pjesë të tjera. Qeveria e Kosovës duhet të inicojë procedurën para organeve të drejtësisë kundër pjesëtarëve të okupatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre që bënë masakra mbi popullësinë civile në Kosovë. LPK nuk pajtohet me pjesën ku flitet për statusin e vendit dhe standardet.

Standardet për Kosovën nuk janë afruar si instrument zhvillimi që do të ishte e dëshirueshme por si pengesë për zhvillimet politike, ngase duke synuar me çdo kusht arritjen e standardeve para statusit vendi vazhdon të shkojë drejt stagnimit dhe bllokimit të plotë.

Qeveria e Kosovës në këtë program ka shprehur gatishmërinë që të diskutojë marrëdhëniet bilaterale dhe çështjet e hapura me Qeverinë e Serbisë.

Ne mendojmë se kjo është e gabuar pasi në bisedime duhet të përfshihen të gjithë fqinjët dhe ndërkombëtarët për të përcaktuar fillimisht pozitën nga e cila Kosova do të bisedojë me të tjerët. Çështja e Kosovës nuk është çështje bilaterale për çështjen ndërkombëtare. Në tekstin e Programit disa herë përmendet termi Kosovaret dhe institucionet kosovare, shih faqën 3 pasuset 1 i 2 dhe në disa pjesë të tjera. Në faktë kemi të bëjmë me qytetarët e Kosovës dhe institucionet e Kosovës. Ky është fjalor, për mendimin tonë, ideologjik dhe politik i disave në Kosovë që po përpiqen të krijojnë kombës të ri kombin Kosovar, gjë që për mendimin tonë është antihistorike, kurse tani është koha e integritimeve dhe jo e kundërta, andej këto terme për mendimin tonë nuk e kanë vendin në Programin e Qeverisë. Në fund edhe disa vërejtje që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tekstit.

Disa pjesë të Programit në fakt paraqesin një doracak teorik të përgjithësuar me fraza jokonkrete, kurse disa pjesë të tjera të Programit janë evidentim dëshirash, nevojash dhe parakushtesh që në

fakt nuk e kanë vendin në një program qeveritar. Programi i një qeverie përfshin atë çka do të bëjë Qeveria gjatë mandatit e jo të përshkruajë gjendjen e vendit apo çka do të dëshironte të bëjë. Për këtë kjo përsëritet në disa vende por më kjashtë në faqën 12 të privatizimi, pastaj në faqen 14 pasuset 2,3 dhe 4. si dhe në faqen 25. Ju falemendoj për vëmendje.

## **KRYESUESI, FATMIR SEJDIU**

Fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj

## **GJERGJ DEDAJ**

Faliminderit z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, ministra dhe deputetë.

Kisha pasë dëshirë para se të paraqesë vërejtjet e mia nga kryesuesi ta di se u bë fjalë për minutazhën, e me që nuk e kam të qartë du një shpjegim, se u folë këtu përveç shefave të grupeve parlamentare kanë një minutazhë pak më të lartë deputetët që janë shefa të partive. E di se për dikën është ndoshta edhe qesharake, por do të ju bëjë me dije se në këtë Parlament duhet të kultivojmë një kulturë politike, një rëndë demokratik në mënyrë që të ndëgjohet zëri i të gjithëve, sepse këtu dikush na ka dhënë vota për me ardhë këtu dhe me i paraqit pikëpamjet tona.

Me vëmendje kemi shfletuar programin e Qeverisë së Kosovës dhe i kemi evidencuar edhe vërejtjet tona posaçërisht në disa nga çështjet që janë më kryesore dhe më substanciale për të ardhmen e vendit dhe mendoj për prioritetet e Qeverisë së Kosovës siç janë: marrëdhëniet ndërkombëtare, statusi final politik i Kosovës, çështja e diasporës dhe problemi që në vazhdimësi po krijon plagë të reja që nuk jemi marrë shumë seriozisht me të, çështja e të zhdukurve.

Në çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare nuk vërehet as afatizimi, as instrumenti e as ndonjë metodë konkretizimi se cila do të jetë pozita e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe fillimisht çka duhet të bëjë Qeveria e Kosovës që Kosova mos mbetet një ishull i izoluar dhe mund të them pa një korrespondencë dhe pa relacione në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe mendoj se do të ishte mirë sikur Qeveria e Kosovës do të kishte paraparë që të afatizohet çështja e hapjes së zyrave të Kosovës, ta zëmë në Washington, Nju Jork, Bruksel dhe në të gjitha qendrat e vendosjes, të cilat, mendoj që nuk janë precizua dhe afatizua. Sa i përket çështjes së statusit final politik të Kosovës edhe këtu konsideroj se duhet të jipet një afatizim për zgjidhjen e kësaj çështjeje mjaft të ndieshme, duhet se është viti 2005, pastaj në vitin 2005 mund të na thonë se në vitin 2006 e kështu me rradh.

Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet ta precizojë edhe afatin edhe instrumentin, sepse partitë që janë në koalicion, disa kanë thanë gjatë fushatës se janë vetëm duke pritur njohjen formale të pavarësisë së Kosovës, tjetra ka kërkuar shpalljen në Kuvend, e mendoj se deri më tash as njëra as tjetra ska ndodhur. Mendoj se është koha që të ipet një përgjigje e qartë konkrete dhe e afatizuar për mënyrën dhe instrumentin si do të arrihet çështja e zgjidhjes së statusit final politik të Kosovës që është pavarësia.

Çështja e diasporës mendoj se në këtë program nuk është e përfshirë. Mundem me thënë se ju ka dhënë më pak prioritet se çështjes së sportit e mendoj se duhet ta dijmë se një gjysmë milioni Shqiptarë jetojnë në diasporë nga ata e kemi mbajtur Kosovën. Mendoj, e ky është edhe qëndrim i Partisë Liberale të Kosovës se ata tash janë shëndrruar në jetim dhe shumë pak Qeveria e Kosovës kujdeset për fatin e tyre, për dokumentat e tyre të udhëtimit, dhe mund të vijmë ata në pushim dyjavësh në Kosovë dhe t'i kalojmë pushimet nëpër sportele ose ta humbin avionin për të kthyer në vendin e punës për shkak të byrokracisë e neglizhencës dhe për shkak se nuk është dhënë një

zgjdhje e drejtë. Mendoj se ka qenë dashur që në këto qendra të vendosjes, ku punojnë njerzit tanë, të hapen zyra e t'ju ndihmohet atyre për lëvizje të lirë. Mos të flasim për çështjen e të zhdukurve ngase kjo ka mbetë vetëm në dëshirën e Serbisë, kështu që i kthen Merdare kur do dhe sa do. Ne menojmë se duhet ta kushtëzojmë se kryeministri tha se jemi të gatshëm për të filluar menjëherë.

## **BEHXHET BRAJSHORI**

I nderuari z. kryesues, z. kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, zëvendësministra, të nderuarë kolegë deputetë.

Konsideroj se dabati i sotëm do të shërbejë si një praktikë e mirë, pra edhe për rradhët e tjera e në veçanti për sot për të pasuruar programin e Qeverisë së re e në këtë drejtim do të mundohem që të jap edhe kontributin tim.

Unë do të jem më konkret brenda mundësive duke i përmendur tri çështje që unë konsideroj se janë prioritare në kuadër të Programit qeverisës. Rritja ekonomike, energjetika dhe privatizimi. Kur flasim për rritjen ekonomike mendoj se kjo është një sfidë për shoqërinë tonë dhe mbetet edhe më tutje sfidë për Qeverinë e ardhshme dhe në përgjithësi për shoqërinë tonë.

E them këtë sepse po ballafaqohemi me probleme të mëdha ekonomike dhe në Programin qeverisës është paraparë një rritje ekonomike prej 1.3% tani në 4.6% në vitin 2006 për të marrë normën shtimit 7% më tutje. Mirëpo mbetet pak a shumë e paqartë se cila do të jetë mbështetja e investimeve për të arritë këtë normë të shtimit ekonomik. Një normë e caktuar e investimeve ekonomike kryesisht do të ishte mirë që Qeveria ta përcaktojë në bazë të asaj edhe të kërkojë fonde ose burime për financimin e investimeve. Janë thënë burime këtu në Programin qeveritar por pak a shumë këto sikur vetëm thuhën dhe nuk dihet sakt se sa do të jenë të sigurta këto burime të financimeve duke filluar nga nevoja e antarësimit të Kosovës në institucione financiare ndërkombëtare, sigurimi i investimeve të jashtme direkte dhe ajo që është me rëndësi shumë krijimi i një ambineti volitshëm investiv edhe për investime të diasporës sonë që unë i konsideroj do të thoja pa alternativë.

Në këtë drejtim, nëse arrinë që këto burime të jenë të sigurta unë mendoj që Programi i Qeverisë mund të jetë i realizueshëm dhe ta zëjë hapin e zhvillimit ekonomik ashtu siç është paraparë në Programin qeverisës. Në të kundërtën sigurisht se do të humbim kohë sepse dihet se edhe ashtu investimet nuk e japin efektin e vet në vitet e para të investimit por vazhdojnë në disa vite derisa ato të tregojnë efektet e veta.

## **E dyta energjetika**

Energjetika është problem për të cilin jo vetëm në strukturën e mëparshme të Qeverisë por ka herë është biseduar dhe sikur nuk gjente zgjidhje për këtë.

Unë mendoj se Qeveria konkretisht duhet t'i japë shumë prioritet kësaj çështjeje dhe të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të energjetikës dhe thuhën në dokumentin përkatës por se duhet të marrë hapa konkret. Ne saktë duhet ta dimë a duhet të shkohet në ndërtime, kapacitete të reja, a duhet të mbështetet në importin e energjisë elektrike, me faktorët që natyrisht duhet kushtëzuar me pagesën e energjisë elektrike nga konsumatorët apo ndonjë formë tjetër. Nëse kështu nuk arrihet e çka të bëhet në këtë drejtim, natyrisht se do të kemi destimulim të investitorëve të jashtëm gjë që do të ndikojë në procesin e zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

## **Dhe e treta privatizimi**

Unë besojë se edhe Qeveria por edhe institucionet ndërkombëtare do ta kenë parasysh këtë kërkesë të të gjithë neve se privatizimi nëse shkon me ritëm të duhur efektet e tij priten pas një kohe të caktuar dhe jo menjëherë, prandaj unë e përmbulli diskutimin me konstatimin se është e nevojshme që urgjentisht të vëhen prioritetet edhe brenda programit qeveritar dhe në këtë drejtim, ndoshta që këto do të ishin prioritetet e para, përtrirja e zhvillimit ekonomik me mundësi për të investuar në fusha të ndryshme të jetës sonë në ekonominë e jetës sociale, zhvillimin e përgjithshëm dhe natyrisht edhe në zhvillimin kulturor. Sporti tek ne nga përvoja e kaluar, unë

konsideroj se duhet ndërruar këtë praktik dhe kultura duhet të jetë një nga sferat që duhet të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës, sepse është par praktikisht që është më se e nevojshme për të përcaktuar edhe për t'i ndihmuar edhe më tepër në drejtim të zhvillimit të kësaj fushe të rëndësishme, sportit dhe problemeve të rinisë e të mos flasim për diasporën prej të cilës vazhdimisht kemi kërkuar dhe tani është momenti që të krijojmë kushte më të mira për ta në mënyrë që ata të investojnë në Kosovë dhe t'u kthehet ai borxh të cilin e kemi për ta. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, FATMIR SEJDIU**

Sa për informim t'ju them se në sallë gjenden 97 deputetë. Vazhdojmë punimet.

## **RIFAT KRASNIQI**

I NDËRRUAR Kryetar, i ndërruar Kryeministër, deputet të nderuar

Para se ta filloj bisedën, do të ju përshëndes, Unë Rifat Krasniqi, jam antar i KDTP-së dhe vie nga Mamusha.

Deputet të nderuar. Pas lufte, sikur organizatat ndërkombëtare, po ashtu edhe Kuvendi i Kosovës, kanë dhënë kontribut mjaft të madhë për zhvillimin e Kosovës.

Sipas mendimit tim, dega më e rëndësishme në Kosovë dhe njëherit faktori kryesor me të cilën mberën shumica e popullsisë është bujqësia.

Dua t'ju them se marrja me bujqësi është një punë shumë e mundishme, kur dihet se çmimet as për së afërmi nuk i plotsojnë nevojat e ushtrimit të kësaj veprimtarie. Siç e dini, kësaj veprimtarie ende nuk i është dhënë vendi i merituar. Mungojnë kreditë e ndryshme, si faktor mjaft e rëndësishëm për stimulimin e bujqve. Problem të veçantë paraqet edhe plasimi i prodhimeve në treg. Këtu ndikon sidomos futja në treg e prodhimeve të huaja pa kontroll.

Mu për këtë, Qeveria e re në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, duhet të kontribojë më tepër në zhvillimin e kësaj dege.

Në fund, dua t'ju them se plotësisht e përkrahi Programin e Qeverisë së re dhe besoj se ky Program do të jetë bazë e mirë për zhvillimin e Kosovës.

Ju falënderoj për vëmendje.

## **KRYESUESI, FATMIR SEJDIU**

Për fjalë është paraqitur deputeti Hajredin Kuçi

## HAJREDIN KUÇI

I nderuari kryesues, kryeministër, Qeveri dhe të nderuar deputet.

Unë do të tentoj të bëjë vërejtjet apo sygjerimet e mia për Programin Qeveritar në dy drejtime, në atë të përgjithshme dhe do të ndalem diçka në aspektin e ngritjes së sistemit juridik në Kosovë.

Sa i përket vërejtjeve të përgjithshme në këtë Program Qeveritar ne do të hasim në definimet e përgjithësuara të cilat kanë më shumë konstatime të gjendjes shpeshëherë edhe ndoshta përshtkrim dhe më pakë që afrojnë zgjidhje, sidomos do ta vëreni apo vërejmë bashkarisht në këtë Program

mungojnë mjetet respektivisht potenciali edhe intelektual edhe material për realizimin e sunimeve që i ka Qeveria e Kosovës.

Në çështje tjetër që duhet ta theksojë si vërejtje të përgjithshme është edhe aspekti i dytë i cili mendoj se ka mund apo ta bëjë më shumë Qeveria e Kosovës në apsorvimin e programeve të partive politike që janë në koalicion. Unë nuk pajtohem me ata që thojnë se ka qenë kohë e shkurtër në hartimin e Programit të Qeverisë nga se programet e qeverive hartohen në momentin kur partitë politike përgatiten për të hyrë në fushatë elektorale, pra pjesa e saj çka është premtuar qytetarëve të Kosovës duhet të jetë edhe në Programin Qeveritar.

Unë kam lexuar me vemendje programet elektorale të dy partive që janë në koalicion dhe mund të them sa i përket statusit politik dhe juridik të Kosovës mungojnë disa çështje që janë premtuar qytetarëve të Kosovës. Unë do të provoj që të orientohe në një pikë që aty thuhet veprimi i shtetit ligjor, por unë kisha pasë me thanë sundimi i të drejtës në Kosovë, dhe mbi bazën e saj ndërtimin e sistemit juridik. Ne e dimë të gjithë se Kosova ka pasë një histori ndoshta jo të mirë të sistemit juridik në të cilin ka dominuar idologjia në të cilën ka dominu edhe mbi të gjitha një mungesë e profesionalizmit ngase 10 vitet e fundit nuk kemi pasur gjyqtarë po mendoj para 1999/tës, që kanë punuar apo shumica e tyre jo, pastaj kemi pasur ngecëje të ekspertëve apo të kuadritë të ri dhe kemi pasur prokuror dhe gjyqtarë ndërkombëtarë. Këtij Programi i mungon një lidhje organike se si do të funksionojnë të gjithë këta së bashku, cilat do të jenë mjete që do t'i ngrisin këta njerëz apo do bëjnë më funksional në këtë sistem juridik.

Një aspekt tjetër që duhet të përmendet gjithësesi çështjet e së drejtës në Kosovë, sila është e drejta në Kosovë, ne mendojmë se kemi katër lloj burime në Kosovë, i kemi ligjet para 23 marsit 89-tës, i kemi rregulloret e UNMIK-ut, i kemi ligjet e Kuvendit të Kosovës, dhe fatkeqësisht në një pjesë të Kosovës kemi edhe mund të themi edhe ligjet e Serbisë të cilat mund të funksionojnë. Mendojmë se këtij Programi i mungon dilema apo heqja e dilemës cila duhet të jetë, e drejta në Kosovë, cila duhet të jetë zbatimi i asaj të drejtës dhe qytetarët dhe zbatuesit e ligjit të mos e kenë këtë dilemë. Pra mendoj se këtë program ka nevojë që të sçarohet kjo se cila do të jetë.

Mbi të gjitha në unifikimin e sistemit juridik në Kosovë dhe homogjemizimin e tij në tërë territorin e saj. Natyrisht se nuk mund të thuhet se do të funksionoj sistemi juridik pa një ngritje të stafit përcjellës, stafit administrativ, ata që punojnë në gjykata e dinë edhe më mirë se kemi një shkëputje administrativ, kur administrata pranohet nga dikush tjetër, dhe gjyqtarët nga dikush tjetër. Dhe tani kjo duket se është një shkëputje, mendoj se ata kanë nevojë për një lidhje më të mirë në kuptimin e Programit Qeveritar dhe për përgatitjen e tyre dhe në aspektin teknologjik. Unë mund të them se në ndërtimin e këtij sistemi juridik e di që në Kosovë dhe kudo në botë që të sundojë e drejtstë sudoj ligji. Ndoshta në Kosovë është një çasje pak sa filozofike por mendoj se në Kosovë duhet të sundohet ligji, pse po e themë këtë, se ligji apo e drejta që vepron në Kosovë nuk është në përputhje tërësi me vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Në këtë drejtim mendoj se Qeveria duhet të bëjë më shumë se si duhet të funksionoj kjo e drejtë që të jenë në përputhje me qytetarët apo vullnetin e qytetarëve. Natyrisht është mirë të dihet qëndrimi i Qeverisë lidhur me

ndryshimet e Kornizës Kushtetuese që janë miratuar në Kuvend dhe të dihet procedura se si do të jetë në të ardhmen një kushtetutë e re, apo me një akt tjetër juridik.

Unë do të them se ka nevojë të bëhet një rishikim dhe reformim i sistemit të tërësishëm gjyqësor dhe mbi të gjitha, edhe pse ndryshimet kushtetuese të ndërtohet apo të merret vendim për ndërtimin e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë. Një çështje që është me rëndësi do ta citoj një autor kur thotë është me rëndësi që gjyqtarët ta thojnë atë që njerëzit e besojnë që norma ai që beson në çdo rast të jenë të barazuara paraprakisht me ligj. Ne kemi vendimin në Kosovë të cilat disa janë në procedurë të sipër disa edhe ka ndodhë më heretë, për cilat dikush mendon që është marrë në bazë të ligjit, por besimi i qytetarëve se ato vendime janë të drejta nuk ndodhë, dhe ne e dimë publikisht ne duhet të bëjmë diçka që këto veprime apo këto gjykime të ndërtohen të rishqyrtohen në forma

të tjera mbi të gjitha mendoj me ndërtimin e Ministrisë së Drejtësisë e cila do të jetë një shansë për vërtetimin e asaj atij gjykimi apo do të ndodhë e kundërta.

Natyrisht se çështja e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk duhet të jetë vetëm në formë të propagandës, por më shumë të trajtohen si vlerë dhe duhet të përfshihet si institucioni i obduspersonit apo avokatit të popullit të shëndrohet në institucionin vendor e jo në institucionin ndërkombëtarë.

KRYESUESI, FATMIR SEJDIU

Fjalën e ka deputeti, Numan Baliq

NUMAN BALIQ

Ja ću najprije da selamim sve prisutne u sali da kaŕem o nekim stvarima koje ću nastojati da ne ponavljam. U vezi sa nekim stvarima koji su jako značajni sa Kosovu i koji su mnogo puta ponavljeni ŕeleo bih da skrenem paŕnju na naše stavove i naša posmatranja sa stanovišta moje zajednice ali i drugih malobrojnih zajednica koje postoje na Kosovu, daklje bošnjaka, gorana, roma, ekipćana i haškalija koje su mislim značajnim delom vezano za ovo pitanje i za neka druga pitanja. Ako su u pitanju standardi, izgleda da se moramo da moramo da skrenemo paŕnju da standardi ne tiću samo malobrojnih zajednica i manjinskih zajednica, nego da se oni prema redu stvari, najpreh tiću svih građana Kosova, ali da poseban značaj imaju za manjinske zajednice, te da je u predloŕenom programu Vlade koji naravno nastoji da bude sve obuhvatan obećavajući i koji nudi mnoga rešenja imaju nega dobra rešenja ali i u mnogim stvarima nedostaje odgovor kako će se rješiti pojedina pitanja.

Mi ŕelimo da uzmemo ućešće u tome i da zajedno sa svima koji su na Kosovu nađemo odgovore i da nam se ponudi saradnja da bi smo našli te odgovore u rešavanju ovih pitanja i svih drugih pitanja. Prema redu stvari dakle standardi se tiću svih nas, svih građana Kosova, na drugom mjestu su pripadnici manjinskih zajednica. Međutim manjinskim zajednicama, ja mislim da se mnogo više pravno ili administrativno favorizira srpska zajednica naravno mi nemamo ništa protiv toga i mislimo da u ovom momentu situacija srpske zajednice jeste najteŕa i najbolnija i moŕda najveći problem za rešavanja i njihovih statusa Kosova, ali je potpuno neopravdano da se zapostavljaju oni koji se navodno nazovaju kao integrisana manjina i moŕda je to teŕište moga izlaganja. Moram reći da oni koji se zovu integrisanim manjinama a pripadaju Bošnjacima, Goranima, Romima, Aškalijama itd. Naŕalost oni nisu integrisani.. Oni su dobrim djelom integrisani, jesu jednim djelom moŕda malo više od bošnjacke, i turske zajednice. Posebno zajednica Aškalija, Egipćana i Roma su značajnim djelom neintegrirani i oni su neravnopravniji kao građani. U mnogim slućajevima se radi o građanima drugog ili trećeg reda, dakle u pojedinim slućajevima radi se o nejednakom pristupu zapošljavanja, administraciji i medijima, institucijima, opštinskim sluŕbama, pristup investiranju,, planiranju razvoja, sektora nevladinih organizacija, ŕto je samo

jedan deo stvari koje sam želeo spomenuti i naravno ovo bi trebalo biti deo dužeg govora, ali nažalost neka kruta pravila koja ne znam kako su postavljena ovde. Ono što je posebno važno a o čemu Vlada mora da da odgovor ako hoće da bude Vlada svih građana, jeste kako će program Vlade omogućiti da se povрати imovina građana i da li je na Kosovu kao svuda u svetu pravo na imovinu neutuđivo. Dakle ima mnogo Bošnjaka, Gorana i mnogo Egipćana i Aškalija, posebno Goranaca kojima su oduzete radnje i veliki broj bošnjaka, aškalije kojima su uzurpirane kuće a radi se o stotinama ili hiljadu objekata, koji su i dalje u vlasništvu drugih. Ponuđeni program Vlade ne daje odgovor kako će biti vraćena njihova imovina ili možda Vlada misli da podrži one koje su nasilno oduzeli tu imovinu Mi smo protiv toga ćutanja i tražimo odgovore kao što tražimo odgovor za veoma važna pitanja, a tiče se povratka.

Povratak nije pitanje ekskluzivno vezano samo za srbe Povratak se veže takođe i za druge malobrojne narode kao što sam rekao bošnjake, rome i aškalije, a kao što znamo najmanje 35 hiljada bošnjaka i goranaca su van Kosova. Neki su iseljeni a neki su prognani, trebamo omogućiti uslove za to da se oni vrate na Kosovo i da žive ravnopravno sa drugima i takođe ko ima pravo da zaboravi one koji su kao manjine u Mitrovici i u enklavama. Oni su tamo manjina, oni su tamo manjinske zajednice. U sjevernom djelu Mitrovice živi jedan broj građana, tamo su albanci, bošnjaci i drugi koji su tamo manjine. Mi moramo naći odgovore i za te građane da se rješe njihova pitanja do statusa Kosova, kako će se odnositi prema njima kao manjinskim zajednicima koji faktički tamo i jesu.

Vezano za nega druga pitanja, želim da napomenem da se pitanje decentralizacije ne odnosi samo na srba, ono je pitanje i bošnjaka i albanaca i svih ostalih, gdje god postoje uslovi da se stvaraju nove opštine. Hvala.

## FATMIR REXHEPI

Përshëndetje. Përkrahi në parim Programin e Qeverisë 2004-2008 bashkë me ekspozenë që dha kryeministri Haradinaj, të cilat përceptojnë objektivat nacionale dhe programore drejtë arritjes pra të standardeve demokratike për shtetin e pavarur të Kosovës. Sygjerimet e mia kanë të bëjnë me disa pjesë programore, po e filloj prej planit strategjik të zhvillimit ekonomik, randësinë që e ka dhe i cili është dashur të plotësohet edhe me disa pjesë konkrete, cilat do të ishin ato fusha si dhe si do të dukej kjo që të jetë më afër pikpamjeve tona ky zhvillim strategjik dhe ekonomik.

Në projektdraftë është dhënë mirë pra planifikimi apo rritja ekonomike e cila niset që nga 3 apo 6% që nga vitet e para e me synim që të kalojë mbi 7% që është një punë e madhe dhe një guxim i madh për Qeverinë e Kosovës që të kryhet reforma ekonomike. Unë e shohë që tek politika fiskale duhet të plotësohet me referenca tjera me tregues të gjendjes aktuale dhe ku duhet të ndryshohet kjo në mënyrë që të vazhdohet, pra të kemi buxhet të ndryshueshëm. Poashtu të kemi menaxhim më të mirë të financave publike si dhe të mos na lajmërohen edhe më tutje të na paraqiten teprica buxhetore si dhe strategjia e shfrytëzimit të tyre të tepricave buxhetore.

Te pjesa e reformës ekonomike, po ashtu është mirë që ngritet iniciativa për bankën nacionale dhe për politikën monetare kredituese në zhvillimin e sektorit privat pra, këtu po ashtu është mirë që është marrë iniciativa që brenda programit dhe punës që e pret Qeverinë të mendohet dhe të sigurohen depozitat e monetare të fondeve kosovare që ato shfrytëzohen dhe t'i kthehen sektorit përmes kredive të lëverdishme.

Unë kam një vërejtje bie fjala te zhvillimet dhe investimet në arsim që nuk ipet asnjë indeks, po ajo si synim që të bëhet kjo, por duhet të dihet se sa mund dhe sa është projekti i Qeverisë për investime në arsim me qëllimin më të mirë që arsimit të avancohet, a mund të jetë 3, 4, 5 apo 6% e gjidipisë së Kosovës, është mirë pra që të mund të bëhet një referencë më vonë e bilancit të punës në këtë drejtim.



Unë po ashtu ndaj mendimin se reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi nuk duhet të shkohen në eksperimentet që kanë filluar jashtë këtij parlamenti dhe nuk duhet ketë pra decentralizim mbi baza etnike, por të kemi reformë të pushtetit lokal konform interesave që të bëhet shtrirja dhe ndarja e pushteteve në territorin e Kosovës. Qeveria po ashtu mirë e ka përceptuar edhe ndërtimin dhe funksionimin e shtetit ligjor e bashkë me të pra edhe hartimin e Kushtetutës së vendit, por unë do të shtoja këtu edhe përgatitjet e diskutimit publik për sistemin zgjedhor që ai të ndryshojë për zgjedhjet e ardhshme lokale dhe nacionale. Ju faleminderit dhe e përkrahi punën e Qeverisë.

ENVER HOXHAI

Të nderuar anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, i nderuari kryeministër, të nderuarë anëtarë të Qeverisë.

Para se të filloj me disa sygjerime dhe vërejtje të mia paraprake mendoj se është e nevojshme të përmendet një vërejtje themelore e cila su tha deri më tash. Ky Program i Qeverisë, me sa di unë, është mes viteve 2004 deri 2008 dhe na duhet të mendojmë dhe ta debatojmë këtë punë, me qëllim që planifikimi të jetë sa më i prerë.

Përvoja politike ka dëshmuar se në demokraci ka dy lloj qeverish, qeveri për qytetarë të Kosovës dhe qeveri që qëndrojnë mbi interesat e qytetarëve të Kosovës se çfarë forme të qeverisë do të kemi këtu për tre vitet e ardhshme do të varen shumë nga ajo se çfarë programi Qeveria jonë do të afrojmë, nga ajo se sa Kuvendi i Kosovës vërtet do të kërkojë llogari nga Qeveria për punën ose mospunën e saj.

Të nderuarë deputetë, unë do të sunoj të fokusohem vetëm në disa vija të përgjithshme shumë gjenerale sa i përket fushës së arsimit, shkencës, kulturës, sportit dhe të diasporës. Çdo qytetar i Kosovës ka menduar që Programi i Qeverisë aktuale do të ketë tri prioritete kryesore, dhe ato prioritete kryesore do të jenë edukimi, edukimi dhe edukimi. Mjerisht kjo gjë nuk ka ndodhë. Në vendet përparimtare dhe me traditë të gjatë shkollimi dhe të studimeve univerzitare, edukimi sot përfaqëson prioritetin e vetëm dhe kryesor të këtyre qeverive. Se çfarë roli duhet të ketë edukimi në përparimin ekonomik që është brengë e Qeverisë sonë, mandej për Qeverinë tonë nuk është e qartë çka nënkuptojmë me arsim dhe me fjalën edukim, kështu që do të duhej të ketë një diferencim të prerë. Programi i Qeverisë sa i përket edukimit është abstrakt, i pamatshëm, nuk ka asnjë cak, nuk parasheh asgjë konkrete për arsimin tonë. Se kah po shkon sistemi arsimor në Kosovë dhe ai edukativ, qoftë në nivelin e ulët, qoftë në nivelin e mesëm, qoftë atë të lartë, këtu nuk thuhet asgjë dhe Qeveria nuk e di këtë gjë. Se a duhet të ndodhin reforma dhe çfarë reforma do të duhej të jenë ato, po ashtu nuk thuhet asgjë konkrete përveç se përdoren nocione shumë të njohura për publikun kosovar si Deklarata e Bolonjës ose si sistemi i Bolonjës. Masandej, kjo pjesë e Programit të Qeverisë, për mendimin tim, ka gabime dhe përmes këtyre gabimeve shprehet edhe moskontinuiteti i punës me ministritë pararendëse. Për shembull vetëm po e lexoj citatin: strategjia e përgatitur mbi zhvillimin e arsimit të lartë deri në vitin 2015 do të diskutohet në Universitet, në asociacionet e biznesit, shoqëritë civile, do të aprovohet në Qeveri dhe në Kuvend dhe do të zbatohet në mënyrë të vendosur – citat. E shoh se këtu ka nevojë vërtet për një informim themelor. Kjo strategji është diskutuar në forume të ndryshme, mandej ka patur një konferencë ndërkombëtare të mbajtur në Hotelin Grand me akademikë vendorë dhe perëndimorë.

Sygyerimi im është që kjo strategji për arsimin e lartë duhet të përmirësohet dhe duhet të realizohet në tërësinë e saj.

Njashtu, Ligji për arsimin e lartë, duhet – për mendimin tim, të plotësohet me ligje tjera bazike, ndërsa Kosova nuk ka strategji sa i përket arsimit parashkollor, shkollat fillore, të mesme, shkolla profesionale dhe kualifikime të përhershme a jetësor.

Sa i përket pagave të arsimtarëve, dhe në çfarë forme do të duhej të rriten ato, njashtu nuk ka asnjë të dhënë konkrete.

Masandej, pjesa e Programit për arsim vaazhdimisht përcillen me fjali të tilla konstatauese, citoj: në këtë moment është vështirë të parashikohet dhe të planifikohet e gjitha, në thojza. Ose, është e nevojshme që buxheti për arsimin të ketë rritje më të shpejtë dhe të sigurohen burime plotësuese financimi.

Shtrohet pyetja: çfarë na duhet neve një pjesë e Programit për arsim nëse nuk planifikon dhe nuk parasheh asgjë? Çfarë na duhet një program i tillë nëse nuk dihet se sa ka buxhet, sa do të rritet buxheti, si mund të rritet dhe nga do të sigurohen në thojza “ato burime tjera plotësuese”.

Me dobësi të njëjta programore, përcillet edhe fusha e kulturës. Unë mendoj se për Kosovën, si vend i vogël dhe për qytetarët e Kosovës si popull i vogël, është mëse e rëndësishme që të ketë kulturë, meqë ne e dijmë se kultura është ajo shpeshherë që inspiron popujt që të shkojnë përpara dhe kultura është ajo e cila iu cakton vendin dhe përmirëson imazhin e tyre në botë.

Mjerisht, sa i përket kulturës ka vetëm formulime. Është shumë romantike për kulturën, nuk definohet asnjë problem dhe mënyra se si... dhe shpeshherë pjesa e programit për kulturën përshkruan situata të cilat nuk ekzistojnë në kulturën tonë. Kulturën e sheh të izoluar, sikurse Kosova t’ ishte....

(ndërprerje nga regjia)

**BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Falemnderit, shpresoj se do t’ia bashkëngjitësh pjesën e diskutimit t’juaj Qeverisë.

Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Gazmend Muhaxheri.

**RAMADAN KELMENDI:**

I nderuari kryesues, i nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër, të nderuar ministra dhe deputetë,

Duke analizuar Programin e Qeverisë së Kosovës 2004-2008, vlerësoj se është një Program që meriton të përshëndetet, miratohet dhe si i tillë të funksionalizohet, natyrisht me angazhimin e të gjithëve.

Mirëpo, Qeveria e Kosovës ka patur të vështirë pikënisjen e hartimit të këtij Programi që na është prezentuar sot duke u mbështetur në këto fakte që mungojnë. Pa kompetenca të plota të shtetësisë, pa politikë ekonomike të përcaktuar, pa sistem ekonomik të përcaktuar dhe pa strategji të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Megjithatë, më lejoni që në kuadër të prioriteteve të paraqes disa angazhime kërkesore, të cilat do ta begatojnë këtë program të Qeverisë.

Nën 1. Kërkohej një angazhim më i shtuar në zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, i cili ditaditës po vdes në aspektin ekonomik, politik, intelektual, po rritet vrafëria, papunësia, si dhe investimet, në veçanti problemi i shëndetësisë si preokupim kryesor i qytetit.

2. Kërkohej angazhim në riaktivizimin e Trepçës ngase ekspertët vendor kanë vlerësuar se Trepça mund të punojë në kufij të rentabilitetit pozitiv ekonomik nga se posedon lëndën e parë dhe kuadrin e kualifikuar të punëtorëve.

3. Mendoj se sistemi gjyqësor duhet të pësojë ndryshim dhe veçanërisht ai korrigtohet duke u bazuar në ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë dhe në veçanti në emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve në bazë të kriterëve unike dhe jo si deri më tani.

4. Të rindërtohen shtëpitë e djegura në veriun e Kosovës, dhe në veçanti në pjesën e Mitrovicës veriore.

Mendoj se toka bujqësore duhet të pengohet të shndërrohet në tokë urbane, si dhe shfrytëzimi racional i sistemit ujor, në veçanti i sistemit Ibër-Lepenc dhe gjegjësisht Liqenit të Gazivodës.

Dhe, përfundimisht, pasi që gjërat parimore po i tejkaloj, kthimi i dokumentave të kadastrit, të pronës, librezat e punës dhe një mori të dokumenteve me interes për qytetarët duhet të jetë angazhim i Qeverisë së ardhshme dhe i këtij Programi. Ju falemnderit.

**BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Të falemnderit edhe ty për shkurtesë të saktë. Fjalën e ka deputeti Gazmend Muhaxheri, le të përgatitet deputeti Lulzim Zeneli.

**GAZMEND MUHAXHERI:**

I dëshiroj Qeverisë punë të mbarë dhe gjumë të ëmbël, se po duket që pushtetarët janë të lodhur.

Në lëminë e infrastrukturës dhe të planifikimit hapsinor, Qeveria është marrë me konstatime, mirëpo nuk e ka bërë asnjë planveprim konkret në këtë lëmi. Do të duhej të ishte përgjegjësi e Qeverisë mbrojtja e rrugëve nacionale dhe e korridoreve të rëndësishme dhe strategjike. Ju falemnderit.

**BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Po, mendova se po na zgjon nga gjumi Gazmend! Ti na vnovë me këtë.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, le të përgatitet deputetja Qibrije Hoxha.

**LULZIM ZENELI:**

I nderuar zoti kryesues, zoti kryeministër, ministra të Qeverisë së Kosovës, të nderuar deputetë, ju përshëndes dhe më lejoni t'i shpreh pikëpamjet e mia lidhur me draftprogramin e Qeverisë së Kosovës.

Së pari do të thoja se është edhe inkurajues fakti se Qeveria e Kosovës në ditët e para të funksionimit të vet ka arritur që me kohë të paraqesë para deputetëve të Parlamentit të Kosovës këtë draftprogram qeveritar, mbi bazën e të cilit do të udhëheqet vendi dhe do të ndërtohet Kosova gjatë këtij mandati.

Hartimi cilësor i këtij drafti, edhe një herë dëshmon qartë përkushtimin dhe seriozitetin e Qeverisë së Kosovës për të ecur përpara në ndërtimin e shtetit dhe zhvillimit të vendit. Ne përpara kemi një draftprogram të Qeverisë që përkon me interesat e qytetarëve të Kosovës, kemi një program i cili komponon angazhimin e institucioneve të vendit në funksion të përshpejtimit të procesit të pavarësisë së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Është bindje e thellë dhe argument i verifikueshëm se ky Program që sot po e diskutojmë është program që reflekton gamën e kërkesave dhe të nevojave të qytetarëve të Kosovës, është instrument i sakt se si duhet të ....

Prioritetet e programit Qeveritar janë sintetizuar me nevojat që shtron procesi politik në vend dhe që shtrojnë proceset zhvillimore. Implementimi i standardeve dhe vlersimi pozitiv i tyre në mesin e vitit 2005 baza e këtij programi obligon angazhimin maksimal të institucioneve të Kosovës. Shenjat e para të këtij angazhimi veç janë dëshmuar qysh në fillim të punës së kësaj Qeverie dhe një ritëm i tillë siguron se procesi i progresit në shumë fusha do të jetë evident dhe i prekshëm për qytetarët e Kosovës. Derisa në anën tjetër demonstron qart përkushtimi i Qeverisë së Kosovës në planin e zbatimit të standardeve që Kosovës i sjell përkrahje dhe partneritet të fuqishëm ndërkombëtar, ajo çka mund të thuhet lirisht dhe çka është shumë reale se ky draftprogram i Qeverisë është hartuar në mënyrë profesionale.

Në këtë program përpos ndërtimit të një Qeverie demokratike, që shumë prioritetet u cekën edhe më heret, Kosovës i garantohet një lëvizje progresive në fushat e ekonomisë nga gjendja stagnuese në të cilën ndodhemi sot. Pra, me këtë program qeveritar Kosovës i hapet perspektivë drejt një strategjie zhvillimore në shumë sfera vitale. Poashtu programi qeveritar si aneks ka edhe më shumë se 20 ligje që janë evidentur si prioritet në procesin e implementimit të standardeve, ligje këto që janë të parapara të hartohen dhe të miratohen me një dinamikë në periudhën e parë 6 mujore të funksionimit të qeverisë. Kjo na bënë të shpresojmë dhe të jemi optimist se ky program ka për bazë realitetin dhe specifikat ekzistuese në Kosovë dhe është program që synon në mënyrë graduale, por me hapa të shpejtë t'i lëvizë gjërat në drejtimin pozitiv.

Të nderuar kolegë deputet, tash është e ditur se Kosovën në 6 mujorin e parë e presin sfida të mëdha si në planin politik ashtu edhe në atë ekonomik. Që të kemi një proces rezultativ kërkohet zbatim i plotë dhe me kohë i këtij programi qeveritar. Natyrisht që nuk kemi iluzione që ky program është i përkryer, gjithnjë duke pasur hapsirë që ky program të begatohet edhe mëtej, unë do të sygjeroja që në segmentin e energjigjës dhe të minierave si interes strategjik për Kosovën t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Poashtu jemi të vetëdijshëm se përkushtimi i vendosur i qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera do ta bëjnë që ky Program të jetësohet me kohë dhe në dinamikën e paraparë të kemi rezultate konkrete. Ju faleminderit.

## QIBRIJE HOXHA

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, i nderuar kryeministër, të nderuar ministra më lejoni ta përgëzoj Qeverinë për programin e prezentuar dhe të kaloj në sygjërimin tim konkret.

Te prioritetet e programit të Qeverisë për diasporën mendoj se duhet të kompletohet ose që të zbërthehen dy çështje shumë të rëndësishme për bashkatdhetarët tanë dhe Kosovën njëkohësisht e këto janë: nën një, bashkatdhetarëve tanë në diaspor duhet t'ju mundësohet e drejta e regjistrimit në mënyrë normale, d.m.th e drejta e regjistrimit në Kosovë, duke mënjanuar procedurat tejet të komplikuara dhe të panevojshme, të cilat ekzistojnë sot dhe të cilat vështirësojnë dhe nganjëherë edhe u pamundësojnë mërgimtarëve tanë të lindur në Kosovë që të regjistrohen dhe të evidentohen

si qytetarë të Kosovës. Kjo çështje e pazgjidhur e regjistrimit të bashkatdhetarëve tanë krijon edhe një padrejtësi për diasporën tonë dhe kjo është e drejta e pamohueshme e bashkatdhetarëve tanë për të marrë pjesë në zgjedhjet nacionale të Kosovës, e drejtë kjo elementare njerëzore e garantuar me konventat për të drejtat e njeriut. Mendoj se edhe me këto zgjedhje si në zgjedhjet e kaluara, procesi zgjedhor demokratik në Kosovë ka qenë i dëmtuar, sepse diasporës tonë padrejtësisht ju pamundësua që ta shprehin mendimin e vet dhe që të votojnë. Kosovës në të vërtetë i mungon zëri i bashkatdhetarëve tanë, të cilët përkohësisht ndodhen jashtë Kosovës që sigurisht kanë rolin e vetë pozitiv në proceset demokratike në Kosovë. Ju faleminderit.

## RAMË BUJA

Të nderuar koleg deputetë, i nderuari z. Kryeministër me stafin ministror, i nderuar kryesues,

unë kam menduar t'i prek disa segmente, të cilat nuk i prekën kolegët e mij të nderuar, por me që u fol për kulturën dhe fare zbehtë është pasqyruar në programin qeveritar edhe pse po ju them se për kohën që ka pasur Qeveria meriton për ta përgëzuar dhe përshëndetur për punën që ka bërë, por me sa di unë Kuvendi i legjislaturës së kaluar ka miratuar ligjin për Komplexin memorial "Adem Jashari" dhe për përkujdesjen e tij dhe për bërjen e tij, ndërsa në programin qeveritar nuk është përmend asnjë fjalë. E para, është shumë e qartë që këtu tani kemi standardet, është shumë e kuptueshme për faktin që synojmë 2005-tën, fillimin e asaj që quajmë në shumë përmbajtësore dhe është përmbajtësore për realizimin e statusit final të Kosovës.

Qeveria është dashur të mendojë që në programin e saj të fus çështjen sa ka kompetenca aq të përmbush standarde dhe diçka që duhet ta them në deputetët që debatojmë mund ta përdorim sintagmën do të duhej, por në programin qeveritar nuk është dashur të jetë, e ajo është përdorur me dhjetra herë. Çështja që e përmendi dikush nga kolegët e nderuar se decentralizimi nuk është i futur me nuanc të veçantë në standardet, ai është ekstra standard, qysh është ekstra standard edhe kthimi edhe lëvizja e lirë dhe për këto gjëra programi qeveritar flet fare pak, e themë se janë ekstra standarde për konsum të brendshëm dhe të jashtëm, ndërsa një ekstra standard i veçantë për të cilin flet fare pak programi qeveritar është energjetika në Kosovë. Flitet për joshjen e investitorëve të huaj e të brendshëm dhe mungon rryma mbi gjysmën e ditës dhe kjo kend do ta josh, kend do ta provokojë në kuptimin pozitiv të vijë dhe të investoj në Kosovë, pak është folur për të.

'Çështja e decentralizimit a do të duhej të shihej si pjesë e reformës pushtetore në Kosovë? Ju e dini mirë që qeveria e mandatit të kaluar ka bërë një draft apo kornizë të këtij veprimi dhe do të ishte shumë jopërmbajtësore dhe joprofitabile që të kalohet ajo, sepse edhe pse janë bërë lëshime, përsëri është bërë një kornizë shumë përmbajtësore dhe ky decentralizim nuk do të duhej të ndodhë dhe bile nuk është dashur as të thuhet siç thuhet në program që do të ketë mundësi të privilegjojë minoritetet, sepse unë mendoj që duke i ndarë ata nuk i privilegjojmë, por duke i ndarë i diskriminojmë.

Pjesa për decentralizimin është dashur të përmbajë atë që decentralizimi duhet të ndodhë si pjesë e reformës për të gjithë qytetarët e Kosovës, në të kundërtën nuk kemi bërë asgjë. Kthimi aq shumë i përfolur, kthimi nuk ka mundësi të ndodhë, nëse ka synime që shumë nga të rinjtë për paperspektivën që kanë në Kosovë të shkojnë nga Kosova dhe të mendojmë se do ta realizojmë kthimin, a në veçanti kthimi nuk mund të ndodhë për faktin se nuk ekziston bashkëpunimi më elementar i mundshëm me pakicën, për të cilën janë bërë ato rregullativa dhe e cila synohet të kthehet, dhe çështja e sigurisë dhe lëvizjes, këtu ka vend sintagma "do të duhej" sepse Qeveria dhe mekanizmat shtetëror të Kosovës tash nuk kanë kompetencë që të garantojnë këtë gjë. Dihet kush e ka sigurinë dhe atëherë po e përsëris krijt në fund do të duhej të mendohej në raport me

kompetencat të realizohen edhe standardet e mundëshme, sepse në të kundërtën nuk ka mundësi të bëhet. Ju faleminderit.

## FEHMI VULA

I nderuar kryesues, i nderuari ministër dhe ministra dhe ju deputetë, do të dëshiroja të flisja për ate që di ma mirë, e këto janë problemet e shëndetësisë, por në programin e mirë të Qeverisë është shkruar shumë pak dhe në viza shumë të trasha, prandaj është shumë vështirë që sot ta elaborojmë këtë problematikë. Një gjë është e vërtetë se shëndetësia e Kosovës ka nevojë shumë të madhe për një shërim të mirëfillt. Kisha edhe disa propozime në sferën e ekonomisë, kryesisht u thanë e unë do ta potencoja vetëm edhe një gjë në lidhje me ndërmarrjet e transformuara që sot i quajmë aksionare. Para 3 muajsh AKM-ja është përgjigjur në një letër të një asociacioni përkatës ku thonë se qenka shumë vështirë të zgjidhet problemi i shoqërive aksionare. Unë mendoj se ky problem patjetër duhet të futet në program të Qeverisë. Edhe jam shumë i bindur se ndërkombëtarët nuk

kanë mundësi ta zgjidhin këtë, prandaj jam i bindur se vendorët do të jenë në gjendje me e zgjidh këtë problem. Ju faleminderit.

## IBUSH JONUZI

Z kryesues, z. Kryeministër, ministra të nderuar dhe kolegë deputetë ju përshëndes. Programin e hartuar në fillim të punës së vetë Qeverisë është për t'u përshëndetur dhe duhet dhënë mbështetje të plotë nga ky Kuvend. U tha edhe më heret për çështjen e energjetikës dhe do të ndalem shumë

shkurt. Të vetëdijshëm se ministria e energjetikës është formuar tani, për të cilën ka pasur nevojë shumë heret dhe nevojë shumë të madhe, prandaj kjo ministri duhet të bëjë maksimumin e mundshëm për të mposhtur kancerin e krijuar të energjisë elektrike në Kosovë pa dashur të komentoj se çka duhet të veprohet për të fituar ate që u tha më heret edhe simpatinë, gadishmërinë e investuesve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë në Kosovë.

E dyta, duke e pasur parasysh potencilin e madh të pasurive që posedon Kosova, të atyre metalike dhe jometalike Qeveria, respektivisht ministria përkatëse duhet të ketë një plan të veprimit konkret për minierat, të cilat mund të aktivizohen dhe sado pak do të ndikojnë pozitivisht në aspektin ekonomik në Kosovë. U tha edhe më heret se kjo është një çështje që Qeveria, respektivisht ministria përkatëse duhet ta ketë në prioritet.

Nën tre, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë shumë në përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, megjithatë unë do të ndalem shkurt për të dhënë një pasqyrë për gjendjen në komunën e Vushtrisë. Në shkollat e qytetit është punuar deri më tani në 4 ndërrime për shkak të mungesës së lokalit, kurse tani punohet në tri ndërrime, me orar të shkurtuar prej 30 minutash. Pyetja është shumë e qartë se çfarë rezultatesh mund të priten aty. Në 4 shkolla të fshatrave janë bë renovime të disa kthinave që me asnjë normë pedagogjike nuk i plotësojnë kushtet për zhvillim normal të mësimin dhe në 3 fshatra nxënësit e ciklit të ulët udhëtojnë nga 8 kilometra në dy drejtimet që edhe kjo është për brengosje të madhe. Prandaj nga kjo që e thash më lartë kërkoj nga Qeveria, respektivisht Ministria e Arsimit që gjatë hartimit të planit investues të ketë një prioritet edhe në komunën e Vushtrisë. Ju faleminderit.

## FEHMI MUJOTA

I nderuari kryesues, i nderuari kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë, të shikosh programin qeveritar prezentuar sot dhe po të mbështetesh në çështjet konkrete dhe reale që mund të zbatohen

gjatë mandatit sa do të ketë Qeveria duhet pasur mjaft kujdes për të sqaruar ato gjëra që janë thënë dhe janë mjaftë kurajuese, por njëkohësisht duhet të ketë vend për shqetësimin se janë të arritshme në terrenin tonë të Kosovës akoma ende të padefinuar në kuptimin juridik dhe politik. Andaj unë do të ndalem në çështje shumë konkrete për të dhën vërejtje në dy fusha të caktuara. Por e para është domosdoshmëri për një lëshim në programin qeveritar që i përngjan asaj që sikur të kenë qenë njerëz që dinë për disa vende se ekzistojnë diku në Kosovë ose nuk kanë qenë asnjëherë në ato vende. T,i jep plotësime z. Buja dhe e përmendi Prekazin, por në programin qeveritar nuk është përmend askund Reçaku dhe të gjithë e dini se këto dy vende janë shumë emblematike për identitetin tonë kombëtar si vend.

Prandaj plotësoj edhe një premtim para elektoratit të partisë demokratike të Kosovës dhe në zonën time se çështja e parë që do t'ia adresoj Kuvendit të Kosovës është ngritja e kompleksit përkujtitor në Reçak dhe atij në Prekaz dhe këtë e mbështes në dy arsye që do t'i kontribuonin Qeverisë në punën e saj të mëtutjeshme. Duke pasur parasysh se në Kosovë ka mundësi sipas

paragjyqimeve të ketë tepriçë buxhetore atëherë që tani të zëmë hapin që të paktën për vitin 2005 të parashikojmë mjete buxhetore në shumën prej 3 milionë euro për Prekazin, 2 milionë euro për Reçakin dhe 1 milion euro për varrezat e dëshmorëve anë e kënd Kosovës.

Besoj se Parlamenti do t'i japë mbështetje Qeverisë nëse këto çështje i fut në programin e vet dhe do t'i bëj nderë Kosovës. Çështjet tjera që do të dëshiroj t'i adresoj në plotësim të Programit të Qeverisë në fushën e politikës sociale, vetëm do t'i korigjoj disa thënie që erdhën nga kolegët tanë më herët dhe këtu kemi të bëjmë me ligjin për familjet e dëshmorëve dhe të rënë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe invalidët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjitha kategorive tjera që kontribuan për lirin e Kosovës. Këtu dueht të ketë ndarje në emërtim të ligjit dhe duhet të ketë një precizim vlerash dhe hierarki vlerash, prandaj kjo nuk është e vetmja çështje që do të ndihmojë në këtë drejtim, por në kuptimin e fushës sociale do të ketë mjaft probleme dhe Qeveria është shumë e vetëdijshme dhe unë e vlerësoj atë shkrimin e saj që nënkupton se nuk ka fonde të mjaftuara për zgjidhjen e këtyre problemeve, por nuk na ofron alternativat, përkatësisht nuk na ofron politikën se si duhet të kaloj kjo çështje dhe unë do të sugjeroja 5 pika apo 6 pika sygjerime për të krijuar politika në fusha të caktuara. Kjo nënkupton se mungon politika për fondet e pensioneve të plaçkitura në Serbi, se si do t'i kthejmë ato dhe si do t'ua plotësojmë kërkesat pensionsionistëve. Mungon çështja e rregullimit të pensionistëve që kanë dhënë kontribute për pensionet e tyre dhe duhet bërë kategorizimi në mes atyre që kanë dhënë kontributin dhe atyre padrejtësisht dhe pa fajin e tyre që nuk kanë punuar në asnjë institucion. Duhet të kem parasysh se mungon strategjia e shkallëzimit të kësaj kategorie dhe gjithsesi kolegët më përpara përmendën Trustin Pensional, duhet të kem një politikë dhe strategji për kthimin e këtyre fondeve që ndodhen jashtë Kosovës. Përmirësimi i mirëqenies sociale mungon në tekstet e Qeverisë, sikur që problem shumë i mbreht është papunësia dhe bazimi në zyrat e punësimit që janë surogat institucional, gjithsesi nuk do t'i bëjmë një shërbim të mirë Qeverisë për t'u mbështetur në to dhe në institutet të cilat merren me hulumtimin e papunësisë në Kosovë. Dhe gjithsesi duhet përmendur edhe çështjen parametër që u ofrohen papunësisë në Kosovë dhe afatet Qeveria do të duhej përcaktuar. Ju faleminderit.

## FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

I nderuari kryesues, ministra dhe deputetë, në fillim desha vetëm një vërejtje, sepse unë jam Fatmire Mulhaxha Kollçaku. Unë desha të përqëndrohem në sektorin e shëndetësisë dhe në rend të parë desha të cekim meqenë se ne e kemi ligjin për shëndetësi të miratuar nga përbërja e kaluar e Kuvendit dhe mendoj se programi qeveritar duhet të përqëndrohet shumë më tepër në implementimin e ligjit, gjegjësisht në mbikëqyrje dhe kontroll të veprimtarisë shëndetësore, si asaj publike, ndërsa në veçanti të asaj private.

Nëse kemi parasysh se ne kemi shumë pak qasje në institucionet shëndetësore dhe private ku si shembull e kisha marrë vetëm Pejën ku 9 prej tyre kanë të drejtë ushtrimi të kësaj veprimtarie. Kjo fillimisht dëmton buxhetin e Kosovës, po në anën tjetër kemi mungesë të raportimit të sëmundjeve, parregullsi të shumta që reflektohen në respektimin e orarit të punës, të kuadrit që punon edhe në sektorin privat dhe publik, cilësinë e punës e në anën tjetër edhe në monitorimin dhe kontrollin që do të kontribuonte edhe në largimin e shumë dyshimeve në prishje të shpeshta të aparaturave të shtrenjta dhe të reja, mungesën e përhershme të reagencave në institucionet shtetërore dhe orientimi i të sëmuarëve në institucionet private ku cilësinë nuk e dimë, por e dim që shërbimet paguhen shumëfish më shtrenjtë dhe kjo e rëndon edhe ashtu buxhetin e rënduar të anëtarëve të familjeve të Kosovës.

Si pik tjetër është fondi i sigurimit shëndetësor. Në programin qeveritar nuk kemi të përcaktuar afatin kohor, ndërsa në ligjin për shëndetësi figuron se do të starton prej 1 janarit 2005. Ne mendojmë dhe nuk e dim se cili model do të mirret. Gjithashtu ne mendojmë se kjo do të duhej të

jetë prioritet për funksionimin e sistemit si tërësi, dhe në fund isha përqëndruar në kategorinë e njerëzve me kategori të veçanta dhe në invalidët e luftës, ku mendoj se në programin qeveritar nuk është shkuar më shumë se asistencë sociale, e unë mendoj se kjo krijon një ndjenjë të diskriminimit të kjo kategori e njerëzve me qenë se në mungesë të infrastrukturës adekuate, shëndetësisë adekuate, ata ndihen të diskriminuar në mundësinë për arsimim dhe punësim që do t'ju krijonte mundësinë për një jetë dinjitoze. Ju faleminderit.

NASER OSMANI

I nderuari kryetar, e nderuara Qeveri, të nderuar deputetë, mendoj që programi është një përmbledhje e të gjitha atyre nevojave të cilat duhet realizuar në këtë mandat, por i cili ka nevojë për një shfletim, për një detajizim në mënyrë që të jetë i zbatueshëm në praktikë. Mendoj që të gjithë diskutuesit deri më tani kanë diskutuar në të gjitha fushat. Mendoj të përqëndrohem në dy çështje. Mirëpo, mendoj që më mirë do të ishte që ministrin apo kabinetin të tij t'ia parashtroj me shkrim dhe atë: administratën publike, shtetin ligjor dhe luftën kundër korrupsionit. Mendoj që të jetë më mirë i definuar pengimi i korrupsionit se Kosova nuk është Panama që të ketë luftë të korrupsionit dhe atë në çështjet e transparencës për përgjegjësitë e sanksionuara për zyrtarët e prokurimit si dhe për politikën kadrovike në resorët ku ka deficit kadrovik, si dhe në çështjet e ekonomisë që kanë të bëjnë me rritjen e ekonomisë dhe të punësimit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, për politikën fiskale si dhe për politikën subvencionale që duhet të ndërmerret për të stimuluar prodhuesit vendor.

Për të pasur një progres të përgjithshëm në ekonominë kosovare mendoj që për ta begatuar këtë program t'ia paraqes me shkrim që të mos marrë kohë. Ju faleminderit.

FADIL KRYEZIU

Mendoj se diskutimi për programin e Qeverisë është një kualitet i ri që ndodh në këtë Parlament e që duhet rrespektuar dhe që flet për një vullnet të fuqishëm të kësaj Qeverie për një angazhim të gjithanshëm në drejtim të përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarëve. Mision kryesor mendoj që është edhe kjo, natyrisht në rrugë e sipër dalin edhe probleme të tjera, si ajo që është puna në drejtim të njohjes së pavarsisë së Kosovës dhe natyrisht para kësaj përmbushja e disa standardeve që qoftë ne këtu, qoftë në media spekulojmë për çdo ditë dhe flasim pa i precizuar gjërat dhe mua më kurajon fakti që Qeveria e ka nxjerrë një agjent më konkrete që t'i qaset kësaj problematike. Në këtë program është e vërtetë që ka një gjithpërfshirje të sferave të ndryshme të interesimit të qytetarëve, gjë që mendoj se këto vlersime janë nxjerrë nga hulumtimi i opinionit qytetar që ne përfaqësojmë dhe jo vetëm nga angazhimet e OJQ-ve siç tha një parafolës për arsye se partitë



politike, pastaj edhe vetë qytetarët me votat e tyre krijojnë sistemin politik, krijojnë shtetin, OJQ-të vetëm e plotësojnë atë.

Në këtë plan mendoj se Qeveria po merr përsipër angazhime shumë të fuqishme dhe angazhimet e saj të deritashme dhe paraqitja para këtij Parlamenti e një programi jo shumë voluminoz për të përgjithësuar, flet që ka dinamizuar jetën në Kosovë dhe ministrat së bashku me kryeministrin marrin përgjegjësinë mbi supet e veta për realizimin e këtyre synimeve.

Rritja e përgjegjësiave për administratën lokale që përmendet në program të Qeverisë, mendoj që nuk është mirë ose jo definitivisht e precizuar, për arsye se administrata jonë lokale, e cila është më afër qytetarit, më afër atij që duhet rregulluar jetën dhe përmirësuar kualitetin e jetës, që ballafaqohet me probleme të ndryshme e të cilave nuk është në gjendje ajo t'u dal zot, qoftë duke implikuar edhe vetë AKM\* në këtë drejtim që ka marrë shumë prona të komunave dhe nuk i len

t'i menagjojë dhe madje sjell deri aty sa që komunat nuk kanë mundësi dhe hapsirë që një shkollë ta ndërtojë, por duhet që të blejnë trollin e saj.

Unë i propozoj Qeverisë që t'i qaset skemave sociale që përmenden në programin e saj dhe në këtë plan pra të rishqyrtohen. Ndonjëherë krijohet përshtypja që ne do të krijojmë një shtet social dhe shpeshherë kategoritë që marrin ndihma sociale dalin kategori që përfitojnë më së shumti nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Përveç ndihmave sociale që marrin, ata lirohen nga pagesat e rrymës, nga pagesat e shërbimeve të tjera komunale dhe del që njerëzit që punojnë duhet të jenë më të diskriminuar. Për politikën buxhetore do të ndalem në rastin tjetër kur buxheti për vitin 2005 do të vijë në Parlament. Dhe së fundi do të doja që në procesin e implementimit të ligjeve të ketë një kujdes të veçantë, një përqëndrim më të shtuar të Qeverisë sepse ne kemi sjellur mjaft ligje dhe janë votuar në këtë Parlament dhe nuk kemi informacion se sa ato drejtëpërdrejtë vëhen në jetë, prandaj përqëndrimi do të duhej të jetë më i madh.

Unë uroj Qeverinë për programin, punën që po bën dhe dëshiroj t'i siguroj edhe kolegët tjerë deputetë që Qeveria sigurisht në fund të vitit të ardhshëm do të parashtrijë raport dhe në raport në realizimin e këtij programi dhe interesimeve tjera që dalin do të mund dalin edhe angazhime që e plotësojnë këtë program të Qeverisë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

**FETAH BERISHA**

I merituari z. Kryetar,

Të nderuar, i ndruari Kryeministër ministra dhe zëvendësministra,

Të nderuar kolegë deputet, programi të cilin e kemi para dhe po e shqyrtojmë, po debatojmë unë kamë veqar dy segmente, politika agrare dhe zhvillimi rural në këtë temë është përmendur, janë përmendur edhe përparësitë e bujqësisë, po mua ma thotë mendja se një segment shumë me rëndësi është dashur të zë vend aty pak më gjërë, e ky segment është segment i vreshtarisë, fjalën e kamë për sektorin privat, në ato treva të Kosovës ku kultivohet hardhija e rrushit siç është Theranda dhe Rahoveci i mrekullueshëm.

Në vitin e kaluar Ministria e bujqësisë patë marrë një iniciativë të tillë që të stimulohet sektori privat, në vreshtari por kjo iniciativë ngeli e pa përmirësuar dhe nën dy: kamë veqar një segment ku bëhet fjalë për arësimin, meqë unë kamë qenë punëtor arsimit dhe kamë udhëhequr arsimin këto katër vite në komunën nga vi, nuk do flas për reformat në arsim për depolitizimin në arsim, për

depolitizimin në arsim, jodiskriminimin por këtu në program është përmendur edhe fjala e paralelizmit.

Fjalën e kamë te paralelizmi në arsim ku lidhet me integrimin e minoritetit serb, minoriteti serb duhet integruar realisht në sitemin arsimor të komunave tona. Ata janë të integruar vetëm në aspektin teknik pra ne meremetojmë shkollat, paisim ndërsa në aspektin pedagogjik nuk janë të integruar dhe nuk bashkëpunojnë me drejtoritë komunale të arsimit. Pra nuk bashkëpunojnë në planin e planprogrameve, të konkurseve, ata edhe sot e kësaj dite shpërblehen me dy paga, një nga Ministria e vetë të Sërbisë dhe një nga Ministria e Arsimit të Kosovës.

Në përfundim, për ndryshe programi është mjaftë gjithpërfshirës me një sintaksë të ngjeshur, me fjali të thukta logjike të cilat ngërthejnë në veti plotë nënkuptime por duhet lexuar me vemendje dhe kuptuar drejtë.

Kryeministrit dhe Qeverisë i uroj punë të mbarë edhe në të ardhmen në zbatimin e këtij programi për të mirën e Kosovës.

Ju falemnderit!

Kryesuesi: Ju falemnderit!

SELVIJE HALIMI

I nderuari Kryetar i parlamentit, i nderuari Kryeministër dhe ministra të nederuar deputet!

Meqenëse shumçka u cek në këtë nga deputetët dmth. Vrejtjet e tyre dhe sygjerimet për programin e ovruar apo dreftprogramin e ovruar nga Qeveria, unë do të fokusohem në disa çështje sa i përket pikës 3.5. gjegjësisht shëndetësisë. Është një draftprogram i ofruar sa i përket shëndetësisë në mënyrë shumë të përgjegjësuar që lenë nënkuptoj se në fund të mandatit do të kemi shumë lehtë mundësinë që të ikim nga përgjegjësia ngase gjërat nuk janë të parapra në mënyrë precize dhe të afatizuara, të mundshme për realizim dhe të matshme.

Kjo të jepë me kuptue se si duket nuk është konsultuar mjaftë raporti i Ministrisë së shëndetësisë në mandatin e kaluar dhe thuajse të gjitha punët që janë nisur të bëhen në mandatin e kaluar mbesin si atribute se do t'i bëjë kjo Qeveri. Kështuqë, mendoj se duhet hartohet një program, duke pasë parasysh punën në kontinuitet. Më ka ra në sy një fjalë ku thotë se Qeveria do të insistojë në përmirësimin, konsolidimin dhe funksionimin më me përgjegjësi në strukturat menagjeriale në QKU dhe të gjitha institucionet tjera publike shëndetësore.

Unë mendoj se Qeveria nuk mund të përdorë shprehjen insistojë ngase ajo është ligji mbi shëndetësinë i aprovuar nga ky Kuvend dhe është punë e Qeverisë që të krijojë struktura për implementimin e atij ligji, që të shpejtojë procedurat për nxjerrjen e akteve nënligjore që do ta plotësojnë ligjin e shëndetësisë dhe ligjeve të tjera të cilat kanë të bëjnë me shëndetësinë në Kosovë, dhe të implementohet legjislacioni.

Për të arritur gjithë këtë unë mendoj se programi i Qeverisë sa i përket shëndetësisë duhet të fokusohet në tri gjëra: mbështetja apo përkrahja e shërbimeve primare, sekundare dhe terciare dhe krahas kësaj investimi në shërbimet shëndetësore preventive. Për të arritur këtë Qeveria duhet që të kushtojë një kujdes të veçantë krijimit të një sistemi financiar të qëndrueshëm për sektorin e shëndetësisë, pastaj të ketë kujdes në implementimin apo zbatimin e standardeve dhe normave si në

institucionet publike shëndetësore ashtu edhe në ato private, dhe gjithashtu të investojë apo të marrë hapat që të krijojë një sistem të unifikuar në informimin e shëndetësisë.

Ju falemnderit!

Kryesuesi: Ju falemnderit

GENC GORANI

Z.Kryetar, zonja dhe zotërinjë deputet, zoti Kryeministër, përshëdnes paraqitjen e programit të Qeverisë së Kosovës

Dua të besoj se Qeveria është e përkushtuar t'i angazhojë të gjitha resursret e mundshme në mënyrë më optimale për realizimin e synimeve tona kapitale. Duke marrë parasysh kohën prej formimit të koalicionit qeverisës dhe duke marrë parasysh dallimet programore në mes të dy partive kryesore të

koalicionit është në kufij me mrekulli shpejtësia me të cilën ky program ka arrajtë të hartohet. Mbasi kjo e spjegon edhe përceptësinë e shtjellimeve, çështjeve aq të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës.

Për ilustrim në mes të shembujve të shumtë, do t'i theksoj vetëm dy për këtë rast, shembulli i parë ka të bëjë me elaborimin e sektorit të turizmit dhe të shërbimeve në kuadrër të kapitullit tre, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Zonja dhe zotrinjë, përmbledhja e elaborimit të tërë këtij sektori më pakë se dhjetë rreshta, dëshmojnë për injorim të thellë të potencialit ekonomik dhe social të këtij sektori në Kosovë. Ndërmarrësit aktual dhe investitorët potencial në këtë sektor, kanë nevojë për qëndrim të kjartë dhe të fortë të Qeverisë për interesin që ka ky sektor ekonomik në zhvillimin tonë afatmesëm.

Ndërkaq, Qeveria propozohet të luajë rolin e një pedagogu, por citojë ngritjen e kulturës turistike në Kosovë, shembulli i dytë ka të bëjë me vendin që i është rezervuar sektorit të telekomunikacionit në këtë program të Qeverisë, në faktë do të ishte dashtë të flitet për sektorin e informatikës dhe të telekomunikacionit.

Ky sektor praktikisht në mbarë botën është një prej sektorëve më dinamikë, faktikisht me dinamikë më të lartë të zhvillimit, me rëndësi strategjike për të gjithë sektorët tjerë shoqëror dhe ekonomik, sektor transformues i shoqërive moderne i ndërlidhjes dhe të interakcionit përbrenda vendit dhe me vendet tjera.

E pra zonja dhe zotrinjë, këtij sektori i është përkushtuar vetëm një fjali dhe atë në një formë gjenerike që nuk iu shpije askund. Asnjë vizion dhe asnjë strategji në lidhje me teknologjitë e informacionit dhe të komunikacionit. Ndërkaq neve na duhet të dijmë se çka dhe si kjo Qeveri planifikon në këtë sektor. I dua të gjithë sektorët e ekonomisë, shëndetësisë, arsimit, rendit publik, administratës, i duhet medijave të rinjëve dhe atyre më pak të rinjë dhe i duhet çdo shoqërie që pretendon të ketë sukses në ndërtimin e demokracisë.

Zonja dhe zotrinjë deputet, nuk mund të aprovohet me votim një program me mangësi të tillë. Ky program edhe pse në start të draftit nuk ka qenë nevoja të prezentohet në stadin embrional. Qeveria duhet të merrë këtë program dhe të bëjë një elaborat. Meqë jemi në prag të festave dhe diskutojmë me një ton pak ma pozitiv. Zonja dhe zotrinjë të koalicionit fitues, ky program i ka të gjitha karakteristikat e një programi paraelektoral. Më lejoni të përkujtoj zgjedhjet kanë marrë fund dhe nuk kemi nevojë më për programe të tilla, është koha e fundit t'i përvjelim mangët dhe në rend të parë kjo vlenë për Qeverinë.

Falemnderit për komentin.

Kryesia: Ju falemnderit, Safete Hadrxonaj, le të bëhet gati Xhavit Haliti dhe i lutë të gjithë deputetët që janë jashtë sallë të këthehen se jemi shumë afër përfundimit dhe futjes në proces të vendim-marrjes.

## SAFETE HADËRGJONAJ

I nderuari zoti Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, të nderuar deputet

Kamë pritur që në shqyrtim do të na ofrohet një program qeveritar, strategjik dhe operativ afatmesëm ku do të përcaktoheh objektivat trevjeçare, qasja metodike dhe programi trevjaçar i masave publike prioritare me një vizion të qartë dhe objektiva të qetësuar të vlerësueshme dhe të monitorueshme ku përcaktohen qartë edhe rolet edhe përgjegjësitë, që në analizë të fundit do të na

qojnë në përmbushjen e qëllimit bazë të Qeverisjes, shtetët të Kosovës, orritjes së nivelit të jetesës së qytetarëve të Kosovës dhe për afrimin e këtij niveli me atë rajonal dhe europere ndimor. Por si duket do të kemi një program që i hapë perspektivë qytetarit të Kosovës për një jetë më të mirë.

Kur përfundon së analizuari do të ndodhedhemi para dilemave, ky program është punuar nga ekspertët, nga individit, apo janë shenuar sugjerime të tjerëve se si duhet vepruar. Unë kamë përshtypjen se më tepër janë paraqitur sugjerimet se si duhet të punojë Qeveria, se sa objektiva të qetësuar, se qfarë qasje do të ketë Qeveria në çështje të caktuara.

Qeverija duhet, të marrë masa duhet për të ngritur efektivitetin dhe të siguronë, duhet të zbatojë, duhet të evitohet qartësitë e tjera, etj. Se qfarë duhet të bëjë Qeveria është e qartë për ne dhe qytetarët e Kosovës por çka do të bëjë Qeveria si do ta bëjë dhe çfarë alternativash do të ofrojë për zgjidhjen e çështjeve kyçe, këtë nuk e shohin në programin e Qeverisë, apo kjo është metodë e ikjes së përgjegjësisë në të ardhmen se ne kemi thënë se duhet ta bëjmë por nuk kemi thënë se do ta bëjmë. Pajtohem me ato që tha kolegu im i nderuar z.Bajram Rexhepi për programin ekonomik, por dua të shtojë se për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është e nevojshme një reformë tërësisht transformuese e kualitetit ekonomik, nepërmjet një vlerësimi të hollësishëm profesional dhe të përgjegjshëm të resurseve që vendi i disponon për të mundësuar sa më shpejtë optimizimin e përdorimit të tyre. Mundësitë e shkëputjes nga elementet frenuese dhe të hyjë në një sektor më të qëndrueshëm ekonomik.

Të nderuar deputet, duke analizuar ato pakë fjalë që janë thënë për turizmin dhe shërbimet kamë përshtypjen se hartuesi nuk ka analizuar se në qfarë shkale të zhvillimi është turizmi, nuk ka vizionin se kah do të shkojë kjo degë e rëndësishme e ekonomisë dhe si duhet të arrijë në cakun e dëshiruar. Qeverija duhet të mendojë më seriozisht në zhvillimin e potencialeve turistike të cilat natyra i ka falur vendit tonë për ta këthyer turizmin në një potencial të vyer në dobi të mirëqenjes individuale dhe të zhvillimit ekonomik.

Kosova i ka resurset natyrore dhe potencialet humane për të krijuar industrinë e turizmit si një degë me peshë në prodhimin e brendshëm bruto. Por kapacitetet profitabile të ekonomisë turistike të Kosovës dhe resurset me perspektivë për valorizimin turistik janë jashtë rrjedhave turistike të Kosovës. Disa kapacitete që gjenden në funksion shfrytëzohen pjesërisht ndërkaq disa objekte turistike janë në shfrytëzim nga komuniteti ndërkombëtar.

Në degën e turizmit dhe të hotelierisë ndihet mungesë e madhe me profile përkatëse të kualifikuara, është domosdoshmëri e Qeverisë që t'i qaset më seriozisht politikave të turizmit, përmes të cilave do

të rikëthehen objektet turistike, do të ndërtoheshin profile të kualifikuara, si do të zhvillohej industria e turizmit e cila siguron punësim dhe përfitime ekonomike.

Turizmi cilësor është i rëndësishëm për Kosovën, në këtë kontest prioritetet e Qeverisë të konsistojnë në, hartimin e strategjisë së turizmit ashtu që gjatë ditëve të ardhshme të zhvillohet një infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e turizmit në bashkëpunim me investitorët. Hartimin e planeve regjionale hapsirore dhe të zhvillimit të turizmit.

Stimulimin e degëve të caktuara të turizmit të cilat do të nxisin zhvillimin e ekonomisë së vogël në lëmin e turizmit dhe shërbimeve, rishikimi i kuadrit ligjorë për investime në këtë fushë në objektivë ruajtjen e pjesës së padëmtuar e të potencialeve natyrore turistike, korigjimin në maksimum të atyre aseteve që janë dëmtuar për shkak të situatës në Kosovë me shumë efektivitet në zbatimin e kuadrit ligjorë që është miratuar, do të miratohet, duhet të përbëjmë prioritete të veçanta të Qeverisë së re.

Qeverija të angazhohet që neprërmjet zhvillimit sasior dhe cilësor të turizmit dhe shërbimeve të krijojë një identitet të ri në ekonominë e Kosovës. Të nderuar kolegë deputet, të gjitha këto që i

thash unë dhe kolegët e mijë nuk janë thjeshtë për të bërë zhurmë në parlament, por janë me qëllimin më të mirë që të kontribuojnë në përcaktimin e faktorëve favorizues si dhe në përcaktimin e objektivave dhe masave prioritare që programi të jetë sa më real, i zbatueshëm dhe në të mirë të mirëqenjes së qytetarëve.

Ju falemnderit.

Kryesia: Ju falemnderit, Shaban Halimit i kërkoj falje por ra mirë se gjinisë i dhamë përparësi edhe opozitës, urdhëro Shaban

Shaban Halimi

Ju falemnderit i nderuari zotri Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, zëvendësministra, të nderuar deputet

U diskutua mjaftë lidhur me Programin e Qeverisë i cili u prezentua sot para nesh, unë shprehi bindjen time se ky program është vërtetë program gjithëpërfshirës dhe nuk mund të jetë program operativ, sepse programet operative i përkasin ministrive përkatëse për lamitë ose fushtat të cilat janë identifikue. Ajo që është e rëndësishme dhe me vetëdijen ose me bindjen time se këtu është bërë identifikim i gjitha fushave dhe sferave me të cilat duhet në të ardhmen të merret Qeveria dhe gjithashtu do të thotë dhënja e prioriteteve por edhe e masave të cilave duhet të ndërmerren gjatë mandatit që do ta ketë kjo Qeveri.

Kuptohet, përkrahi të gjitha ato diskutime dhe sferat që janë mjaftë të ndieshme me të cilat do të ballafaqohemi në periudhën e ardhshme e sidomos lëmi i ekonomisë do të jetë një prej lëmive më të vështira sigurisht që do të ballafaqohemi të gjithë së bashku, në këtë drejtim mendoj se terthorazi u përmend turizmi, kurse unë duhet theksojë se kjo është një prej sferave të veprimtarisë ekonomike e cila mund shumë shpejtë të nxitë zhvillimin ekonomik dhe sidomos të regjioneve rurale që kanë resurse të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit.

Në këtë drejtim unë mendoj se shumë kuvende komunale, rurale siç është Komuna e Dragashit dhe disa komuna të tjera kanë bërë hapat fillestar dhe kanë shijue turistët e parë, qofshin ata vendor apo të huaj. Në këtë fushë unë besoj dhe kam shpresën se Qeveria dhe ministrinë përkatëse duhet të japin mbështetje, përkrahje për krijimin e infrastrukturës për zhvillimin e turizmit vendor-fshatar, turizmit malor, turizmit dimror, turizmit veror ku kemi mjaftë resurse.

Kjo në mënyrë indirekte do të ndikonte në zhvillimin e blektorisë, në zhvillimin - blektorisë ekstenzive, por po them në zhvillimin e blektorisë intenzive e sidomos të komunave që janë pakës më rurale me mbi lartësi mbidetare pakës më të lartë dhe të frutave të malit dhe prodhimeve të tjera që janë me rëndësi.

Besoj se me diskutime të tilla konstruktive rezultatet nuk do të mungojnë.

Ju falemnderit

Kryesia: Ju falemnderit,

Besoj z.Xhavit Haliti do të jetë diku në ndërtesë, unë me qëllim e lashë një anëtar të Kryesisë të partisë dhe të Parlamentit dhe një anëtarë të Kryesisë të LDK-së ta përmbyllim diskutimin, Naim Jerliu dhe nëse vjen i fundit Xhavit Haliti, urëdhëroni z.Naim

Falemnderit z.Kryetar,

Meqë paskam qëlluar që jamë i fundit unë do të jem shumë i shkurtër, fjalën time do ta deponoj me shkrim dhe besoj që nga gjithë ajo që u tha në këtë debat përmbajtësor ky Parlament do ta mbështes programin e prezentuar sot dhe i dëshiroj punë të mbarë dhe të sukseshme Qeverisë.

Kryesia: Ju falemnderit Naim, atëherë Nazim Jashari dhe le ta përfundojë Bajrushin si kryetar shumë i suksesshëm i komisionit mandatin e kaluar,

NAZIM JASHARI

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit, të nderuar zonja dhe zotërinj kuvendor, i nderuari z. Kryeministër dhe anëtarë të stafit qeveritar.

Me dëshirën më të sinqert për të dhënë kontributin tim në shqyrtimin e programit të Qeverisë së Kosovës të formuar pas koalicionit LDK, AAK, dua ta përgëzoj kryeministrin për zellin dhe përkushtimin që e ka shfaqur në fillimin e ushtrimit të mandatit të tij, duke shpresuar se edhe ministrat do të dëshmojnë të njëjtër shkallë të seriozitetit dhe të konsistencës.

Po e shpreh pikërisht këtë rezervë për shkak se njëri nga ministrat e Qeverisë e i cili është nënkryetar në partinë nga e cila edhe vjen edhe kryeministri. Gjatë fushatës zgjedhore në fshatin Slllovi të Lipjanit u zotua publikisht para qytetarëve të atij lokaliteti, që po që se do t'i jepej rasti Aleancës-Ministrinë e parë që do ta merrnim do të ishte Ministria e Bujqësisë. Ky zotrim publik që nuk u përmbush nga Partia e Ministrat të Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor, rezultoj të ketë qenë blef elektoral. E theksova këtë fakt, për ta vënë në spikamë harrestarinë e përsëritur të nënkryetarit Bajram Kosumi e shumë më tepër për ta theksuar vazhdimësinë e të trajtuarit në mënyrë jo mjaft të përgjegjshme të një sektori mjaft të rëndësishëm të ekonomisë sonë. Duke marrë parasysh se bujqësia merr pjesë rreth 1/3 të prodhimit vjetor të Kosovës, duke marrë parasysh se një pjesë e madhe e popullsisë së Kosovës është e lidhur me këtë veprimtari, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo në mënyrë të terthortë, duke marrë parasysh se prodhimtaria bujqësore përbën rreth 18% të eksportit edhe ashtu shumë të kufizuar të vendit tonë, duhet të thuhet se 28 rreshtat e programit qeveritar janë tepër pak për një fushëveprimtari kaq të rëndësishme.

Bujqësia kosovare ka nevojë për një ekonomi shumë më të madhe se sa që e pati nga Qeveria e kaluar ku nga buxheti i së cilës mezi u ndanë 2.4 milion euro rreth 1 euro për kokë banori që është shumë pak. Për deri sa dihet se gjatë periudhës 1990 – 1999 e sidomos gjatë kohës së luftës 98-99 u zvogëluar shumë prodhimtaria bujqësore, u shkatërruan shumë objekte prodhuese, u asgjësua gadi i tërë sektori shoqërori bujqësor, u dëmtan të gjitha mjetet prodhuese dhe u asgjësuan mbi 60% e

fondit të kafshëve, pas lëuftës kjo degë nuk u arrit të rmëkëmbet dhe të avansohej me rritje të nevojshme nga se nuk u siguruan bazat elementare ligjore për zhvillimin e saj.

Edhe pse Qeveria në Programin e vet paralajmëron aprovimin e strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë, që mendoj se është për t'u përshëndetur, ni aspekt negativ i kësaj është se nuk është bërë afatizimi kohor i miratimit të kësaj strategjie. P.sh në 100 ditët e para të qeverisjes e që më vonë të kishte kohë të mjaftueshme për ta jetësuar këtë strategji, kështu mundet fare lehtë që kjo strategji të përpilohet në fund të mandatit qeveritar, pikërisht për këtë mendoj se programi i Qeverisë është dashur të jetë më i hollësishëm, sa i përket kësaj veprimtarie kaq strategjike ekonomike dhe është dashur gjithsesi të parashoh, një partneritet të ri të domosdoshëm në mes të Qeverisë së Kosovës, institucioneve kredituese, zhvilluesve bujqësor dhe përpunuesve të produkteve bujqësore. Të ndryshoj politikën ndaj tokës dhe shfrytëzimit të saj me qëllim të ruajtjes së tokës punuese që po dëmtohet vazhdimisht dhe të përcaktoj krijimin e një instituti bujqësor që do t'i shërbente për këshillim profesional prodhuesve bujqësor.

Një aspekt tjetër që desha ta shqyrtoj të nderuar zonja dhe zotrinj është lufta kundër korrupsionit që fare pak ose përciptazi trajtohet në programin qeveritar. Në programin qeveritar thuhet se do të

merren masa që gradualisht me rritjen e mundësive buxhetore pozita materiale e punëtorëve publikë dhe shërbyesve civil të përmirësohet dhe të jetë e dinjëtetshme, paralelisht me këtë do të evitohen të gjitha dukuritë e keqpërdorimit të pozitës të menaxhimit të përgjegjshëm, të buxheteve dhe të përfitimeve private nga pronat publike, po që se e ndëgjojmë me vëmendje këtë pasus do ta shifni se vjen prej një rekomandimi të dnonjë udhëheqje diku, e nuk mund të jetë pikë e programit qeveritarë.

Në programin qeveritar nuk parashihet ndërtimi i mekanizmave kontrollues dhe verifikues që do t'i bënin më transparente proceset e tenderimit dhe të prokurimeve në ministri. Thuhet diku se Qeveria do të kërkojë një aleancë të gjërë me opinionin publik, medija dhe shoqërinë civile për ta ngushtuar hapsirën për veprim të korrupsionit, është poashtu citat nga programi qeveritar, mirëpo siç po shihet nga ky program qeveritar nuk është paraparë tli blhen kurfarë auditimesh lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive në disa nga ministrinë e mandatit të kaluar, të cilat kanë qenë të përfolura nëpër shtyp. Si bie fjala në ministrinë e arsimit me licencimet, herë me kriter, her pa kriter të insitucioneve arsimore, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria për Ekonomi dhe Financa që në shtyp po paraqesin një ...dhe një pozitë të nepotizmit e deri tek Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit që në mes tjerash ja doli ta prodhojë një skandal me përmasa ndërkombëtare...

Kryesia: Ju falemdnerit,

**BAJRUSH XHEMAJLI**

I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, dua që menjëherë të përqëndrohem në dy segmente që kanë të bëjnë me programin e Qeverisë në sektorin e energjetikës dhe në sektorin prodhues industrial. Po fillojmë me energjetikë:

Nën një, energjetika siç dihet se ka një rëndësi të posaçme, në zhvillimin e gjithmbarshëm të ekonomisë të një vendi dhe është parakusht dhe bazë që ndikon në shoqërinë e jetës në përgjithësi, por hapësira që i është dhënë energjetikës në programin e Qeverisë, nuk le të kuptohet kjo rëndësi e posaçme e këtij sektori i cili duhet të jetë pjesë motorike e zhvillimit të Kosovës, posaqërisht tani kur ajo ballafaqohet me probleme të mëdha dhe paraqitet si pengesë e vetë zhvillimit.

Nën dy, fokusimi i Qeverisë në ndërmarrjen e masave efektive në stabilizimin e prodhimit të furnizimit dhe ngritjes së nivelit të pagesës së energjisë së hargjuar është i gabueshm, këtë duhet ta bëjnë 10 mijë punëtorë ekspert të punësuar në KEK bash me menagjmentin e tyre. Qeveria do të

duhet të merret me punë tjera ajo duhet t'i përkrahë iniciativat dhe aktivitetet që mundësojnë ngritjen e nivelit të gadishmërisë për prodhim më cilësorë, për furnizim të rregullt me energji elektrike, duke insistuar me gjetjen e mekanizmave shtetërorë në përmirësimin apo eliminimin e dukurive prezente, në mospagesën e energjisë së hargjuar.

Nën tre, nuk mund të thuhet siç është në program, ndjekjen e politikave të strategjisë energjetike të bëhet faktorizimi i ministrisë për energjetikë, kjo në vete nuk le të kuptohet asgjë, se me vetë faktin që është Ministri e Energjetikës dhe Minerave, është faktor madje nr. 1, por çështja qëndron se a e luan rolin aq të rëndësishëm që ka si ministri. Ministria e Energjetikës në fakt duhet të aftësohet për t'u angazhuar ose aktivizuar në krijimin për dizajnimin e politikave të strategjisë energjetike të vendit e jo të kërkojë nga dikush tjetër që të faktorizohet, në fakt ajo mund ta faktorizojë vetëveten.

Nën katër, në program parashifet që Ministria e Energjetikës të përgaditë hartimin e struktimit të fizibilitetit për një bllok të ri prej 300 megavatë. Shtrohet çështja, ku dhe kur është caktuar nevoja për këtë kapacitet dhe për çfarë destinimi. Është dashur në fillim të përcaktohen nevojat e vendit dhe tek atëherë të përcaktohet kapaciteti, kush duhet të përcaktojë madhësinë e kapacitetit të ri, tek pasi të shqyrtohet strategjia energjetike e Kosovës, atëherë mund të flitet se cili është kapaciteti optimal

për mbulimin e nevojave të ekonomisë dhe popullatës vendore, deri atëherë asnjë program nuk do të mund të përcaktojë kapacitetin e objektit energjetik.

Nën pesë, asnjë pjesë të programit për energjetikë nuk përmenden mundësitë tjera të ndërtimit të objekteve energjetike në bazë të nevojave. Ashtu si edhe në tërë programin, edhe kjo pjesë vuan nga përgjithësimet. Këto dëshira të shfaqura nuk janë konkrete, së paku është dashur të afatizohet procesi i ristrukturimit, pastaj të përcaktohet se kur do të hyjnë në funksion 3 ligje që kanë të bëjnë me energjetikën, që të mundemi me i eliminuar importin dhe të mos grabitet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Me një fjalë do të duhej të jetë një dritë në fund të tunelit se si të dilet nga kjo gjendje, e që nuk shihet së paku mbi bazë të asaj që është thënë. Tani dua të shpreh habin time se si një program qeveritar mund të anashkaloj prodhimin industrial. Në program përmendet pothuajse vetëm fjala biznes pa u fokusuar fare cilin biznes e favorizon Qeveria.

Nuk paraqet asgjë ashtu siç është thënë se Qeveria i jep rëndësi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Qeveria nëse do të zhvilloj vendin duhet doemos të krijoj vende duhet të mos lej anash programet industriale dhe ta potencoj fuqishëm programin e vetë, të stimuloj sektorin prodhues si nga drejtimet kryesore për rritjen e punësimit, përdorimin e faktorëve natyrorë, rritjen e eksporteve dhe uljen e importeve, me synim rritjen e deficitit tregëtar. Për këtë ajo duhet që brenda afatit të saj të hartoj politikë dhe strategji të tilla, të krijoj mundësi për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe kushte të favorshme për nxitjen e zhvillimit të industrisë në Kosovë. Ka edhe shumë çka por do t'i bije më shkurtë, pas energjetikës, si resurs që është resurs numër 1. në Kosovë së paku unë mendoj ashtu, sigurisht që janë nr. 2 minierat për të cilat nuk është folur asgjë. Kjo mendoj se nuk do koment, këtu besoj se ka shumë çka, por i sygjerroj Ministrisë - se programi ka të meta serioze dhe si i tillë duhet të përpunohet seriozisht dhe të jetë i zbatueshëm e jo të mbetet që unë ta quaj si fontanë dëshirash e Qeverisë. Ju faleminderit.

**KRYETARI, NEXHAT DACI**

Kryeministri e ka të drejtën e rezervuar në qofte se e shef të arsyeshme, por nuk e ftoj, nuk është obligim. Atëherë më lejoni që 97 deputetë.

**SABIT RRAHMANI**



E perkrahi plotësisht Programin e Qeverisë. Më falni deputet që nuk ju përshëndeta juve, kryetarin e Kuvendit, kryeministrin, e veçanërisht e përshëndes punën e zëvendës kryeministrit Adem Salihaj që e ka bërë në Ferizaj për komunitetin Ashkanjli.

E përshëndes programin e Qeverisë . Unë kisha dashur që disa gjëra të qartësohen mirë në lidhje me punësimin, arsimimin dhe kthimin e komunitetit ashkanjli. Duke marrë parasysh se do të bëhet transferi gradual i kompetencave prej ndërkombëtarëve te vendorët, ne besojmë që shumë shpejtë edhe kjo Qeveri në të cilën kemi besim që do ta kryej punën e vetë ashtu siç duhet, do të merr në dorë kompetencat e AKM-së. Unë kisha preferuar që të gjitha institucionet që do të privatizohen, e kam fjalën për ndërmarrjet private, ato publike dhe aksionare që Kuvendi dhe kjo Qeveri ta nxjerr një lligj të posaqëm dhe t'i kushtëzoj këto ndërmarrje që të privatizohen, që 10% prej tyre të punësojnë edhe komunitetet pakicë. Nëse nuk del një ligj i këtij lloji prej këtij Parlamenti me siguri që ndërmarrjet që do të privatizohen do t'i marin punëtorët e vet dhe me siguri që pakica do të jetë mbrapa. Ne e dimë shumë mirë që privatizimi është proces pozitiv dhe zbatim i standardeve në Kosovë, po me siguri se komunitetet pakicë i lënë mbrapa, duke marrë

parasysh se punësimi në komunitetet pakicë është shumë i vogël. Unë e di se mbi 95% të komunitetit ashkali janë të papunë dhe janë raste sociale, dikush prej tyre ka 10 anëtaer dhe i merr 60 euro në muaj dhe për çdo kryefamiljar i merr 2 euro për çdo muaj duke llogaritur se nuk i bien për një shujtë në ditë as 25 cent.

Kisha kërkuar nga të gjithë ministrat edhe nuk është turp me thënë këtë, duke marrë parasysh se komuniteti ashkali është një popull i varfër dhe i pashkollë, nëse ka mundësi edhe ministratë e juaja t'i punësojnë këta të rinj dhe të reja edhe si pastrues . Nën 2 e kam një model që e ka përdorur Kuvendi komunal i Ferizajit dhe Kuvendi Komunal Shtimes, nivelin e arsimimit intenziv. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit ashkanjli kanë mbetur pa u arsimuar prej vitit 90 deri 99, duke marrë parasysh rrethanat politike, shumica prej tyre për shkak të kushteve ekonomike që nuk kanë pasur mundësi në atë kohë me ndjekë shkollimin, kështu që kisha pasur një sygjërim te Ministria e arsimit që ta aplikojë mësimin intenziv sikur që është aplikuar në komunën e Ferizajit dhe në Komunën e Shtimes që ata persona që i kanë humbur 9 vite me mësim intenzive dhe periudha 6 mujore dhe 9 mujore ta marrin një klasë të shkollës fillore, së paku të paisen me dëftesa të shkollës fillore.

Është formuar edhe Ministria e kthimit. Nuk do të flas pa kurrfarë konotacioni politik sa i përket kthimit. Unë mendoj që pjesëtarët e pakicave e sidomos pjesëtarët e komunitetit ashkanjli të kthehen në këtë moment në Kosovë, nuk e kam për diçka që do të ketë ndikime negative, por është shumë e vërtetë që shumica prej komunitetit ashkali që janë momentalisht në Kosovë mvaren prej tyre dhe zbatimi i standardeve dhe zhvillimi i një shoqërie demokratike nuk mund të bëhet me një varfëri të skajshme si është momentalisht komuniteti ashkali.

Si pikë të parë e kisha sygjëruar Qeverinë që së paku fillimisht t'i kthej këta persona që janë brenda për brenda Kosovës dhe në rajon, si p.sh. kampi i Plemetimit, nuk dua ta mohoj punën e Qeverisë, që vërtet ka punuar me një përkushtim shumë të madh, por edhe 5 vite mbas luftës prap 72 familje të komunitetit ashkali dhe egjiptas ndodhen në Plemetin dhe nuk i kanë shtëpiat e tyre 5 kilometra 6 kilometra larg. Unë besoj se suficiti i buxhetit të Kosovës që u përmend vitin e kaluar mbi 120 milion euro dhe kur po ndodh një dëm sikur që ka ndodhur 17 dhe 18 marsi mjetet po dalin, atëherë na dalin këto mjete që edhe këta persona me i kthyer në vendet e veta sikur që ka ndodhur me një numër bukur të madh të komunitetit ashkali në Komunën e Vushtrisë që janë kthyer me 17 dhe 18 mars Qeveria gjeti mjete për ata.

KRYETARI, NEXHAT DACI

Z. kryeministër e keni fjalën përfundimtare.

RAMUSH HARADINAJ

I nderuar z. kryetar i Parlamentit, të nderuar deputet, zëvendëskryeministër, ministra zëvendësministra.

Ne me vetëdije kemi sjellur para jush Programin e Qeverisë dhe në ekspozenë time. Unë jamë munduar poashtu të shpjegoj rrethanat dhe shumë aspekte tjera që kanë ndikuar që të kemi një program siç është i Qeverisë së Kosovës. Unë mendoj se shumë nga Ju me vlersimet e juaja dhe me mendimet, por edhe vërejtjet dhe kritikën, poashtu. kemi pasur parasysh shumë aspekte dhe obligime që secili prej nesh i ka ndërmarrë dhe synon që t'i realizoj në Kosovë. Në rrethanat në të cilat Qeveria e Kosovës ka filluar punën dhe me gjendjen e gjetur në Kosovë dhe duke përmbledhur dhe duke përfshirë përvojat e ministrive veç e veç, duke pasur këtu parasysh edhe

ministritë e reja, ne kemi sjellur para jush programin e Qeverisë që sipas bindjes sime është i realizueshëm dhe do t'i sigurojë Kosovës zhvillim të gjithmbarshëm. Do ta bëj një shpjegim edhe pse e di se ju e dini të gjithë, ministritë veç e veç kanë planet dhe programet e tyre të punës, planet e veprimtë që janë shumë të gjërë dhe që mund t'ju them se përfshijnë shumë aspekte që unë i kamë ndëgjju sot të ngritura nga ju.

Ne e kemi pasë një zgjedhje që të bashkojmë më shumë në këtë program. Shumë nga këto çështje, por e kemi mendu se orientimet programore dhe zhvillimore t'i përmbledhim në mënyrë që do të jenë në trende zhvillimore në një ngritje të vazhdueshme dhe që do të sigurojmë mbështetjen e të gjithëve.

Ne kemi mendu në një mbështetje që do të vjen në rradhë të parë nga puna që do ta bënë Qeveria, kemi mendu në rolin dhe në ndihmesën që do ta japim institucionet e Kosovës, Parlamenti dhe Presidenca. Kemi mendu në rolin dhe në bashkëpunimin që do ta kemi me shoqërinë civile edhe me shumë institute dhe organizata me qenë se shumë prej tyre kanë bërë punë që tani më janë të aplikueshme dhe mund të aplikohen në aspektet qeverisëse.

Andaj, duke i pranuar vërejtjet dhe kritikën, por edhe ndihmesën që janë të mirëseardhura, unë premtoj se kjo do të jetë një materie ndihmesë, në zbatim të Programit. Pra një materie ndihmesë në zbatim të Programit si Qeveria, Poashtu disa nga ato sugjerime që janë të inkorporueshme dhe që e pasurojnë Programin do të jenë të përfshira në planet dhe në programet veç e veç të ministrive që thash se janë shumë më të gjëra do të na ndihmojnë këto vërejtje dhe sugjerime tuaja.

Unë ju ftoj si kryeministër i Kosovës që të votojmë Programin sot dhe ju ftojë po ashtu në bashkëpunim të mëtejshëm.

Jam i bindur me këtë Program i tillë çfarë është, janë dhënë shumë mendime si është puna ky program me rradhë e me rradhë. Të mos harrojmë se në këtë program kanë punë të gjithë ministritë veç e veç, kanë punë institute dhe ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë, por ne kemi qenë të hapur të marrim të gjitha hulumtimet e instituteve të ndryshme që kanë punë dhe që kanë qenë protagonist të zhvillimeve në Kosovë.

Ne sigurojmë një zhvillim të Kosovës në të gjitha fushat e jetës me këtë Program, sigurojmë realizimin e standardeve në këtë Program dhe sigurojmë pra bërjen e Kosovës shtet, që është synim i ynë dhe ju ftojë që të na japni mbështetjet, pra edhe ta votoni. Ju faleminderit.

## KRYESUESI NEXHAT DACI

Kryeministër ju faleminderit

Më lejoni një konstatim përfundimtarë. Unë mendoj që seanca e sotme plenare, vërtetë meriton vlersimet më të larta si sencë plenare. Të gjitha diskutimet janë aqë cilësore në nivel të duhur dhe mendoj që atë që tha kryeministri çdo ministri e veçantë me shumë përkushtim dhe seriozitet do t'i analizon sugjerimet që kanë qenë shumë kolegiale me qëllime të mira. Për mua është një knaqësi e veçantë që sezonin e punës ose mandatin e kemi filluar me një nivel të këtillë. Me qëllim thash po e faleminderoj seancën plenare jo pozitën dhe opozitën, sepse në një mënyrë prej Parlamentit do të jetë opozitë konstruktive e Qeverisë, ndërsa Qeveria dëshmoi me qëndrimin e saj në sallë që do të jetë gjithmonë sa herë ta ftojnë deputetët dhe sipas rregullorës. Mbi këto baza i faleminderoj edhe ata që e deponuan me shkrim, ata që nuk arritën për shkak të kohës të kufizuar fjalimin t'a dorëzojnë, sepse e kanë të vetmin qëllim që të begatohet Programi i Qeverisë dhe ju ftoj të futemi në procesin e vendimarrjes, ta përkrahim Programin e Qeverisë, duke propozuar që inkorporohen

të gjitha ato që i kanë mungu dhe ju ftoj kush është për aprovimin e Programit të Qeverisë, t'i numërojmë votat, ju lutem.

Ju falemnderit

A ka votë kundër, një votë kundër, a ka abstenime, edhe pse apstenimet nuk kan barë, le të konstatohet, ju lutem

Rezultati i votimeve është si vijon: 66 deputet kanë votuar pro programit të Qeverisë, 1 votë kundër dhe 31 abstenime, prandaj konsideroj që e kemi aprovuar Programin e Qeverisë. Ju faleminderit shumë.

Kalojmë në pikën tjetër - Formimi i komisioneve.

Duhet të marrim vendim për miratimin e numrit të komisioneve dhe numrit të anëtarëve të komisioneve.

T'ju njoftoj se të gjitha...

(Ndërprerje e shkurtër)

Të gjitha grupet parlamentare i kanë bërë propozimet e veta. Deri në këtë moment unë nuk e kam propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës. Ka patur premtime gojore, nuk e di sa është e vërtetë, që në Seancë dikush do t'i propozojë. Pyes shëfën e Grupit Parlamentar – a keni diçka të re, apo jo? Urdhëroni...

JAKUP KRASNIQI:

Zoti kryetar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përshëndet punën që është bërë në reduktimin nga 19 komisione në 10, por mendoj që është mirë që vendimin përfundimtar po e marrim sot në Kuvend.

Ne kemi disa vërejtje, ndoshta edhe nuk janë krejt të ligjshme, por mendoj se pasi në Parlament funksionon pozita dhe opozita, ne si Grup Parlamentar kemi një kërkesë që për dy komisione, që në fakt janë caktuar kryetarët e grupeve – të udhëhiqen nga opozita dhe jo nga pozita. Është fjala

për Komisionin e parë – për buxhet dhe financa. Nëse dëshirojmë që vërtetë opozita të jetë promotor dhe nxitje e punës dhe nëse dojmë ta kuptojmë këtë se duhet të jetë edhe një barometër kontrollues i koalicionit qeverisës, atëherë ky Komision duhet të drejtohet nga opozita.

Komisioni tjetër, që mendoj duhet përsëri për shkak të transparencës dhe demokracisë të drejtohet nga Partia Demokratike ose opozita, është Komisioni për ekonomi, tregti, industri, privatizim. Mendoj se kjo është në interes të demokracisë, është në interes të transparencës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron se Parlamenti ynë duhet të ketë edhe një komision politik për çështjen e standardeve dhe të decentralizimit. Kur kemi parasysh disa gjëra që kanë tejkalar kornizën e decentralizimit, e që ishte një nga dokumentat kryesor, i arritur bashkë në mes të administratës ndërkombëtare dhe Qeverisë së Kosovës, ne mendojmë se ky dokument është tejkalar. Diçka është duke u përshpejtuar në këtë drejtim, dhe ne kërkojmë formimin e një komisioni politik dhe profesional që do të ketë 5 apo 7 vetë, mos të jetë për të

gjithë periudhën por konsiderojmë se për këtë fazë, kur dikush decentralizimin don ta përdorë për ndryshimin e kufijve komunal, pa ekzistimin e ligjit për ndarjen territoriale dhe hapsinore të komunave – konsiderojmë se nuk kanë të drejtë dhe këtë të drejtë e ka vetëm Parlamenti dhe kërkojmë që Parlamenti ta formojë këtë komision nëse dëshiron të jetë në koherent dhe në ngjarjet që do të zhvillohen për reformimin e ushtetit vendor dhe decentralizimin.

Përndryshe, tejkalimi që i është bërë dokumentit kornizë për decentralizim, është i rrezikshëm dhe këtu nuk po bëhet decentralizimi, as ofrimi i pushtetit dhe i shërbimeve publike afër qytetarit, por po bëhet një ndarje e re, po bëhet një enklavizim dhe nuk dij deri ku shkon kjo, prandaj kërkoj nga ju deputetë – zonja e zotrinj që kësaj qasjeje t'i qasemi me seriozitet e që pastaj mos të votojmë. Përndryshe, edhe betimin që e bëmë sot, edhe betimi na obligon që të kemi kujdes se me decentralizimin, sidomos me dokumentin e fundit që është sjellë në grupin e punës për decentralizim, nuk kemi as reformim, as decentralizim – po e cek edhe një herë: kemi ndarje territoriale dhe kjo punë nuk është më e ekzekutivit. Kjo punë dhe kjo çështje tepër e rëndësishme, është e Parlamentit dhe duhet të vendoset në Parlament. Këto janë vërejtjet tona për këto çështje.

Përndryshe, kemi edhe caktimin, nëse është nevoja do t'i lexoj?

Të gjithë kryetarëve, nënkryetarëve dhe antëtarëve të komisioneve...

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Jo, na i dorëzoni me shkrim. Falemnderit zoti Krasniqi.

Më lejoni, për hirë të kamerave dhe të opinionit, sepse deputetët e dijnë... Përzgjedhja e komisioneve është bërë, sipas informatës time, në marrëveshje të plotë të grupeve parlamentare – mbi baza të një rregullsie që ka qenë në mandatin e kaluar dhe që është mbi bazën e forcës së ulëseve në Parlament. Dhe, asnjë ndryshim... edhe pse në aspektin demokratik zoti Krasniqi plotësisht ka të drejtë kur thotë që mund edhe t'i marrë financat dhe buxhetin – nuk është kurgjo e pamundshme, por kjo ka qenë në një fazë të kaluar, në të cilën – unë besoj – ka participuar edhe vetë zoti Krasniqi, si shef i Grupit Parlamentar. Do të thotë, dy çështjet e para – Komisioni për

buxhet, ekonomi dhe tregti nuk mund të jetë pjesë e asnjë diskutimi – debati, sepse proceduralisht ka përfunduar më herët.

Sa i përket Komisionit të tretë. Mendoj që Jakupi ka menduar për një komision ad hoc dhe nuk e refuzoj si mundësi, por jo sot. Kjo duhet t'i nënshtrohet procedurës, do të thotë të shkojë si propozim i Grupit Parlamentar në Kryesi dhe në një moment të duhur..... me kënaqësi të veçantë sepse ne nuk mendojmë tërë mandatin të mirremi si komision permanent me këto çështje dhe e përsëritës me kënaqësi të veçantë këtë mirëseardhje të ndërrimit fundamental të qëndrimit të zotit Krasniqi. Besoj se edhe ai e kupton këtë dhe s'po hyj .... sepse kam rrespekt dhe nuk po dua të shkoj më tutje. Prandaj, do të keni përkrahje zoti Krasniqi gjithmonë për atë që është interes i Kosovës, interes i qytetarëve të Kosovës.

(Ndërhyrje – pa kyçe të mikrofonit)

Jo, jo s'keni pse të ndërhyni, sepse po t'u kisha thënë ato të gjitha... Unë kurgjo s'ju thash, veç e përsëritës progresin që po e arrijmë të gjithë në punën tonë dhe s'ka tjetër...

Prandaj, ju falemnderit për propozim dhe që keni bërë gati emrat. Unë po shkoj, jo për të votuar, sepse është e drejtë e grupeve parlamentare, por po ua them propozimin se në cilin komision – kush është, cila parti e udhëheq, e tjera, e tjera:

- Komisioni për buxhet dhe financa: 12 anëtarë. Kryetar është LDK; një nënkryetar i parë SLKM dhe një nënkryetar i dytë PDK;
- Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe për kthim: Kryetar – komuniteti serb; nënkryetar i parë LDK; nënkryetar i dytë Komuniteti turk;
- Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, me nënkomisionet për barazi gjinore, peticion e ankesa publike dhe për persona të pagjetur: 12 anëtarë; Kryetar PDK; nënkryetar i parë LDK; nënkryetar i dytë – Grupi 6 plus;
- Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim në BE: Kryetar LDK, nënkryetar i parë PDK; nënkryetar i dytë GP 6 plus;
- Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport: Kryetar PDK; nënkryetar i parë LDK, nënkryetar i dytë SLKM;
- Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion: Kryetar LDK; nënkryetar i parë PDK; nënkryetar i dytë GP 6 plus;
- Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor: Kryetar GP 6 plus; nënkryetar i parë LDK; nënkryetar i dytë SLKM;
- Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale: Kryetar ORA; Nënkryetar i parë LDK; nënkryetar i dytë GP 6 plus;
- Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media: Kryetar LDK; nënkryetar i parë PDK; nënkryetar i dytë SLKM;
- Komisioni për gatishmëri dhe emergjencë: Kryetar AAK; nënkryetar ORA; nënkryetar i dytë GP 6 plus;

- Komisioni për Rregulloren e punës të Kuvendit: Kryetar PDK; nënkryetar i parë IRDKAK dhe nënkryetari i dytë SLKM.

Prandaj, ju ftoj që me një votë formale të deklarohe mi.

Kush është për? Urdhëro bre Baliq, shta da govorish?! Urdhëroni, lëshojani mikrofonin.

### NUMAN BALIĆ:

Pa nema brojanja glasanja prije glasanja. Ja vas molim za riječ.

Gospodine predsjedniče Skupštine, rekli ste da ćemo govoriti u interesu Kosova i za dobro građana Kosova. Ovo što ću govoriti, sigurno je u interesu Kosova i građana Kosova.

Ovo je predlog Predsjedništva Skupštine. Kao što znate, jedan od članova Predsjedništva Skupštine, koji je i u prošlom sazivu nažalost bio sporan, ponovo je sporan. To jedna stvar.

Druga stvar. Imenovanje članova komisija iz redova drugih zajednica, obavljeno je na taj način što je on dokazao potpuno neuvažavanje, zapostavljanje i ja mogu riječi – diskriminaciju. Na osnovu naših dokaza, ja kao predstavnik Bošnjaka i predsjednik SDA, zatim gospodin Sabit Rahmani, predstavnik Aškalijski, Rustem Ibišić, predsjednik Goranaca, Zulfij Merdža, predsjednik Roma uopšte nisu niti konsultirani, niti obavješteni, niti imaju mjesto u bilo kojoj komisiji. Jesu li to standardi, gospodine predsjedniče Skupštine? To je jedno pitanje.

Drugo pitanje u vezi sa Komisijom za prava i interese zajednica koje bi valjda trebalo da bude neki rezervat za Bošnjake, Rome, Egipćane, Haškalijski i tako dalje - ni za ovu komisiju uopšte nismo bili pitani, niti smo pitani niti je sa nama dogovoreno. Ja vidim svoje ime ovdje u Komisiji za prava i interese zajednica. Naravno moje mjesto jeste tu, i u ovom Parlamentu takodje - da se zajedno sa vama borimo za zajednička prava i za zajedničko uvažavanje. Ali, gospodine predsjedniče, mi ne možemo činiti loše a raditi dobro, tako da, ja vas molim da se razmotri, prvo: pitanje učešća drugih takozvanih zajednica u svim komisijama zato što Grupa G 6 plus, ne znam ni kako se zove, ona tačno da ima 6 poslanika i ima dovoljan broj poslanika, ali ta grupa obuhvaća samo Tursku zajednicu i jedan dio Bošnjačke zajednice. Ta grupa ne obuhvaća Bošnjake, dakle drugi dio Bošnjaka, Rome, Egipćane, Haškalijski i Gorance. Dakle, morate voditi računa o tome.

### KRYETRI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Pasi ta dhash fjalën, tani përfundoje! Kemi hyrë në proces të votimit. E kam thye rregullën e punës vetëm për të ta dhënë fjalën. Mos na mbaj ligjerata. Në proces të votimit, na keni ndërpre, prandaj edhe mos e zgjat shumë.

### NUMAN BALIĆ:

Vi ste očigledno navikli da isključujete riječ i ja vas molim da tako ne postupate, ako želite da postupate sa onim što ste rekli – u interesu Kosova i građana Kosova, ako ga uopšte nekoga predstavljamo.

Vežano za Komisiju za prava i interese zajednica, ovde je – ova Komisija, odredjen je predsjednik Komisije iz redova Srpske zajednice. Prema mojim saznanjima, koje sam dobio, kao i vjerovatno i vašima, gospodin Randjel Nojkić uopšte nije niti konsultiran niti je dao saglasnost za ovu Komisiju. Moje pitanje je prvo, da li mora biti srpski predstavnik onaj koji će predsjedavati ovom Komisijom, i da li potpredsjednici moraju biti iz redova LDK odnosno Turske zajednice i predlažem da se ova Komisija u cijelosti ponovo razmotri kao naravno i druge komisije. U protivnom, za predstavnike ove četiri zajednice, sastavi ovih komisija - su neprihvatljivi.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Numan, sado që të mundohet njeriu t'i përkrah minoritetet qoftë partiake, qoftë etnike – në fund merr kritika dhe sulme. Dëgjo kjartë, sepse nuk ke qenë i përfshirë në punë. Komisionet i propozojnë grupet parlamentare. Në Grupin parlamentar të bashkësive etnike joserbe dhe joshqiptare kërkush nuk ju limitizon ose nuk ju kufizon që të merrni pjesë e të inkuadroheni dhe të keni të drejtë në përfaqësim me atë që merreni ju si Grup Parlamentar. E njëjta gjë vlen edhe për partitë e vogla shqiptare. Nuk ka përkufizime që t' mos kyçen, e nëse dojnë edhe mund të formojnë grup të vetin parlamentar.

Mos u shërbeni me të pavërteta dhe pa argumente, sepse Nojkiqin as ëndërr s'e kam pa, as unë e as Kryesia. Për këtë e kemi dokumentin me shkrim edhe në Kornizë kushtetuese e në dokumente me të cilat punon Parlamenti dhe komisioni ose komiteti për komunitete udhëhiqet nga serbët, nga minoriteti serb. Ose, është çështje e juaj të mirreni vesh. Nuk është e mazhurancës, prandaj as mos kërcënoni, as mos bëni sulme e kritika pa vend. Unë ju dhash fjalën. Ju falemnderit.

Dëgjuam propozimet për dhjetë komisione, nga grupet parlamentare, jo nga Kryesia dhe jo nga individit dhe ju ftova... Dhe, po ju ftoj edhe një herë:

- Kush është për popozimet e grupeve parlamentare? Urdhëroni votoni.

Le të numërohen votat, ju lutem.

A ka votë kundër, ju lutem? 2 vota kundër.

A ka abstenime? 1 abstnenim.

90 deputetë kanë votuar për propozimet e grupeve parlamentare dhe për këtë ju falënderoj.

Grupeve parlamentare iu dëshiroj punë të mbarë dhe do ta kenë ndihmën e plotë tonën.

Më lejoni t'ju falënderoj për pjesëmarrje. Komisioni për rregullore dhe të tjerët, do të informohen për punë të mëtejshme. Shpresoj se, nëse mundemi, ndoshta para vitit të ri do të takohemi në një kafe ose në një kojte, prandaj ju falënderoj për kontributin e sotëm.

Seanca përfundoi punën në orën 16,35.

---

E transkriptoi: fq:1-15,40,41,58-62 - [rexhep.tullari@assembly-kosova.org](mailto:rexhep.tullari@assembly-kosova.org), zyra E-04,tel.038-211-860